Institucionet për Planifikim Hapësinor kanë ekzistuar në Kosovë që nga Lufta e Dytë Botërore. Gjatë konflikti të vitit 1990, këto institucione në Kosovës pushojnë së vepruari. Që atëherë, shumë ndërtime janë zhvilluar pa planifikim. Me “Ligjin për Planifikim Hapësinor”, u krijua një kornizë e re ligjore për planifikim hapësinor. Plani Hapësinor i Kosovës, 2005-2015+”, i përgatitur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, (MMPH), Instituti për Planifikim Hapësinor, është plani i parë hapësinor, i cili e mbulon tërë territorin e Kosovës, e i përgatitur sipas kornizës së sipërpërmendur. Në kohën kur kanë filluar të përgatiten: PZHU/PZHK (2006), Plani Hapësinor i Kosovës ishte si dokument pune.

Plani Hapësinor i Kosovës është i bazuar mbi vizionin për të ardhmen: “Kosova vend sovran i integruar në Bashkësinë Evropiane me zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik, infrastrukturë dhe teknologji moderne, me mundësi arsimimi për të gjithë, fuqi punëtore të kualifikuar, një vend që ka respekt për mjedisin, trashëgimin natyrore dhe kulturore për tërë territorin e vet dhe vendet fqinjë, me një shoqëri të hapur që e promovon llojllojshmërinë dhe shkëmbimin e ideve , duke respektuar të drejtat e të gjithëve.”

Pjesa qendrore e Planit Hapësinor është Strategjia Zhvillimore Hapësinore. Kjo Strategji e propozuar bazohet në tri parime kryesore:

- **Zhvillimi i rrjetit të fuqishëm urban për zhvillim ekonomik.** Shumica e zonave urbane janë përmirësuar dhe është themeluar rrjeti i infrastrukturës ndërmjet vendbanimeve të vogla dhe të mëdha. Kujdesi shëndetësorë dhe edukimi u është ofruar qytetarëve. Bujqësia dhe industria e lehtë është përkrahur në zonat rurale. Industria e rëndë është rehabilituar, tregtia dhe turizmi janë përkrahur.
- **Zhvillimi dhe ruajtja e burimeve natyrore.** Mbrojtjen dhe përdorimin e mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe natyrore, kualitetin e tokës bujqësore, burimet minerale dhe kontrollimi i zhvillimit të vendbanimeve.



- **Zhvillimi i lidhjeve strategjike.** Integrimin në rrjetin rajonal dhe Evropian të transportit (TEN-T), përmirësimin e nevojave të transportit në Kosovë si dhe furnizim të qëndrueshme me energji elektrike dhe ujë për familjarët dhe industrinë.


Strategjia dhe objektivat për një zhvillim të dëshirueshëm hapësinor, ekonomik, mjedisor dhe shoqëror janë të ndara në katër grupe, si në vijim:

- **Porti i Kosovës - Zona e Kaltër:** Rajoni përreth Prishtinës. Përqendrimi në administratë, edukim, kujdes shëndetësor, shërbime dhe tregti, industri të lehtë, industri bujqësore dhe turizëm.
- **Thesari i Kosovës - Zona e Gjelbër:** Rajoni rreth Mitrovicës. Përqendrimi në industri, shërbime dhe tregti dhe industri bujqësore.
- **Urat e Kosovës - Zona e verdhë:** rajonet përreth Gjiçanit/Ferizajt dhe përreth Gjakovës. Përqendrimi në shërbime dhe tregti, industri të lehtë, bujqësore dhe turizëm.
- **Parqet e Kosovës - Zona e Portokalltë:** Rajonet përreth Pejës dhe Prizrenit. Përqendrimi në turizëm kulturor, shërbime dhe tregti, industri të lehtë dhe bujqësore.





Fig. 3: Strategjia për Zhvillim Hapësinor, dokument pune, Prill 2006




Kjo strategji ka për qëllim ndarjen në mënyrë të barabartë të shërbimeve publike dhe zhvillimin ekonomik në të gjitha pjesët e Kosovës, por në shumë aspekte Prishtina është qendër e padiskutueshme. Një nga pjesët më të rëndësishme të strategjisë është zhvillimi i Trekëndëshit të Zhvillimit Ekonomik (TZHE) në zonën ndërmjet Prishtinës dhe aeroportit ndërkombëtar. Gjendja më e favorshme e transportit dhe kushteve të veçanta ekonomike në këtë zonë, do ti tërheqin investimet dhe ta kthej TZHE-në në një shtyllë kurrizore të zhvillimit ekonomik.

Në Dokumentin e Strategjisë Hapësinore të Kosovës, Komunitet i Gjilanit dhe Ferizajt janë të shënuara si zonat e verdha e të definuar si "Urat e Kosovës", Komunitet i Kaçanikut, Artanës, Vitisë, Kamenicës, Shtërpçës gjithashtu janë të përfshira në këtë zonë. Kjo zonë karakterizohet me tokën kualitative bujqësore, burime të pasura të ujit mineral, tregti dhe me traditën e turizmit. Lidhjet ndërkufitare me Maqedoninë dhe Serbinë, sigurojnë kushte të mira për investime në këtë rajon.



Fig. 4: Strategjia për Zhvillim Hapësinor për rajonin e Gjilanit/Ferizajt, "Urat e Kosovës", dokument pune Prill 2006



Ky vizion parasheh një rol të rëndësishëm për rajonin si një lidhje ndërmjet Kosovës dhe vendeve fqinje. Brenda rrethit të qyteteve dhe fshatrave janë zhvilluar aktivitete ekonomike, janë tërhequr investimet dhe është siguruar hapësirë e përshtatshme për sektorin privat, duke e bërë rajonin konkurrent në tregtinë e brendshme dhe të jashtme, dhe duke e përmirësuar kualitetin e jetës për të gjithë qytetarët, njëherit duke i përmbushur kriteret për zhvillim të qëndrueshëm. Firmat e vogla dhe të mëdha (FVM), po kontribuojnë në zhvillimit ekonomik, dhe po japin përkrahje të veçantë këtij zhvillimi.



Synimet Kryesore për Rajonin e Gjiçanit/ Ferizajt janë:

- Zhvillimi i rrjetit të vendbanimeve që siguron qasje të lehtë dhe kushte për jetë dhe punë atraktive në qytete: Gjiçan, Ferizaj si dhe nëpër fshatrat të këtyre rajoneve.
- Përkrahja e ekonomisë së qëndrueshme të urbanizmit lokal, konkurrencë në tregjet e brendshëm dhe të jashtëm,
- Zhvillimin e infrastrukturës (transport rrugor, hekurudhor, ajror, Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit TIK), për të krijuar lidhje të përshtatshme ndër-urbane me pjesët e tjera të Kosovës dhe jashtë vendit.

Plani Hapësinor i Kosovës, i vendos kufijtë e Gjiçanit që kryqëzohen me Serbinë dhe Maqedoninë, si një zonë me interes të veçantë për tërë Kosovën.

Plani Hapësinor i Kosovës gjithashtu i evidenton problemet e ndryshme kyçe dhe propozon që të ndërmerren veprime për zgjidhjen e tyre . Zhvillimi ekonomik i pabarabartë i vendit, është parë si një nga problemet kyçe, ndërsa njëra nga objektivat e identifikuara është qasja e qytetarëve në infrastrukturë. Ndërmjet propozimeve për zhvillimin e infrastrukturës është edhe ndërtimi i linjës hekurudhore që lidh Ferizajn me Bujanovcit përmes Gjiçanit.

### 1.1.3 Përfshirja e informatave kyçe të raporteve dhe strategjive sektoriale në dispozicion

Informatat kyçe të raporteve dhe strategjive sektoriale janë përfshirë në fusha tematike veç e veç.

### 1.1.4 Çështje kyçe të kontekstit më të gjerë hapësinorë

#### **Anamorava dhe komuna e Gjiçanit në Kosove**

Kosova është në qendër të Evropës juglindore dhe ka një sipërfaqe prej 10,887 km<sup>2</sup>. Ajo është vend i kufizuar me: Shqipërinë, Maqedoninë, Serbinë dhe Malin e Zi.

Kosova karakterizohet me reliev të ndryshueshëm, me fusha të gjëra dhe zona malore. Rrethohet nga malet- Alpet Shqiptare (Bjeshkët e Nemuna) me pikë më të lartë mbidetare prej 2,700 metrash. Megjithatë,





malet nuk e izolojnë Kosovën. Lumenjtë kanë formuar lugina të thella, duke i kapërcyer barrierat natyrore dhe duke e lidhur territorin e Kosovës me vendet fqinjë. Ne territorin e Kosovës shtrihen dy tërësi të ulëta relievore të mëdha, rrafshi i Dukagjinit dhe Fusha e Kosovës të cilat janë të ndara me malet e Drenicës. Rrafshi i Anamoravës e prek Fushë Kosovën në pjesën jugore.

Prishtina, kryeqyteti i Kosovës, gjendet në Fushën e Kosovës. Shumica e funksioneve qendrore si dhe zhvillimi më i madh ekonomik në Kosovë, janë koncentruar në rajonin rreth Prishtinës. Baseni i madh i thëngjillit dhe industritë tjera të rënda në Prishtinë kanë krijuar ndotje më të madhe të mjedisit në këtë rajon. Pjesët tjera të Kosovës janë më pakë të ndotura.

Arteriet më të rëndësishme të trafikut rrugorë kalojnë përmes Fushë Kosovës. Hekurudha dhe rrugët automobilistike e lidhin Prishtinën me Shkupin dhe Maqedoninë në jug si dhe me Serbinë në veri .

Rrjeti hekurudhor i Kosovës momentalisht është i standardit të ulët. Tani ai shfrytëzohet vetëm për transport të mallrave, me vetëm një numër të vogël të trenave për transport publik. Momentalisht (2006) nuk ka lidhje të hekurudhës që kalon nëpër Gjilan, por ekzistojnë plane për një lidhje të përshtatshme të Ferizajt me Bujanovcin përmes Gjilanit.. Kjo linjë do ta ndërlihdë Gjilanin me rrjetin hekurudhorë të Kosovës dhe Evropës.

Ekzistojnë dy rrugë magjistrale që kalojnë nëpër Anamoravë: rruga magjistrale M25-3 ndërmjet Ferizajt dhe Bujanovcit dhe M25-2 ndërmjet Prishtinës dhe Preshevës. Këto rrugë kryqëzohen me njëra tjetrën në Gjilan. Të dyja këto rrugë magjistrale e lidhin Kosovën me korridorin X të transportit Pan-Evropian.

Ekzistojnë projekti i autostradës së re e cila do ta lidhte Prishtinën me Nishin- me korridorin e transportit Evropian në verilindje si dhe me Tiranën dhe detin Adriatik në jugperëndim. Ndërtimi i autostradës do të ketë rëndësi të madhe si për komunikacionin brenda Kosovës, ashtu edhe për lidhjet ndërkombëtare. Lidhja më e afërt e Gjilanit në këtë autostradë do të jetë në Shtime, afërsisht 50km larg.

Anamorava dhe Gjilani kanë tradicionalisht lidhje shumë të mira me zonat përreth qyteteve të Bujanovcit dhe Preshevës në Serbi dhe Kumanovën në Maqedoni. Edhe sot ekzistojnë shumë lidhje të tregtisë me këto zona.



Gjatë kohës së ish Jugosllavisë, Gjiçani ka qenë qendër me rëndësi e zhvillimit industrial dhe tregtar për Kosovës. Në Gjiçan ka ende koncentrim të madh të fabrikave edhe pse një numër i madh i tyre nuk është në prodhim. Toka në rrafshin e Anamoravës është shumë pjellore dhe kushtet për zhvillimin e bujqësisë janë shumë të mira.

Malet që e rrethojnë Anamoravën janë të pasura me minerale. Ekzistojnë disa miniera dhe ranishta që kanë punuar para luftës, por momentalisht shumica prej tyre janë të mbyllura. Ekzistojnë gjithashtu burime minerale në pjesë të ndryshme të Anamoravës. Njëra nga më të rëndësishmet është e vendosur në Kllokot, ku është ndërtuar një qendër klimaterike dhe një hotel. Burimet minerale, peizazhi atraktiv dhe qasja e mirë në infrastrukturë rrugore, krijojnë parakushte për zhvillimi të turizmit lokal.

**S****Përparësitë**

- Ndotja më e vogël në krahasim me rrethin e zonës së Prishtinës,
- Lidhje të mira rrugore,
- Është planifikuar linja hekurudhore përmes luginës, lidhje me Serbinë dhe Maqedoninë,
- Koncentrimi i industrisë / pajisjeve industriale,
- Kushte të mira për bujqësi,
- Potenciale për zhvillime turistike.

**W****Dobësitë**

- Lokacioni paksa i largët nga Prishtina dhe nga arteriet kryesore,
- Nuk është planifikua lidhje me autostradën,
- Nuk ka hekurudhë.

**O****mundësitë**

- Rrafshi i Anamoravës mund të zhvillohet në një alternativë atraktive dhe me mjedis pak të ndotur në krahasim me rrethinën e zonës së Prishtinës,
- Gjiçan është porta e Kosovës me Bujanovcin/Preshevën në Serbi dhe Kumanovën në Maqedoni.

**T****kërcënimet**

- Burimet e limituara për zhvillim në Kosovë janë të koncentruar në rrafshin e Fushë Kosovës.

**→****çështjet**

- Përforcimi i pozitës së Gjiçanit si portë hyrëse në Kosovë për Bujanovcin/Preshevën në Serbi dhe Kumanovën në Maqedoni.

	kufiri e shteteve fqinje neighbour national border
	kufiri i Republikës së Kosovës Republic of Kosovo border
	qytete cities
	trekëndëshi i zhvillimit ekonomik të Kosovës (TZHEK) triangle of Economic Development of Kosovo (TED)
	qyteti i Gjilanit/ komuna Gjilan town/ municipality
	topografia topography
	rrafshinë plain
	sipërfaqet malore mountain areas
	lum / liqeni river / lake
	autostrada ekzistuese / e planifikuar motorway existing /planned
	rrugë magjistrale magistral road
	vendkalim kufitar border crossing
	hekurudha railway
	hekurudha e planifikuar planned railway
	korridori rrugor Pan-Europian Pan-European Transport Corridor
	aeroporti ndërkombtar / ushtarak international / military airport
	termocentraler /hidrocentraler coal-fired /hydroelectric powerplant
	minierë /koncentrim i industrisë mines / concentration of industry
	sella e qeverisë / universiteti seat of government / university
	banjë / qendra universitare klinike spa / university clinical centre
	bujqësia / vreshtaria agriculture / viticulture
	peisazhe atraktive /sporte dimërore attractive landscape/wintersport
	qytete të lashta /objekt fetar / lashtë historic cities/historical religious object

**Kuvendi Komunal Gjilan**  
Municipal Assembly Gjilan

**Plani zhvillimor komunal i Gjilanit**  
Municipal development plan of Gjilan

**Komuna e Gjilanit në Kosovë**  
Municipality of Gjilan in Kosovo

14.03.2008

Përpjesja: 1:650.000  
Scale: 1:650.000

Plan 1  
Plan 1


0 5 10 20 30 km

DIREKTORIA PER URBANIZEM, RINDERTIM DHE AMBENT  
THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT

TECH  
Municipal Engineering Office

WWU  
Wirtschaftsuniversität Wien

planungsgruppe 4





## Komuna e Gjilanit ne rajonin e Anamoravës

Komuna e Gjilanit shtrihet në pjesën juglindore të Kosovës, rajoni i Anamoravës, me një sipërfaqe prej 515 km<sup>2</sup>. Pozita e mirë gjeografike e komunës, i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit, njëherit i mundëson të jetë qendër e rëndësishme në trekëndëshin Gjilan-Preshevë-Kumanovë.

Komuna e Gjilanit kufizohet me:

- Në juglindje me Preshevën (33km) dhe Kumanovën (malet e Karadakut),
- Në lindje me Bujanovcin (40.5km),
- Në verilindje Dardanën (Kamenicën) (29km),
- Në jug ka Vitinë (20km),
- Në perëndim Lipjanin dhe Prishtinën (47km),
- Në verilindje me Artanën (Novobërdën), (19.5km).

## Karakteristikat morfologjike

Anamorava e Kosovës paraqet tërësinë gjeografike që e përbëjnë zonat e vogla të saj: Morava e Epërme, Izmorniku dhe Kriva Reka. Zona malore e Moravës së Epërme shtrihet në skajin jugor të Kosovës. Në juglindje dallohet zona e ulët e Moravës së Epërme. Ajo shtrihet në drejtimin jugperëndim - verilindje, dhe ndahet në pjesë të gjera Viti - Sllatinë, Partesh- Nosalë dhe Livoç. Baseni i Krivo Rekës shtrihet në pjesën e skajshme lindore të Kosovës.

## Karakteristikat Hidrografike

Ujërat nga ky rajon derdhen në pellgun e Detit të Zi. Pjesa më e madhe e ujit rrjedhë gjatë një periode të shkurtër kohore. Rrjedhje më të mëdha të ujit shfaqenë në mars, shkurt dhe në maj, kurse më të vogla në gusht dhe shtator. Lumi më i madh Morava e Binçës buron nën masivin e quajtur Bilak që është remb i Karadakut të Shkupit.



Fig. 5: Rrjeti Hidrografik i Komunës







### **Karakteristikat klimatike**

Rajoni i Gjiçanit ka një klimë mesatare kontinentale. Temperatura maksimale e ajrit është në muajin Gusht, kurse minimalja në Janar. Ditët e nxehta dhe ato shumë të nxehta shfaqen prej Prillit deri në Tetor, respektivisht prej majit deri në Tetor me dendësi mesatare vjetore prej 85,0 dhe 23,7 ditë

### **Lagështia e ajrit**

Vlera mesatare vjetore e lagështisë relative është 76,8%. Muaji më i thatë është gushti (66,2%), kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori (84,2%).

### **Reshjet**

Të reshurat mesatare në rajonin janë relativisht të vogla e që në Gjiçan arrijnë deri 583,4 [l/m<sup>2</sup>]. Në Gjiçan dhe Dardanë muaji më i thatë është gushti, me të reshura prej 27,6 dhe 23,5 [l/m<sup>2</sup>], kurse në viset malore të rajonit është shtatori, me 34,6 [l/m<sup>2</sup>],

Në Gjiçan dendësia vjetore e ditëve me borë është 21,9 ditë ose 6,0% të vitit, me ditën e parë mesatare -3 dhjetori, (më e hershmja 5 nëntori) dhe të fundit 2 prilli (më së voni 24 prill).

### **Erërat**

Në Gjiçan ( përveç kohës pa erëra (368 ‰)), erërat më të shpeshtë janë ato Veriore (N) me 226 ‰, e më të rrallat jugperëndimore (SW) me 27 ‰. Shpejtësia më e madhe mesatare e erës është e asaj jugore (S) (3,2 m/sec. kurse më e vogla - erërave më të rralla (SW) jugperëndimore (1,9m/sec).

### **Karakteristikat pedologjike:**

Relievi i Anamoravës së Kosovës nga aspekti gjeografik dhe ai morfologjik veçohet me zona bregore valore me lugina lumenjsh, që me veprimin e lumenjve dhe të përrenjve është ndarë në disa pllaja të vogla ose të mëdha dhe, zona e rajonit kodrinorë- malor, që nga aspekti gjeomorfologjik, gjenetik dhe ai klimatik dallohen në mes tyre.


### **Karakteristikat inxhinierë-gjeologjike të rajonit të Anamoravës :**

Rajoni i Anamoravës karakterizohet me një llojllojshmëri shumë të theksuar litostratigrafike dhe ka një përbërje të ndërlikuar tektonike të terrenit. Këtu janë të shprehura proceset e theksuara bashkëvepruese gjeologjike, të sjelljes së materialeve nga shpatina me formimin e sipërfaqeve të shpëlarjes së shpejtuar dhe të gërryerjeve, rrëqeve dhe



me dukuri të shumta të rrëshqitjeve dhe të shembjeve të dheut, të bartjes së materialeve sterile etj.

Fig. 6: Karakteristikat inxhinierë-gjeologjike të Komunës



Edhe pse Anamorava nuk është drejtpërdrejtë brenda zonës së Prishtinës, megjithëate kryeqyteti i Kosovës është gjithmonë i rëndësishëm për rajonin. Ka lidhje direkt nga Gjilani për në Prishtinë përmes dy rrugëve



të ndryshme magjistrale. Gjithashtu, ekzistojnë lidhje të ngushta ekonomike dhe kulturore ndërmjet rajonit të Anamoravës dhe zonën përreth Bujanovcit dhe Preshevës në Serbi dhe Kumanovës në Maqedoni.

Gjilani është qendra kryesore në Anamoravë. Është një nga qytetet më të mëdha në rajon dhe ka përqendrimin e funksioneve qendrore për administratë, edukim, kujdes shëndetësor dhe kulturë për komunën. Gjilani gjithashtu është qendër ekonomike për rajonin, me përqendrimin e industrisë, bujqësisë dhe tregtisë.

Komunat në afërsi të Gjilanit në rrafshin e Anamoravës, nuk kanë rëndësi të madhe ekonomike dhe nuk kanë numër të madh të banorëve. Një ndër qendrat klimaterike më të rëndësishme të Kosovës është e vendosur në Kllokot në Komunën e Vitisë, pjesa perëndimore e Gjilanit. Ekziston një Fabrikë Birre në Kamenicë. Artana, në zonën malore të pjesës veriore të rrafshit të Anamoravës ka një histori që prej kohesh si qyteti për shfrytëzimin e minierave.

Autostrada e planifikuar Nish – Tiranë nuk do të kalojë përmes Anamoravës. Lidhja më e afërt është e planifikuar në Shtime, afërsisht 50km nga Gjilani. Rruga për transportin më të afërt ndërkombëtar është korridori transportues Pan-Evropian X përmes Serbisë. Kjo rrugë vetëm pjesërisht e ka standardin e autostradës, por është shumë e rëndësishme për lidhje me rrjetin e transportit evropian .

Ekzistojnë dy rrugë magjistrale që kalojnë nëpër rajon; M25-2 dhe M25-3. M25-2 e lidh Preshevën që gjendet në Serbi me Prishtinën. M25-3 e lidh Bujanovcin që gjendet gjithashtu në Serbi me Ferizajn. Këto dy rrugë magjistrale kryqëzohen njëra me tjetrën në Gjilan. Të gjitha rrugët magjistrale në rajon janë të asfaltuara., edhe pse krahasuar me rrugët e shteteve evropiane, asfaltimi është i një cilësie me të ulët.

Qytetet dhe fshatrat në rajon janë të lidhura nga një rrjet i rrugëve rajonale. Disa nga rrugët rajonale janë të asfaltuara, por shumica prej tyre janë në gjendje jo të mirë- rrugë më cilësi të dobët .

Nuk ka hekurudhë në Anamoravë. Linjat më të afërta janë në Bujanovc dhe Preshevën në lindje dhe Ferizaj në perëndim. Në “Planin Hapësinor të Kosovës” ekzistojnë planet që të ndërtohet një linjë hekurudhore nga Ferizaj për Bujanovc , përmes Gjilanit.





Gjilani ka pozitë të mirë për tu zhvilluar në Rajon, por gjithashtu ka edhe disa mangësi në krahasim me pjesët tjera të Kosovës. Komuna ka leverdi nga komunikimi i mirë dhe përforcimi i bashkëpunimit me vendet fqinjë.

**S****përparësitë**

- Qendër e rajonit të Anamoravës,
- Koncentrimi i administratës, industrisë dhe institucioneve qendrore të qytetit të Gjilanit,
- Lidhje të mira me qytetet tjera brenda dhe jashtë Kosove.

**W****dobësitë**

- Nuk ka hekurudhë,
- Pjesërisht standard i ulët i rrugëve.

**O****mundësitë**

- Pozita e Gjilanit si qendër e rajonit të Anamoravës duhet të përforcohet,
- Lokacioni ndërmjet rrafshit të Fushë Kosovës dhe kufirit me Maqedoninë dhe Serbin janë të përshtatshme për të siguruar kushte të mira për Tregti.

**T****kërcënimet**

- Burimi i limituar për zhvillim në Kosovë është i koncentruar në rrafshin e Fushë Kosovës.

**→****Çështjet**

- Konsolidimi i Gjilanit si qendër e Anamoravës,
- Kooperimi ndër komunal në mes të Gjilanit dhe Ferizajt,
- Kooperimi ndërkufitar në mes të Gjilanit, Preshevës dhe Kumanovës.

	kufiri shtetevë fqinje	neighbour national border
	kufiri i Republikës Kosovës	public of Kosovo border
	kufiri i komunës dhe dendira	municipality and cadastral boundary
	komuna e Gjilanit	municipality of Gjilan
	zonat e ndërtuara	built-up areas
	topografia	topography
	pyll	forest
	lumi / liqeni	river / lake
	autostrada planifikuar	planned motorway
	rrugë magjistrale	magistral road
	rrugë rajonale	regional road
	vendkalim kufitar	frontier crossing
	hekurudha, ekzistuese / e planifikuar	railway, existing / planned
	korridor i rrugor Pan-Europian	Pan-European Transport Corridor
	aerodrom / stacioni i trenit	airport / train station
	rrugë e planifikuar / termocentralet	planned motorway/connection / powerplant
	minierat në funksion / jashtë tij	mines, working / not working
	industria, ushqimore / koncentrim i industrisë	food industry / concentration of industry
	sella e qeverisë / universiteti	seat of government / university
	qendra klinike universitare / spitale	university hospital / regional hospital
	gjyqi i qarkut / institucion kulturor	district court / cultural institutions
	bujqësi / banjë	agriculture / spa
	bazë e rëndësishme e KFOR-it / numri i peratër / banorëve	important Kfor-base / estimated number of inhabitants
	rajonet	regions
	zona e aglomeratave e Prishtinës	Prishtina Agglomeration area

**Kuvendi Komunal Gjilan**  
Municipal Assembly of Gjilan

**Plani zhvillimor komunal i Gjilanit**  
Municipal development plan of Gjilan

**Pozita në rajon**  
Situation Region

14.04.2008


Përpjesja:   
Scale: 1:100,000

Plan 2  
Plan 2

DIREKTORIA PER URBANIZEM, RINDERTIM DHE AMBENT  
THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT

ITCHE IWU

**planungsgruppe 4**





## 1.2 VLERËSIMI I GJENDJES NË KOMUNË

### 1.2.a DEMOGRAFIA DHE QESHTJET SOCIALE

#### Popullsia-Gjendja

Baza e të dhënave mbi popullsinë në Kosovë si tërësi, si dhe mbi popullsinë e qytetit dhe Komunës së Gjilanit, në veçanti, është relativisht e pandryshueshme. Regjistrimi i përgjithshëm i fundit në Kosovë ka qenë në vitin 1991, dhe të dhënat e prezantuara janë treguar të pasigurta. Regjistrimi i përgjithshëm më i sigurt daton nga viti 1981 dhe 1971<sup>2</sup>. Megjithatë, ato të dhëna nuk mund të merren si baza të mjaftueshme për ta vlerësuar zhvillimin e popullsisë mes asaj kohe dhe të tanishmes. Një regjistrim i ri i përgjithshëm mund të pritet më së shpejti në fund të vitit 2006<sup>3</sup>. Kështu që çfarëdo prognoze në lidhje me zhvillimin e popullsisë mund të jetë i bazuar vetëm nga këto vlerësime dhe llogaritje. Duke qenë plotësisht të vetëdijshëm mbi mungesat e bazës së të dhënave, edhe pse prognozat e zhvillimit të popullsisë janë esenciale për çfarëdo planifikimi strategjik, prognozat e prezantuara më poshtë mund të merren si të përkohshme dhe duhet të përmirësohen menjëherë kur të jenë të gatshme të dhënat e sakta.

Vet fakti se, zhvillimi i ardhshëm i popullatës në Kosovë gjithashtu edhe në Gjilan, varët nga shumë faktor si ai ekonomik, shoqëror, dhe politik, nuk mund të parashihen mirë pa të dhënat e duhura statistike, të cilat janë të nevojshme për përcaktimin e një koncepti adekuat të planifikimit hapësinor, për një plani urbanistik të qëndrueshëm i cili mund të zbatohet hap pas hapi për nevojat përkatëse për banim, tregti ose edhe ndërtimeve publike gjatë kohës.

<sup>2</sup> „...për shkak të ngjarjeve të historisë së fundit dhe nga vet fakti se nuk ka pasur regjistrim të përgjithshëm të popullsisë që nga viti 1981, dhe sistemi i regjistrimit civil nuk është i freskët, praktikisht është e pamundur që të jepen të dhëna absolute të sakta për numrin e popullsisë (të Kosovës) si tërësi ose pjesët e saj përbërëse (...).“cit.: Ara e Statistikave të Kosovës: Statistikat e Tregut të Punës 2004, Seria e 5: statistikave Sociale; p.13

<sup>3</sup> Draft ligji për regjistrimin e përgjithshëm ishte dërguar në Kuvendin e Kosovës më Maj të vitit 2003 dhe është aprovuar nga Kuvendi më 11, Korrik 2003. Megjithatë, në ligj, nuk është dhënë data se kur do të bëhet regjistrimi i përgjithshëm. Kjo duhet të vendoset nga Kuvendi. Ligji për regjistrimin e përgjithshëm ishte shpallur me disa amendamente më 13 Dhjetor të vitit 2004 nga PSSP-ja (cf. SOK.org as of 10/02/06).faza e parë testues për regjistrimin të përgjithshëm është mbajtur në gjashtë komuna dhe është përfunduar në mes të Nëntorit të vitit 2005. pritej se, regjistrimi i përgjithshëm do të mbahet në fund të vitit 2006 ose fillim të vitit 2007.





Vlerësimi i shtimit të popullsisë së Kosovës i bërë nga OSBE-ja (2000) është një nga vlerësimet më të përafërta. Ai është i bazuar në një argumentim të shtimit të madh të popullsisë, i njohur nga dekada 1981 deri 1991 rreth 23 për 1000 persona ose përafërsisht 2% e shtimit vjetor të popullsisë. Vlerësimet tjera i marrin parasysh një nivel më të vogël të shtimit të popullsisë. Shifrat e paraqitura nga UNMIK-u në vitin 2002 (ESTAP) p.sh janë të bazuar në një shkallë të rritjes së reduktimit të popullsisë prej 1,1% për çdo vit, e cila është rreth gjysmë shkalle e rritjes, e supozuar nga OSBE-ja. Sipas të dhënave të paraqitura nga statistikat jetësore (Vital) (SOK 2004) shkalla e lartë e lindjes (i gjallë) në vitin 2003 ishte 13.2 për njëmijë dhe vlera e shtimit natyral ishte 10,5 për njëmijë. Këto të dhëna kanë parashikuar se Kosova ka pasur në këtë periudhë j rreth 1.860.000 banorë.

Të dhënat e sigurta janë vetëm në paraqitjen strukturore të popullsisë, jo nga numri i tyre, që janë siguruar nga analizat e poshtëshënuara:

- "Analiza Demografike Socio-ekonomike dhe shëndetësore 1999 / 2000" që është kryer me rreth 7.300 kryefamiljar dhe 41.0000 persona (SOK/UNPF/IOM 2000),
- Analiza e Masës së Standardit Jetësor (LSMS) që i siguron të dhënat bazë për vlerësimin e varfërisë , studim i vitit 2000 (Banka Botërore 2001)
- Sistemi i Statistikave Jetësore (SOK 2004) bazuar në të dhënat mbi lindje, vdekjet dhe martesat (i organizuar përsëri në vitin 2001),
- "Analiza Demografike dhe shëndetësore e Kosovës 2003" (SOK 2004) që i mbulon shembullin e përfaqësimit të rreth 3.200 shtëpiakëve me rreth 19.500 banorë, duke u barazuar në rreth 1% të popullatës Kosovare dhe
- "Analiza e fuqisë punëtore (LFS) e vitit 2004" (SOK 2005) – duke e arritur suksesin e analizës së vitit 2001, 2002 dhe 2003 – i kryer me rreth 3.200 kryefamiljarë dhe 19.900 persona.

Në bazë të të dhënave të siguruara nga këto analiza, mund të krijohet një pasqyrë më reale e zhvillimit dhe shtimit të popullsisë. Të dhënat mbi moshat grupe të gjinive, shkalla e lindjes, dhe informatat mbi migrimin, mund të sigurohen nga këto analiza: (SOK/UNPF/IOM 2000; VSS dhe DHS, SOK 2004). Këto të dhëna të specifikuar janë përfshirë në llogaritjen e prognozave për zhvillimin e popullsisë, (Tab.!) Megjithatë, studimet e përmendura, nuk mund ti zëvendësojnë të dhënat e sigurta mbi regjistrimin e përgjithshëm, të mirave materiale dhe nevojave për banim të popullatës.



Tab. 1: Të dhënat mbi popullsinë e Gjilanit dhe Kosovës

#	Burimi i të dhënave	Numri i banorëve		Bazat	
		Zona urbane	Komuna		
1	SOK 1981 <sup>/1/</sup>		84.085	1.584 440	Të dhënat nga regjistrimi i përgjithshëm të vlerësuara si të sigurta
2	SOK 1991 <sup>/2/</sup>		103.675	1.956.000	Të dhënat nga regjistrimi i fundit i përgjithshëm, të vlerësuara si të sigurta
3	OSCE 2000		90.870	2.364.000	Shkalla e argumentimit të shtimit të mëparshëm natyral në Kosovë 2%/ vit (1981 ff)
4	UNMIK 2002 <sup>/3/</sup>			2.073.000	Vlerësimi për 2.000
5	UNMIK 2002 <sup>/4/</sup>			1.960.000	Vlerësimi për 2.001
6	Buxhet 2003 <sup>/5/</sup>			1.860.000	
7	ESI <sup>/6/</sup>			1.700.000	Vlerësimi për 2004, indikator të ndryshëm specifik
8	Komuna e Gjilanit	79.000	139.558		Vlerësimi i vitit 2002
9	Komuna e Gjilanit		133.724		Vlerësimi i vitit 2002
10	Zyra e regjistrimit UNMIK		129.690		Vlerësimi në Gusht 2003
11	Komuna e Gjilanit	83.962	140.523		Argumentimi i vlerësimit të vitit 2002 deri 2005

**Burimet** :/1/ Kosova dhe popullsia e saj. Përshkrim i shkurtër (SOK 2003)

/2/ Kosova dhe popullsia e saj . Përshkrim i shkurtër (SOK 2003); Popis '91 (FRY/FSO 1993)

/3/ ESTAP (UNMIK 2002); nevojat për energji elektrike, draft raporti, Prill 2002; pp. 22, 24

/4/ ESTAP (UNMIK 2002); ESTAP përmbledhje ekzekutive; raporti i fundit , Shtator 2002; p. 14

/5/ Bazuar në të dhënat nga shumë burime (SOK, RIINVEST, Regjistri Civil i Kosovës et al.) që përfshinë rreth 190.000 të cilët lëvizin mbrapa dhe përpara ndërmjet Kosovës dhe jashtë vendit (Qeveria e Kosovës 2003; 2)

/6/ Vlerësuar nga zyrtarët ESI

/7/ Baza e të dhënave Komunale (2002)

/8/ Burimi: Instituti Kombëtar I Shëndetit Publik, Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim;

Zyra Rajonale për Statistikë-Gjilan;

Përpunoi: Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-Gjilan (2006)



## Numri dhe përbërja e banorëve në Gjilan

Për vitin 2002 Komuna e ka paraqitur një vlerësim se ka gjithsej 139.558 banorë, ku 79.000 në qytetin Gjilanit dhe 60.558 në fshatra. Në Gusht të vitit 2003 sipas të dhënave zyrtare të UNMIK-ut, komuna e Gjilanit ka pasur 129.690 banorë, pjesa më e madhe prej 116.000 Shqiptar Kosovarë (89,4%), 12.000 Serb Kosovar (9,5%), rreth 350 Romë (0,2%) dhe 1.005 banor tjerë (0,8%) (Profili Komunal i OSBE-së për Gjilanin, Shkurt 2005). Vlerësimi i fundit është i bazuar në burime të ndryshme, duke përfshirë të dhënat nga UNHCR, IOM, OSBE, HLSP-DIFID, OJQ dhe tjera, në vitin 2005, numri i banorëve në komunë rritet dhe është 140.523 banor banorë.

Tab. 2: Zhvillimi i Popullsisë në Gjilan dhe përbërja Etnike

Popullsia	Numri i Shqiptarëve Kosovar		Numri i serbëve në Kosovë		Numri i Romëve		Tjerët		Numri total	
		%		%		%		%		%
1981	59.764	71,1	19.212	22,8	3.347	4	1.762	2,1	84.085	100
1991	79.357	76,5	19.370	18,7	3.477	3,4	1.471	1,4	103.675	100
Gusht 2003	116.000	89,4	12.300	9,5	350	0,2	1.005	0,8	129.690	100

**Vërejtje:** Përfshirë Personat e Zhvendosur nga Brenda

**Burimi:** OSBE 2005:

Për regjistrimin e përgjithshëm të vitit 1981 dhe 1991 ;Zyra Federale e Statistikave në Beograd

Për vitin 2003: UNMIK Gjilan /Gnjilane

## PARASHIKIMI I POPULLSISË PËR VITIN 2020

### Zhvillimi i Popullsisë

Zhvillimi i popullsisë bazohet në dy komponentë :


- Shtimi Natyral dhe
- Migrimi,

Shtimi natyror dhe migrimi mundën me qenë pozitive dhe negative. Zhvillimi natyral i popullsisë mund të vlerësohet në mënyrë më të saktë, kur për kushte të zhvillimit normal, shkalla e lindjes ndryshon jashtëzakonisht ngadalë gjatë kohës. Për kushtet e Kosovës megjithatë, periudhat e luftës dhe proceset e migrimit të shkaktuara nga lufta, kanë lënë gjurmët e tyre në shtimin e popullsisë. Gjatë kësaj periode është vërejtur rënie e moshës mesatare të popullsisë dhe zvogëlim të shkallës së shtimit të saj (Ministria e Shëndetësisë 2003; 8). Zvogëlimi i



shkallës së shtimit të popullsisë mund të realizohet më shtimin e zvogëluar të popullsisë së Kosovës nga moshat grupore prej njëzet vjet e teposhtë. Procesi i migrimit i shkaktuar nga lufta ka rezultuar veç kësaj në pasigurinë e të dhënave për një numër të qëndrueshëm të popullsisë. Një pjesë e rëndësishme e refugjatëve që e kanë lënë Kosovën për të dal jashtë vendit, janë kthyer, por është e paqartë se ku do ta gjejnë ata vendin e tyre për të qëndruar në Kosovë. Megjithatë paqartësitë e tilla shpresojmë se do të evitohen me definimin e statusit final të Kosovës.

Fig. 7: Piramida e popullsisë së Kosovës



### Shtimi Natyrorë

Numrat mbi lindjet dhe vdekjet në Kosovë për periudhën prej 1988 deri 2003 tregojnë se, shkalla e lindjeve është duke rënë në mënyrë domethënëse, në së paku 23,0 lindje të gjalla për 1.000 banor. Shtimi natyral i viteve të mëparshme “është rezultat i zhvillimit të ulët ekonomik dhe social në Kosovë“, aktivitetet e nivelit të ulët ekonomik dhe papunësia, në veçanti e grave, niveli i ulët i standardit, pozita e gras në shoqëri dhe familje (burimi)” (RIINVEST 2004).

Tab. 3: Shkalla e lindjeve në Kosovë

Periudha	Shkalla e lindjeve
1988 – 1993	27,0
1993 – 1998	24,9
1998 – 2003	23,0



**Burimet :** Analiza Demografike dhe Shëndetësore e Kosovës 2003 / KDHS 2003 (SOK 2004) p. 54 Shkalla e vdekjes është nxjerr nga të dhënat e njëjta eksperimentale ku janë të përfshira edhe 5,3 fatkeqësi për 1000 banorë. Shembulli është bazuar për personat që kanë vdekur në shtëpi gjatë vitit të fundit. Duke marrë në konsideratë informata shtesë, numri megjithatë është më i madh, së paku 6 ose edhe afër 7 (KDHS 2003 / SOK 2004). Si pasoj, shtimi natyral vjetor në Kosovë mund të jetë 16 për 1.000 banor. Një shkallë e shtimit prej 13 për 1.000 banorë, është e dhënë nga MMPH-ja (2004; 8).

Në vitin 2004 numri i lindjeve në Gjilan ishte 1.790 dhe numri i vdekjes 433 (Statistikat jetësore; SOK 2004; Tabela. 1.17 dhe 2.11) kështu që rritja nga shtimi natyral ishte 1.357 persona në atë vit. Duke iu referuar popullsisë së 138.219 banorëve në Gjilan në vitin 2003, mund ti përgjigjet shtimit të popullsisë prej 9.8 persona për 1.000 banorë në atë vit. Megjithëse shifrat e aprovuara vetëm për pak viteve nuk mund të jenë bazë e sigurt për ta definuar shkallën e shtimit të popullsisë. Këto shifra megjithatë e reflektojnë tendencën e rënies së shtimit të madh të mëparshëm të popullsisë në Kosovë.

Tab. 4: Shkalla e Shtimit të Popullsisë në Gjilan

	Viti	Statistikat jetësore	1/1000 <sup>1/</sup>	Përqindja <sup>2/</sup>	Shkalla
Popullsia			133.724		
Lindjet		1.906	14,3		Shkalla e lindjes
vdekjet		373	2,8		Shkalla e vdekjes
	<b>2002</b>	<b>1.533</b>	<b>11,5</b>	<b>1,146</b>	<b>Shkalla e shtimit</b>
Popullsia			135.953		
Lindjet		1.648	12,1		Shkalla e lindjes
Vdekjet		429	3,2		Shkalla e vdekjes
	<b>2003</b>	<b>1.219</b>	<b>9,0</b>	<b>0,897</b>	<b>Shkalla e shtimit</b>
Popullsia			138.219		
lindjet		1.790	13,0		Shkalla e lindjes
vdekjet		433	3,1		Shkalla e vdekjes
	<b>2004</b>	<b>1.357</b>	<b>9,8</b>	<b>0,982</b>	<b>Shkalla e shtimit</b>



**Shënim:** /1/ Shtimi natyral i popullsisë: Banor shtesë për 1.000 banor të atij viti  
/2/ përqindja e popullsisë të atij viti sipas treguesve

**Burimet:** vlerësimi i popullsisë i vitit 2002 ff.: Instituti Kombëtar I Shëndetit Publik,  
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim; Zyra Rajonale për Statistikë-Gjiçan;  
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-Gjiçan;  
vdekjet dhe lindjet: Statistikat jetësore të Kosovës 2002, 2003, 2004 (SOK 2004, 2005);  
shkallët: llogaritjet IWU

Zhvillimi i kontrolluar i lindjeve në Kosovë, p.sh. shkalla e shtimit natyral, është bazë e rëndësishme e sigurisë së prognozave mbi shtimin popullsisë. Sa për llogaritje, është përdorur shkalla e shtimit natyral të tanishëm. Rezultatet e llogaritura mund ta përfshinë një mbivlerësim të zhvillimit të popullsisë nga parashikimi prej 15 viteve të ardhshme.

## Migrimi

Duke e marr parasysh perspektiven e paqartë të ekonomisë në Kosovë dhe në veçanti zhvillimin ekonomik në komunën e Gjiçanit, është e vështirë që të identifikohet balancimi i migrimit në Gjiçan dhe jashtë tij. Sipas shifrave të dhëna për migrim, të dhëna nga Analiza Demografike dhe Shëndetësore të vitit 2003 (SOK 2004) për shtat rajone<sup>4</sup>, balancimi i migrimit brenda Kosovës ishte pozitiv në kuptimin e plotë vetëm në rajonin e Prishtinës.

<sup>4</sup> Gjakovë, Gjiçan, Mitrovica, Peja, Prizren, Prishtina dhe Ferizaj; regjioni i Gjiçanit përfshin Kamenicën dhe Novobërdën

Fig. 8: Rajonet e analizuar për balancimin e tyre të migrimit



Burimi: UNFPA/SOK/IOM 2000


Të dhënat për migrimin janë mbledhur për migrimin e tërë jetës, (personat që kanë lindur në një komunë tjetër dhe janë shpërngulur në vendin e tanishëm në cilëndo kohë të jetës deri më sot,) dhe migrimet e brendshme pesë vjeçare (p.sh. migrimet në vendet e tanishme gjatë pesë viteve të fundit, të dhënat e mbledhura për të gjithë personat pesë vjeç dhe më të vjetër). Nuk duhet të harrohet se, në krahasim me faktorët ekonomik, efektet e shtypjes etnike, trazirat civile dhe lufta në dekadën para viti 2000, kanë shkaktuar migrim domethënës i cili është pasqyruar në shifrat e mbledhura nga SOK. Meqenëse kushtet për të ardhmen në këtë aspekt janë të tjera, është e pamundur të nxirret evidenca për të ardhmen nga shifrat e dhëna nga SOK, mbi migrimin në Kosovë. Por megjithatë ato mund të japin orientim të sigurt për këtë fenomen.

Tab. 5: Balancimi i migrimit

Rajoni i lindjes	Neto Migrimi përfundimtar i jetës deri në vitin 2003	
<b>Renditja e rajoneve</b>		<b>Neto migrimi vjetor i gjallë periudha pesë vjeçare 1998 – 2003</b>
Gjiçan	- 9.400	+ 300
Gjakovë	- 9.400	- 2.100
Mitrovica	- 6.700	- 6.200
Peja	+ 7.800	+ 3.300
Prizren	- 5.400	+ 500
Prishtina	+ 22.500	+ 7.000
Ferizaj	+ 600	- 2.800

Burimi: Analiza Demografike dhe Shëndetësore / KDHS 2003 (SOK 2004)

Fig. 9: Rajonet e analizuar për balancimin e tyre të migrimit



Në rajonin e Gjilanit, shtimi i popullatës është ndër më të lartat në Kosovë. Megjithatë, ka pasur një rritje të popullsisë në periudhën prej vitit 1998 – 2003, ngase rajoni nuk ka pasur vuajtje nga lufta aq sa kanë pasur rajonet tjera, dhe si pasoj ky rajon i ka tërhequr refugjatët nga zonat e luftës.

Shtimi i 300 personave nga migrimi që kanë ardhur në rajonin e Gjilanit- në periudhën pesë vjeçare 1998 – 2003 nuk mund të jenë bazë për identifikimin e arsyes për migrim. Megjithatë, shqetësimi i



jashtëzakonshëm politik dhe ndryshimet fundamentale ekonomike që e shënojnë këtë periudhë, nuk e lejojnë që thjesht të rriten shifrat e shtimit të popullatës në të ardhmen. Rritja e popullsisë nga migrimi, megjithatë nuk është shumë i kënaqshëm. Por sot askush nuk e din se si do të zhvillohet migrimi në të ardhmen.

Migrimit nga komuna e Gjilanit në rajonet me ekonomi më të zhvilluar, është sepse popullata mund të kërkojnë dhe gjejnë punë më lehtë jashtë vendbanimit, p.sh. në zonën e Prishtinës dhe rreth saj, zonë më e zhvilluar ekonomikisht. Megjithatë, ata nuk mund të lëvizin brenda Kosovës pa ofertë të qartë për punë, dhe më shumë shpresë për të gjetur një punë më të lehtë tjetërkund. Shifrat e fundit nga IES (Iniciativa Evropiane për Stabilitet) bazuar në studimet relevante në komunitetet e vogla e përforcon këtë supozim. Këto shifra tregojnë se njerëzit pa punë kanë përfitim nga rrjeti i të afërmeve në shtëpinë e tyre në fshat ose në qytet. Gjithashtu është supozuar se orientimi i bizneseve në Kosovë është më tepër lokal, dhe kështu ata preferojnë më shumë që të zhvillojnë biznese në vendet e caktuara sesa të shikojnë për të kërkuar punë shumën vende qendrore. Si pasojë, migrimi në rajonin e Prishtinës nuk mund të motivohet vetëm nga se është qendra kryesore e Kosovës. Vetëm zhvillimi i biznesit aty dhe mundësit aktuale për punë mund ti stimulojnë ose tërheqin migrimin e motivuar ekonomik.

Nëse, një shtim ekonomik mund të ndodh në Gjilan, nuk garanton të tërheq imigrimin substancial. Imigrimi i tillë mund të jetë vetëm një rast se bëhen investime të mëdha industriale në Gjilan, dhe si pasoj krijohen mundësi të punësimit që mund ta tejkaloj kapacitetin e fuqisë punëtore në qytet, në sasi dhe profesion, pra në rast të përparimit të përgjithshëm ekonomik. Rajonet tjera në Kosovë mund ta provojnë një zhvillim të përshtatshëm ekonomik krahasuar me rajoni e Prishtinës. Me këtë rast shkalla e lartë e papunësisë dhe e punësimit të pjesshëm duhet të merren në konsideratë. Kjo mund të pritët që në një periudë kohore me të gjatë, fuqinë punëtore në Gjilan do të mund ti absorboj, në shumicën e rasteve, kompanitë lokale që krijohen, më rastin e një zhvillimi më të madh ekonomik

Për më tepër, zgjidhja e statusit të ardhshëm të Kosovës, si entitet i pavarur politik dhe i anëtarësuar në BE, do të mundësoj migrim më të madh. Kjo mund ta hap rrugën për një shtim të migrimit jashtë vendit ku kërkohet fuqia e lirë e punëtorëve dhe akomodimi i familjeve të tyre.





Duke e marr parasysh këtë zhvillim të ekonomik të komunës së Gjilanit, kemi supozuar një balancim negativ të migrimit, duke qenë më shumë si balancë i përshtatshëm, se sa migrimi pozitiv, pa i ditur, llogaritur, përmasat e mundshme të migrimit të jashtëm. Brenda limiteve të komunës, ne presim lëvizjen e njerëzve që jetoj nëpër fshatra për në qytet, të cilët provojnë që të fitojnë për jetesën e tyre aty. Ky migrim i brendshëm nuk mund të llogaritet pasi që të dhënat substanciale nuk janë të gatshme.

Për balancimin e migrimit të komunës së Gjilanit janë llogaritur tri alternativa:

1. Një barazim i balancimit të migrimit,
2. Një migrim i jashtëm i 100 personave për një vit ose 0,7 persona për 1,000 banorë,
3. Një migrim i jashtëm i 250 personave për një vit ose 1,8 persona për 1,000 banor.

Llogaritjet janë bërë në bazë të të dhënave mbi popullsinë në tërë komunën, si të dhëna detale (mosha grupore dhe proporcioni i gjinisë) për qytetin e Gjilanit ose vetëm kur nuk janë të gatshme. Efekti numerik i migrimit ishte kombinuar me të dhënat nga shtimi natyral të Gjilanit. Numri i banorëve për vitin bazë 2002 është marr nga baza e të dhënave të komunës: 139.558. Zhvillimi i popullsisë është shpërndarë ndërmjet qytetit dhe fshatit në proporcionin e dhënë për 2002 (79.000 deri 40.588).

## Llogaritjet

Për parashikimin e zhvillimit të popullsisë është aplikuar metoda biometrike. Moshat grupore për çdo vit të vetëm janë përfshirë në llogaritje vit pas viti bazuar në të dhënat si në vijim: lindjet, vdekjet, fitimet nga migrimit, humbjet nga migrimi. Metoda mund të përshkruhet nga formula në vijim:





Fig. 10: Formula për llogaritje

Formula e llogaritjet; numri i lindjeve në vitin e parë ( $a=1$ ):

$$B_m(a)_{t+1} = G_m t+1$$

Duke qenë

$$G_m t+1 = \sum_{a=1}^{45} B_w(a)_t * f_q(a)_t * q_{sex}$$

Formula e llogaritjeit; numri i lindjeve në vitet në vijim ( $a=2$  deri në 100):

$$B_m(a)_{t+1} = B_m(a)_t * (1 - S_m(a)_t) + Z_m t * q_{zm}(a)_t - (B_m(a)_t * q_{fm}(a)_t)$$

$$B_w(a)_{t+1} = B_w(a)_t * (1 - S_w(a)_t) + Z_w t * q_{zw}(a)_t - (B_w(a)_t * q_{fw}(a)_t)$$

**Burimi:** IWU

**Shpjegimet e simboleve:**

$B_m(a)_t$  = proporcioni i gjinisë mashkullore i moshës grupore në vit  $t$

$B_w(a)_t$  = proporcioni gjinisë femërore i moshës grupore në vit  $t$

$B_m(a)_{t+1}$  = proporcioni i gjinisë mashkullore i moshës grupore  $a$  në vit  $t+1$

$B_w(a)_{t+1}$  = proporcioni i gjinisë femërore të moshës grupore  $a$  në vit  $t+1$

$G_m t+1$  = lindjet e gjinisë mashkullore në vit  $t+1$

$q_{sex}$  = faktorët për proporcionin e gjinisë

$S_m(a)_t$  = mundësia e mortalitetit të moshës së burrit  $a$  në vit  $t$

$S_w(a)_t$  = mundësia e mortalitetit të moshës së gruas  $a$  në vit  $t$

$Z_m t$  = imigracionet e personave të gjinisë mashkullore në vit  $t+1$

$Z_w t$  = imigracioni i personave të gjinisë femërore në vit  $t+1$

$q_{zm}(a)_t$  = proporcioni i burrave të imigruar të moshës së  $a$  i të gjithë burrave të imigruar

$q_{zq}(a)_t$  = proporcioni i gruas të imigruar të moshës  $a$  i të gjitha grave të emigruara

$q_{fm}(a)_t$  = mundësia e emigracionit të burrit të moshës  $a$  në vit  $t$

$q_{fw}(a)_t$  = mundësia e emigracionit të gruas të moshës  $a$  në vit  $t$

Si bazë për llogaritjet e mëtejshme është marr vlera bazë prej 139.558 banor në vitin 2002 e dhënë nga Komuna e Gjilanit si një vlerësim i atij viti. Në këto të dhëna nuk ekzistojnë informata analitike të mëtejme. Kështu që ndarja e moshave grupore prej pesë viteve dhe gjinia është bërë duke ju referuar të dhënave dhe proporcioneve të prezantuara nga IOM 2000<sup>5</sup>. Ndarja e mëtejme e grup moshave dhe gjinisë nga të

<sup>5</sup> Organizata Ndërkombëtare për Migrim / IOM: "Hulumtimi Demografik, socio-ekonomik dhe Shëndeti reprodaktiv në Kosovë". Rezultatet themelore. Maj 2000; tab. 36, f. 81g;



dhënat pesëvjeçare në ato vjetore, është vlerësuar sipas mënyrës së llogaritjeve empirike Gjermane (bazuar në rajone, qyteti me fshatra, duke ju referuar situatës në Komunën e Gjiçanit).

Për parashikimin e lindjeve janë përdorur shkallët e lindjes, të ndryshuara me moshat e nënave. Përderisa këto të dhëna nuk ishin të gatshme për Gjiçanin, është aplikuar shkalla e lindjes së Gjermanisë Perëndimore, e që është adoptuar në bazë të shifrave të lindjeve të gjalla në Gjiçan të dokumentuara nga të dhënat në Statistikat Jetësore të Kosovës (SOK 2004).

Parashikimi i mortalitetit është i ngjashëm e i bazuar në shkallën e mortalitetit të Gjermanisë Perëndimore, duke qenë i ndryshëm për gjininë dhe moshat grupore një vjeçare. Për ta adoptuar gjasën e mortalitetit në Gjiçan, niveli i mortalitetit është korrigjuar, respektivisht është adoptuar me shifrat e Gjiçanit të bazuara në Statistikat Jetësore të Kosovës (SOK 2004).

**S**

## Përparësitë

- Shtimi natyral i popullsisë ka qenë shumë i lartë në të kaluarën. Megjithatë, gradualisht ka zbritur në dekadat e fundit, por krahasuar me vendet tjera në rajon, është ende i lartë.

**W**

## Mangësitë

- n/a.

**O**

## Mundësitë

- Edhe pse me një rënie substanciale të banorëve do të përballet në vitet që vinë, popullsia në Gjiçan ende është duke u rritur.

**T**

## Kërcënimet

- Gjendja e dobët e ekonomisë lokale, dhe mungesa e shkallës së lartë të prodhimit të industrisë së mëparshme, ka shkaktuar zvogëlimin e mundësive për punë, që mund ta detyroj pjesën substanciale të popullsisë aktive që ta lënë Gjiçanin ose edhe Kosovën, për ta fituar jetesën e tyre diku tjetër .

**→**

## Çështjet

- Rritja e popullsisë është një sfidë për komunën që të kujdeset për të krijuar kushte të përshtatshme të jetës, në Gjiçan, që popullata e komunës të punoj dhe jetoj në vendlindje.
- Prioritet i parë është mbështetja e zhvillimit ekonomik,



- veçanërisht të SME-së, që mund të ketë efekte të fuqishme në krijimin e vendeve të reja të punës .
- Kërkesat e ardhshme për infrastrukturë sociale dhe teknike, duhet të parashihen dhe duhet të sigurohen.

## Banimit-Gjendja

### Numri i Familjeve

Ekzistojnë shumë paqartësi rreth numrit të familjeve në Gjilan. Nuk ka të dhëna aktuale të sigurta që janë të sakta për këto familje. Duke i marr parasysh pasojat e shkatërrimit gjatë luftës, dhe rindërtimet e viteve të para të pas luftës, pa leje të ndërtimit dhe ato urbanistike, regresi i të dhënave të vjetra mund të jetë edhe më çorientues. Deri më tani janë të gatshme vetëm të dhëna shumë të përgjithësuara për situatën e tanishme që janë nxjerr nga disa analiza, dhe në shumicën e rasteve janë të bazuara në vlerësime ose edhe i referohen Kosovës si tërësi.

Tab. 6: Të Dhëna të përgjithshme mbi Personat për Vendbanim dhe Sipërfaqe të Banimit në Kosovë

Burimi i të dhënave		rural	urban	Kosovë
<b>Banka Botërore 2003</b>	Persona për Familje	7,1	6,1	6,7
<b>DHS 2003</b>	Persona për familje	6,8	5,5	6,4
<b>ESTAP 2002</b>	Persona për familje 2001			5,4
	Vlerësimi 2015 (shtimi i i lart/mesëm/i ulët )			4, 0 / 4,5 / 5,0
<b>IWU</b>	Madhësia e vendbanimit		67 m <sup>2</sup>	74 m <sup>2</sup>
	Hapësira banuese për të mëdhenj		11 m <sup>2</sup>	11,5 m <sup>2</sup>

**Burimi:** Programi i Ndhmës Teknike në Seksion e Energjisë (ESTAP) raporti Final; (UNMIK 2002)  
Analiza Demografike dhe shëndetësore e Kosovës 2003 (SOK 2004)  
vlerësimet e IWU për madhësinë e vendbanimit bazuar në numra në Rajonin e Prishtinës

Numri i personave për familje në Kosovë është 6,4; shifrat janë diçka më të vogla në zonat urbane (5,5) dhe pak më i lart në zonat rurale (6,8) (DHS 2003 / SOK 2004). Në një krahasim Evropian numri i personave për familje në Kosovë është shumë i lartë. Në UE (25 vende) ndryshon rreth 2,2 – 2,5 persona për familje në një shtrirje ndërmjet 1.9 në Suedi dhe 3.0 më Qipro dhe Malta (Bordi Kombëtar i Suedisë 2004). Numri i personave për familje varet edhe prej standardeve kulturore dhe kushteve



ekonomike. Ne e përjashtojmë modeli tradicional i familjeve, sepse numri i madh i anëtarëve dhe familje të mëdha për gjenerata të ardhshme, që jetojnë së bashku do të ndryshojnë. Në të ardhmen, me gjasë, njerëzit e ri preferojnë që të jetojnë vetëm nga vetvetja dhe të jenë të pavarur – prindërit dhe fëmijët – familja. Kjo tendencë, që është e pranueshme në tërë Evropën, me sa duket ka tendencë të jetësimit edhe në Kosovë. Shansi për njerëzit e ri që ti krijojnë familjet vetë, megjithatë, varet nga gjendja ekonomike. Sidoqoftë, sipas kushteve të shtimit të ngadalshëm ekonomik në Kosovë, është supozuar se deri 2015 numri mesatar i anëtarëve për familjeve nuk bie më poshtë se 4.0 persona (ESTAP, UNMIK 2002).

Sipas Studimit Mozaik të Kosovës (UNDP 2003) numri i banorëve në familje në Gjilan është më i vogël se sa i fshatrave përreth (pyetja D15). Në qytet një familje katër anëtarësh është më e zakonshme (24% në vetëm 9% në fshatra), përderisa në fshatra 19% e familjeve përbëhet nga 8-9 persona (krahasuar me 7% në qytet) dhe 11% i dhjet ose më shumë personave (krahasuar me 4% në qytet). Numri i vogël relativ i banorëve të familjeve në zonat urbane krahasohet me ato në zonat rurale e që është në përputhje me rezultatet e Analizave Demografike në Kosovë në vitin 2003 (DHS 2004). Shifrat e dhëna në këto analiza janë një përqindje prej 6.4 persona për familje në Kosovë; për më tepër i caktuar prej 6.8 në zonat rurale dhe 5.5 persona për një familje në zonat urbane.

Tab. 7: Zhvillimet e Familjeve 2002 / 2020 (vlerësimi i përafërt)

Gjilan	Banorët 2002 /1/	Personat për familje	Numri i familjeve	Banorët 2020 / Migrimi 0	Personat për familje /4/	Numri i vlerësuar për familje	Shtimi i pritur / i plotë
Komuna	<b>139.558</b>	5,9	23.723 ←	161.395	5	32.279	<b>8.500</b>
Qyteti	<b>79.000</b>	5,5 /2/ →	14.364 ↑	91.361 ↑	4,5	20.302	<b>6.000</b>
Fshatrat	<b>40.558</b>	6,5	9.359 /3/ ←	70.034 ↑	6	11.672	<b>2.300</b>

**Vërejtje:** /1/ vlerësimi i popullsisë 2002 nga komuna (baza e të dhënave),

/2/ personat për familjet urbane në Kosovë; cf. DHS (SOK 2003);

Numri i familjeve në Komunë (duket i dyfishhtë) të kalkuluakan këtë shkallë

/3/ shifrat e dhëna nga baza e të dhënave nga Komuna (vlerësimi 2002)

/4/ personat për familje bazuar supozimet dhe krahasimet me kombësitë në Rajon

**Burimet:** Banorët: Profili i komunës (OSCE 2005); personat për familje: DHS (SOK2003);

Baza e të dhënave komunale (vlerësimi 2002); llogaritjet e IWU



Përbërja e familjeve në Kosovë nuk është e kufizuar vetëm në prindër dhe fëmijë; familjet me tri gjenerata ka ende dhe familjarët e pa martuar mund të integrohen në familje të tilla. Kjo mund të shpije në kritere të ndryshme për statistika në familje..

Sa për shkallën e personave në familje në Gjilan, vlerësimi i Komunës i vitit 2002 (baza e të dhënave komunale) nuk janë në përputhje me përfundimin e Studimit të Mozaikut dhe me shkallën për Kosovën si tërësi. Megjithatë numri i personave për familje i dhënë për fshatra është në përputhje me shifrat për Kosovën. Të dhënat për qytetin e Gjilanit<sup>6</sup>, megjithatë, nuk duken me qenë të besueshme. Mu për këtë është vendosur ta bazojmë llogaritjen e zhvillimit të familjeve të qytetit të Gjilanit në shkallën e Kosovës.

Bazuar në shkallën e Kosovës (DHS 2003) dhe vlerësimin e Komunës të vitit 2002 (baza e të dhënave) i specifikuar për zonat urbane dhe rurale, numri i familjeve në Gjilan është 14.400 në qytet dhe 9.300 në fshatra, duke arritur shumën në 23.700 familje në komunë, të cilët mundën me qenë të barabartë në një shkallë e përqindjes prej 5,9 persona në familje.

Nëse të arriturat për zhvillimin e familjeve janë të vlefshme, si rezultat i strukturës së zhvillimit të popullsisë dhe familjeve, atëherë do të ketë kërkesa për vendbanime shtesë (duke iu referuar numrit të familjeve për vitin 2002), për rreth

- 8.500 familje në komunë,
- 6.000 prej tyre në qytet dhe
- 2.300 në fshatra.

Shifrat përafërsisht do ta ndryshojnë, e me këtë edhe vlera sipas shkallës së migrimit dhe strukturës së familjeve. Shtimi natyral është faktori i vetëm i zhvillimit të popullatës bazuar në llogaritjet në më shumë ose më pak të dhëna të përshtatshme.

<sup>6</sup> Nga Data Baza e komunës / Vlerësimi 2002:

Komuna	Banorë	familje	person / familje
Komuna	139.558	16.659	8,4
Qyteti	79.000	7.300	10,8
Fshatrat	40.558	9.359	6,5



## Madhësia dhe standardi i vendbanimeve

Sipas analizave Buxhetore të Familjeve prej vitit 2003 (SOK 2003), numri i përqindjes së dhomave të vendbanimit në Kosovë është 2,9 (në vendet urbane 2,7 dhe rurale 3,1). Vlerësimet paraprake të dhëna në "Analiza Demografike e Kosovës për vitin 2003" (SOK 2004), janë pak më të larta (zona urbane 3,0; zona rurale 3,4). Çështja e numrit të dhomave të përdorur për familje në dy hulumtime, megjithatë, nuk është saktësisht i njëjtë (SOK 2003, p.6). Të dhënat mbi madhësinë e vendbanimit (sipërfaqja nga m<sup>2</sup>) nuk ishin përfshirë në analiza. Të dhënat mbi hapësirën banuese për të rritur janë marr nga studimi ESTAP të vitit 2002 (UNMIK/ESTAP/Banka Botërore 2002).

Tab. 8: Familjet me numër të dhomave në Kosovë (zonat urbane/rurale)

Numri i dhomave	Kosovë	Zonat urbane	Zonat rurale
1	10%	11%	9%
2	35%	41%	32%
3	25%	26%	25%
4	20%	16%	22%
5	4%	3%	5%
6	3%	2%	3%
7 dhe më shumë	2%	1%	3%
Totali	100%	100 %	100%

**burimi:** Analiza e Buxhetit të Familjeve të 2003 / banimi në Kosovë (SOK 2003)

Megjithëse disa të dhëna mbi standardin dhe numrin e dhomave të vendbanimit në Komunën e Gjilanit janë përcaktuar nga Studimi Mozaik i vitit 2003, baza e vogël e përgjegjësve nuk mund të shpërndaj të dhëna që përfaqësojnë tërë territorin e komunës së Gjilanit. Këto analiza, megjithatë mund ta japin një parashikim të gjendjes e cila është në harmoni me gjendjen në Kosovë, të dhënë më lartë: familjet janë më të mëdha në fshatra, dhe gjithashtu edhe vendbanimet. Lloji i banimit ekzistues larg njëra tjetrës është i rrallë. Shtëpi e vetme familjare, është lloj ekskluziv i banimit në fshatra, përderisa, banimi kolektiv në shumicën e rasteve është i kufizuar në qytetin e Gjilanit. Në vend standardi teknik i vendbanimeve është i ulët, edhe pse shumica e familjeve janë të furnizuara me energji elektrike.





Tab. 9: Numri i Banorëve për Vendbanim në Gjiçan

(baza e përgjegjësve)	Përgjegjësit total (200 persona)	Zonat rurale (80 persona)	Qytet/qytet-shtet (120 persona)
1-2	3%	1%	3%
3	9%	10%	8%
4	18%	9%	24%
5	21%	19%	22%
6	17%	15%	18%
7	15%	16%	13%
8-9	12%	19%	7%
10 and more	7%	11%	4%

**Burimi:** Studim Mozaik Gjiçan (UNDP 2003). Pyetja D 15: Sa njerëz janë duke jetuar këtu tani?

Tab. 10: Lloji i banimit në Gjiçan

Baza e përgjegjësve)	Përgjegjësit total (200 persona)	Zona rurale (80 persona)	TQytet /Qytet, shtet (120 persona)
Vendbanimet shumë-familjare	2%	-	3%
Shtëpitë e kufizuara për një familje të vetme	99%	100%	98%

**Burimi:** Studim Mozaik Gjiçan (UNDP 2003). Pyetja D 19: përgjegjësit jetojnë në një

Tab. 11: Standardi teknik i vendbanimeve në Gjiçan

Baza e përgjegjësve))	Përgjegjësit total (200 persona)	Zona rurale (80 persona)	qytet /Qytet, shtet (120 persona)
Lidhja e furnizimit me ujë	58%	14%	88%
Ujërat e zeza /sistemi publik sanitar	61%	10%	94%
Nxemja qendrore	2%	-	3%
Energji elektrike	92%	99%	87%
Asnjërin	2%	1%	3%

**Burimi:** Studim Mozaik i Gjiçanit (UNDP 2003). Pyetja D9: a keni këtu në vendbanim ... ?



## Vlerësimi i Kërkesave të Banimit për të Ardhmen

Kërkesat e banimit për të ardhmen mund të identifikohen duke i përmbledhur kërkesat e ndryshme që janë llogaritur në mënyrë të ndarë.

Tab. 12: Përcaktuesit e Kërkesave për të Ardhmen

Kërkesa	I shkaktuar nga	Bazat llogaritëse
Kërkesat e pakryera	Banimet që nuk i zgjedhin standardet e sotme të kërkesat	Numri i familjeve në kohën e tashme numri i vendbanimeve në kohën e tashme ( <i>boshllëku i tanishëm ndërmjet furnizimit dhe kërkesave standarde</i> )
Kërkesat e reja	ritja e numrit të familjeve që kërkojnë vendbanime	Numri i familjeve aktualisht numri i familjeve në kohën e prognozave
Kërkesat e zëvendësuese	Zëvendësimi i banimit i marr nga tregu – p.sh. jashtë përdorimit, të përdorura ndryshe ose të shkatërruara	Reduktimet vjetore të familjes banuese (përqindja)
Kërkesa më të mëdha për shkak të rritjes së të ardhurave	Të ardhurat më të larta i lejojnë vetes vendbanime më të mëdha për më shumë familje	Eksperienca afatgjate bazuar në seritë e kohës

Rezultatet e katër llogaritjeve të kërkesave për banim janë përmbledhur për ta nxjerr shumën e kërkesave për të ardhmen. Si bazë për llogaritjet e mëtutjeshme, është numri i vendbanimeve në komunë ( numri aktual i vendbanimeve është i panjohur) . Supozimet dhe prognoza te kërkesave për banim në komunë mund të japin vetëm orientime të përafërta për këto çështje.

## Kërkesat e pakryera

Numri i njerëzve që jetojnë së bashku në një vendbanim është mjaft i madh, bazuar në përfundimet e Studimit Mozaik. Në dy të tretat e vendbanimit, pesë e shumë banor jetojnë së bashku, ndërsa në vendbanime rurale numri i banorëve për një familje është edhe më i madh (UNDP 2003, D15). Nëse secila familje në Gjiçan që dëshiron të jeton vetëm ka vendbanimin e vetë, numri i vendbanimeve duhet të jetë më i madh sesa që është tani. Është e pasigurt një shpërbërje radikale e familjeve tradicionale, ku jetojnë së bashku me shumë gjenerata në një familje në Kosovë, që është një objektivë e mundshme dhe e



dëshirueshme për shumicën e popullsisë. Për tu përmbushur një kërkesë e tillët tani për tani nuk ekzistojnë këto rrethana.

Kjo vlen edhe për komunën e Gjiçanit. Kushtet dhe niveli i të ardhurave familjare në Gjiçan, nuk janë në gjendje të mundësojnë vendbanim të vetëm privat për shumicën e popullsisë mbi moshën 20 vjeçare, sepse numri i banorëve me të ardhura të vogla është tepër i madhshqetësues. Edhe pse parashikimi bazohet në vlerësimin më optimist të zhvillimit ekonomik, kërkesat e pakryera do të jenë të kënaqshme vetëm pjesërisht, ose shumë pakë, kur vlerësimi është i bazuar në shtimin më të ulët. Ekonomik.

### **Kërkesat e reja**

Kërkesat e reja janë si rezultat i parashikimit të zhvillimit të numrit të familjeve (siç është paraqitur më lartë). Mund të supozohet se, numri i personave për familje do të rritet dhe hapësira e banimit do të shtohet. Kështu, numri i familjeve do të rritet diçka më shpejtë se popullsia. Në çfarë shkalle kjo kërkesë e re mund të jetë e kënaqshme, varët nga zhvillimi ekonomik. Një numër prej 4,5 anëtarësh për familje në vitin 2020, është supozuar për qytet, 6 për fshatra, dhe 5 për komunën në tërësi. Duke iu referuar rritjes së familjeve nga viti 2002 – 2020 familjet banuese do të rriten përafërsisht në 6.000 vendbanime në qytetin e Gjiçanit dhe përafërsisht 8.500 vendbanime në tërë komunën.

### **Kërkesat zëvendësuese**

Varësisht nga zhvillimi i të ardhurave, kërkesat për banim për familje do të rriten proporcionalisht. Një rritje e të ardhurave do të shkaktoj kërkesa më të mëdha në lidhje me objektet, kualitetin dhe gjendjen e vendbanimit. Një pjesë e familjeve do të kthehen në vendbanime më të mëdha dhe më të gjëra. Vendbanimet e mbetura, disa do të përdoren për nevoja tjera p.sh. objekte komerciale, dhe disa do të rrënohen. Një gjendje e tillë e re duhet ta zëvendësoj këtë lloj vendbanimi. Ne e supozojmë shkallën e zëvendësimit të vendbanimit prej rreth 0,5% të familjes për çdo vit ose rreth 8 deri 10 % të familjeve banuese të tanishme mbi pesëmbëdhjetë vite. Megjithëse një pjesë e vendbanimeve që mund të zëvendësohet në të njëjtë tokë, do të krijoj kërkesa shtesë për tokë ndërtimore. Duke e marr parasysh dendësinë e ulët për zona të reja të vendbanimit dhe hapësirë më të madhe të vendbanimeve të reja, kërkesa e re për tokë ndërtimore mund të jetë rreth sasisë së tokës së zënë nga vendbanimet e zhdukura më parë.



## Kërkesat e mëdha për shkak të rritjes së të ardhurave

Kjo mund të jetë më shumë realiste në vend të një analize të nevojave, siç është provuar më lartë, për ta bazuar planifikimin strategjik në baza të të dhënave mbi analizat e përkrahjes së pushtetit. Për shkak të faktorëve të ndryshëm që i kemi vlerësuar, GDP në Kosovë është pritur të stagnoj në vitet e ardhshme. Në përfundim, është pritur që ekonomia të rritet, së pari në mënyrë përmbajtjesore dhe pastaj më fuqishëm. Sidoqoftë këto rezultate prites do të përmbushën vetëm nëse plani i veprimeve optimist i zhvillimit do të barazohet me realitetin më të mirë të së ardhmes. Në këtë rast mund të pritet që përçindja e hapësirës banuese për të rritur do të mund të rritej nga 11 metër katror që është sot në afërsisht 15 metra katror në fund të periudhës së paraparë.

## Perspektivat për Planifikim dhe Ndërtim

Aktivitetet për riparimin dhe ndërtimin e shtëpive të shkatërruar ose të rrënuara për shkak të rrethanave të luftës (EU/IMG 1999/2000), kanë filluar menjëherë pas përfundimit të saj.. Një numër i konsiderueshëm i shtëpive të ndërtuara pas luftës, dëshmojnë aftësitë e njerëzve dhe familjeve në Gjilan që të përballën me kushte shumë të vështira ekonomike dhe të ia dalin mbanë të bëjnë shtëpi të reja për qëllimet e tyre vetjake. Asnjë qeveri shtetërore nuk ka qenë e gatshme ti mundësoj ato riparime dhe ndërtime në kohën dhe sasinë e realizuar. Për shkak të rritjes së ndërtimit me vetë-ndihmë dhe mungesa e mbështetjes profesionale dhe mbikëqyrjes së kualitetit, megjithatë, në të gjitha rastet nuk ndërtuesit nuk kanë mundur ti realizojnë standardet profesionale të ndërtimit. Një problem tjetër ishte mungesa e standardeve të planeve urbane, në veçanti pas luftë planet rregulluese ekzistuese nuk janë respektuar, ose ndërtimet janë bërë në zonat ku nuk ekzistonin planet rregulluese, zona këto të cilat nuk ishin të lejuara për ndërtim.

Vlen të përmendet se me ndihmën e ndërsjellë të familjeve, një pjesë domethënëse e popullatës kanë qenë të zotët të ndërtojnë shtëpitë e tyre, duke e siguruar sistemimin e tokës së nevojshme për ndërtim. Në fshatrat ku janë shtëpitë e vetme, forma ekzistuese e pjesës së ndërtimit të vendbanimeve për shtëpi shtesë mund të përgatitet më lehtë brenda strukturës ekzistuese të vendbanimit ose në periferitë e tyre. Megjithatë, në qytet, është i nevojshëm ndryshimi i ndërtesave të banimit. Në hapësirat e mëdha, familjet mund të ndërtojnë shtëpitë e tyre në mënyrë të vetme të pavarur ose gjysmë të varur, por prapë ekziston nevoja e banimit kolektiv, qiradhënies dhe bashkëpronësisë, veçanërisht për familje të vogla, të cilët nuk janë në gjendje të ndërtojnë shtëpitë e tyre. Megjithatë për ndërtimin e ndërtesave për banim kolektive janë të



nevojshëm investues dhe mjeshtër profesionale. Çfarëdo zhvillimi i mëtutjeshëm i vendbanimit në qytet duhet të bazohet në planet rregulluese urbane me qëllim të organizimit më të mirë të ndarjes së llojeve të ndryshme të ndërtesave banuese, për të shpresuar për tokën ndërtimore dhe vlerën e investimeve.

Prognozat më të sakta, mund të merren në bazë të dhënave relevante të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë dhe familjeve ekzistuese. Deri më sot nuk ka të dhëna të gatshme mbi numrin e madh të ndërtimeve të reja të kryera pas luftës. Me sa duket shumica e tyre janë akoma në ndërtim dhe nuk janë në përdorim ose vetëm pjesërisht janë të uzurpuara. Sasia e këtyre rezervave të banimit potencial është e panjohur dhe vetëm mund përafërsisht të vlerësohet.

#### **S** Përparësitë

- Bazuar në strukturat tradicionale të familjeve me vetë-ndihmë dhe ndihmë të ndërsjellë, një sasi e konsiderueshme e vendbanimeve është ndërtuar për ta lehtësuar mungesën e vendbanimeve menjëherë pas luftës, të shkaktuara nga shkatërrimet dhe rrënimet si dhe nga refugjatët që kërkonin strehim.

#### **W** Mangësitë

- Në lidhje me kombësitë tjera në rajon, ofrimet i standardit të banimit ende është i ulët. Mund të përmirësohet gradualisht me zhvillim ekonomik dhe prosperitet.

#### **O** Mundësitë




- Mund të pritët që aktivitete individuale të ndërtimit të kontribuojnë në mënyrë domethënëse në përmirësimin e ofertës së banimit në Gjilan.

#### **T** kërcënimet

- Supozohet se, modelet tradicionale të banimit në me shumë gjenerata - familje të mëdha do zvogëlohen e me këtë do të rriten kërkesave shtesë për vendbanim individual.

#### **→** çështjet

- Planet rregulluese do të sigurojnë përdorimin optimal të tokës ndërtimore duke e rritur dhe siguruar ndërtim cilësor m standarde bashkëkohore Aktivitet e ndërtimit të vendbanimeve, megjithatë duhet të mbështetën dhe të ndihmohen nga profesionistët e lëmit përkatëse.



- kufiri shtetëror fqinje  
neighbour national border
- kufiri i Republikës së Kosovës  
Republic of Kosovo border
- kufiri komunal i fqinjeve  
municipality border
- komuna e Gjiçanit  
municipality of Gjiçan
- Zonat kadastrale  
District zones
- bazë e rëndësishme e KFOR-it  
important KFOR-base
- hapësirat e ndërtuara  
built-up areas
- hapësirat kryesore industriale  
main industrial areas:
- 1. ndërmarrja ndërtimore "Morava e gjnca"
- 2. pronë industriale "Ruga magjistrale Buljarov"
- 3. industria e tekstilit
- 4. industria e duhanit
- 5. pronë industriale "LGB" dhe "Fluid"
- shtrirja e dendësisë së vendbanimeve  
main settlement areas
- shtrirja e dendësisë së popullatës  
main population areas

**Kuvendi Komunal Gjiçan**  
Municipal Assembly Gjiçan

**Plani zhvillimor komunal i Gjiçanit**  
Municipal development plan of Gjiçan

**Vendbanimet dhe popullsia**  
Settlements and Population

14.04.2008

Përpjetor: Përfaqësuesit  
Scale: 0 1 2 3 km

Plan 3  
Plan 3

DIREKTORI PËR PLANIMIN, INJENIERI DHE ARKITEKTURË  
THE OFFICE FOR PLANNING, ENGINEERING AND ARCHITECTURE

PLANIMSGRUPPE 4





## Arsimi

Roli i komunave në sistemin edukativ është përgatitja dhe mirëmbajtja e infrastrukturës arsimore e përbërë përveç tjerash nga objekte dhe pajisje tjera për shkollë, transport dhe stafi arsimor. Drejtoria Komunale e Arsimit është përgjegjës për të gjitha detyrave dhe përgjegjësive komunale për arsim. Nga janari 2002 të gjitha komunat marrin përgjegjësitë e shpenzimeve të veprimit përfshirë mbështetjen e stafit, administrativ, mallrat dhe shërbimet, riparimet dhe mirëmbajtjen. Të ardhurat mujore të stafit mësimorë janë ende nën përgjegjësinë e Qeverisë së Kosovës.


Deri në fund të vitit 2002 të gjitha objektet e shkollave fillore dhe të mesme në Kosovë janë transferuar nën pronësinë e komunës. Komunat tani janë përgjegjëse për riparimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore.

Shtrirja e rrjetit të objekteve shkollore të arsimit fillor, është mjaft e mirë në komunë, ndërsa qyteti ka mangësi në numër të objekteve shkollore. Këtu duhet të theksohet se për shkak të shpopullimit, disa shkolla nuk kanë nxënës të mjaftuar.

Objekte të arsimit të mesëm nuk ka fare në pjesët rurale të komunës, ndërsa në qytet është një mungesë e madhe e objekteve të tilla. Gjendja e objekteve shkollore si në qytet ashtu edhe në komunë nuk është e mirë.



Fig. 11: Sistemi arsimorë në Kosovë





### Edukimi Parashkollorë

Në qytet ekzistojnë 3 çerdhe. Në zonat rurale nuk ka institucione të edukimit parashkollorë.

### Arsimi Fillorë dhe i Mesëm i Ulët(Arsimi I obligueshëm)

Arsimi i obligueshëm është zgjatur në nëntë vite ku 5 vite janë arsim fillor dhe 4 vite arsim i mesëm i ulët. Paraqitja e klasës së 9-të në arsimin e obligueshëm përfshinë zhvillimin e plan-programit të ri dhe orientimin e mësimdhënësit. Viti shtesë "është vit orientimi" që u siguron nxënësve informata dhe këshilla në mënyrë që ata të kenë mundësi të zgjedhin se çfarë duan të studiojnë dhe të zgjedhin profesionin e tyre në të ardhmen.

Në Komunën e Gjilanit ekzistojnë 19 shkolla amë dhe 25 paralele të ndara fizike të tyre të arsimit të obliguar fillor në gjuhën shqipe dhe turke. Në këtë kategori të edukimit dhe arsimimit janë të përfshirë 18.874 nxënës prej klasës I-IX dhe 1.602 fëmijë në paralelet para fillore pranë shkollave fillore. Me ta punojnë mbi 910 mësimdhënës dhe 170 punëtorë administrativ dhe teknik.

Tab. 13: Shkollat Fillore në Komunë

Nr. rendor	Emri i shkollës	Lokacioni	Numri i nxënësve	Numri i puntorëve
1.	Salami Hallaqi	Gjilan	2994	133 (6)
2.	Abaz Ajeti	Gjilan	2329	113 (3)
3.	Musa Zajmi	Gjilan	1523	73
4.	Thimi Mitko	Gjilan	3089	112 (4)
5.	Rexhep Elmazi	Gjilan	1433	64 (1)
6.	Dëshmorët e Kombit	Livoç i Poshtëm	543	30
7.	Bajram Curri	Shurdhan	115	15
8.	Ramiz Cernica	Cernicë	680	49 (1)
9.	Agim Ramadani	Zhegër	1140	70 (1)
10.	E. Berisha	Llashticë	437	29 (1)
11.	Mulla Idriz Gjilani	Velekincë	684	44 (2)
12.	Emin Duraku	Malishevë	1070	60
13.	Liria	Pogragjë	524	49
14.	N. Hikmet	Mireshe	843	53
15.	Skënderbeu	Perlepticë	551	41 (2)
16.	V. i Diturisë	Livç i Epërm	671	34 (1)
17.	Ibrahim Uruqi	Bresalc	798	44 (2)
18.	Afërdita	Kishna Pole	231	32
19.	F. Qerimi	Vërbicë e Zhegovcit	171	23 (1)



20.	Shkolla e muzikës	Gjilan	686	22 (3)
21.	Milladin Popoviq– kom. serb	Pasjan	335	35
22.	Dosite Obradoviq– kom. serb	Partesh – Budrig	352	33
23.	Branko Radiqeviq– kom.serb	Cernicë	50	14
24.	Sveti Sava – kom. serb	Parallovë – Ponesh	132	28
25.	Bora Stankoviq – kom.serb	Koretishtë – Strazhë	183	38
26.	Vuk Karaxhiq – kom. serb	Gjilan – Kmetovc – Shillovë –Livoç	286	70
27.	P.P. Njegosh – kom. serb	Kufcë – Makresh – Stanishor	370	59
28.	N. Hikmet – komuniteti turk	Miresh	29	11
29.	Musa Zajmi – komuniteti turk	Gjilan	67	10
	<b>Gjithsej:</b>		<b>20.605</b>	<b>1.368</b>

Burimi:Raportet Sektorale

Tab. 14: Numri i shkollave fillore, nxënësit dhe proporcioni nxënës/shkollë në arsimin e obligueshëm (klasat 1–9), 2005/6

Numri i shkollave	Numri i nxënësve	Proporcioni nxënës/shkollë
A (19+25 paralele të ndara)	20 605	468.29

Tab. 15: Personeli arsimor në arsimin e obligueshëm sipas pozitës (klasat 1-9) 2005/6

Mësimdhënësit		Personeli administrativ		Personeli ndihmës		Gjithsej personel arsimor	
Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%
910	85.93	33	3.11	116	10.95	1059	100

Burimi: Raportet Sektorale



### Standardet arsimore

Në qytet hapësira e shfrytëzimit për një nxënës është 0.65 m<sup>2</sup>, ndërsa në fshat kjo hapësirë është 1.1 m<sup>2</sup> për një nxënës.

### Arsimi i mesëm i lartë

Arsimi i mesëm i lartë përfshinë tri apo katër vite të shkollimit për nxënësit e grup-moshës 15 deri 18 vjeç.

Në Komunën e Gjiçanit janë 12 shkolla të mesme dhe atë 6 në gjuhën shqipe me 6033 nxënës dhe 380 mësime, ndërsa 6 shkolla në gjuhën serbe me 799 nxënës dhe 107 mësime.

Tab. 16: Shkollat e mesme në Komunë

Nr. Rendor	Emri i shkollës	Lokacioni	Numri i nxënësve	Numri i punëtorëve
1.	Zenel Hajdini – gjimnazi	Gjiçan	1913	109
2.	Memet Isai – teknike		1047	73 (8)
3.	Marin Barleti – ekonomike		888	56 (1)
4.	Dr. Asllan Elezi – medicina		433	17 (2)
5.	Arbëria		632	52 (3)
6.	Muzikës		63	12 (1)
7.	Medicinës	Pasjan – Shillovë	227	16
8.	Ekonomike	Partesh Koretishtë	264	37
9.	Teknike	Kufcë	309	57
10.	Gjimnaz	Shillovë	86	25
11.	Zenel Hajdini – gjimnazi-komuniteti turk		33	4
	<b>Gjithsejt:</b>		<b>5.009</b>	<b>458</b>

Burimi: Raportet Sektorale

Tab. 17: Numri i shkollave të mesme, nxënësit dhe proporcioni nxënës/shkollë në arsimin e mesëm (klasat X-XII), 2005/6

Numri i shkollave	Numri i nxënësve	Proporcioni nxënës/shkollë
A (6+I par. e ndarë)	5009	834.83



Tab. 18: Personeli arsimor në arsimin e mesëm sipas pozitës (klasat (X-XII) 2005/6

Mësimdhënësit		Personeli administrativ		Personeli ndihmës		Gjithsej personel arsimor	
Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%
266	84.98	15	4.79	32	10.22	313	100

Burimi: Raportet Sektoriale

## Universiteti

Në Gjiçan ka filluar punën Fakulteti i Edukimit me 104 studentë dhe 6 mësimdhënës, ndërsa i vazhdojnë studimet edhe 629 studentë nga SHLP "Skënderbeu" me 19 punëtorë.

## Shkollat Speciale

Në Komunën e Gjiçanit nuk ka shkollë të veçantë speciale, por në shkollat fillore "Abaz Ajeti" dhe "Thimi Mitko" ekzistojnë klasë speciale për fëmijë të paaftë dhe me të meta mentale.

### S

#### përparësitë

- Arsimi gjithëpërfshirës,
- Arsimi privat,
- Aplikimi i reformave,
- Numri i madh i nxënësve
- Trajnimi i kuadrit arsimor,
- Numri i madh i profileve (shkollat e mesme ),
- Ekzistimi i këshillave të prindërve,
- Ligji mbi arsimin.

### W

#### dobësitë

- Hapësira e pamjaftueshme në shkolla,
- Infrastruktura teknike e dobët,
- Kuadri arsimor i pamjaftueshëm,
- Stimulimi i dobët i arsimit,
- Mungesa e buxhetit,
- Shtirja e pavolitshme hapësinore e shkollave,
- Kapaciteti i vogël i arsimit parashkollor,
- Orari i shkurtër i enteve parashkollore,
- Mos përfshirja e të gjithë nxënësve nëpër shkolla,
- Prezenca e dukurive negativë nëpër shkolla.

### O

#### mundësitë

- Mbrojtja dhe sigurimi i lokacioneve për shkollë,
- Trajnimi i kuadrit arsimor,
- Mundësia e financimit përmes pjesëmarrjes,






- Riaktivizimi i bibliotekës në shkolla.
- Kthimi i pedagogëve nëpër shkolla,
- Ndërtimi i objekteve të reja shkollore të të gjitha niveleve,
- Renovimi i objekteve ekzistuese shkollore.



#### kërcënimet

- Mos përfshirja e të gjithë nxënësve nëpër shkolla,
- Prezenca e dukurive negativë nëpër shkolla.

Fig.12: Institucionet shkollore në Komunë





## Sistemi për përkujdesje shëndetësore

### Detyrat institucionale

Rregulloret e përgjithshme të përkujdesjes shëndetësore në Kosovë janë përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë / në nivelin komunal përgjegjës është Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Sa i përket sigurimit të shërbimeve dhe pajisjeve të programuara nga shteti dhe zyrtarët komunalë, pasojat që kanë të bëjnë me nevojën e hapësirës dhe përzgjedhja e lokacioneve duhet të koordinohen me Drejtorinë për Planifikim dhe Urbanizim në bazë të dispozitave të Planit Zhvillimor.

### Problemet Ekzistuese

Sektori i shëndetësisë në Kosovë ka pësuar jo vetëm nga shkatërrimi fizik i konflikteve të dhunshme, por edhe nga jo-investimet afatgjate në zhvillimin e stafit dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës fizike dhe pajisjeve.

Aktualisht çdo komunë ka një Qendër të Shëndetësisë Familjare (FHC apo shtëpia shëndetësore) për të mbikëqyrur rrjetin e Ambulantëve dhe barnatoreve (pajisjet primare të përkujdesjes shëndetësore dhe shërbimet në fshatra).

Sidoqoftë mundësitë diagnostifikimit të secilës qendër janë të kufizuara dhe shumë raste referohen nëpër spitale. Infrastruktura fizike e përkujdesjes shëndetësore në Kosovë edhe pse nuk ka pësuar nga dëmet e luftës ka shumë nevojë për rinovim.

Çështja e dytë brengosësh në strategjinë për rehabilitimin e sektorit të shëndetësisë është mungesa e personelit të kualifikuar shëndetësor në kuadër të sistemit publik.

Në dhjetë vitet e fundit profesionistët shëndetësorë kanë pasur qasje të vogël në pajisjet dhe të përtëritjes së njohurive apo ndryshime në teknologjinë mjekësore dhe në punët praktike.

### Struktura e sistemit shëndetësor

Sistemi i reformuar shëndetësor në Kosovë është projektuar të bazohet në "praktikën familjare" qasje në mjekë, motra medicinale dhe ekspertë tjerë shëndetësorë që punojnë si grup.

- **Përkujdesja Parësore Shëndetësore:** Është e organizuar në bazë të konceptit të mjekësisë Familjare si sistem i ri në Kosovën e pasluftës.



- Organizimi institucional i Mjekësisë Familjare është i organizuar me sa vijon:
- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare(QKMF)– ofron shërbime shëndetësore 24 orë.
- Qendrat e Mjekësisë Familjare(QMF)– ofrojnë shërbime shëndetësore gjatë ditëve të punës.
- AMF– ofrojnë shërbime shëndetësore gjatë ditëve të caktuara (2 deri 3 herë brenda javës).
- **Përkujdesja Sekondare Shëndetësore:** Si spitale të përgjithshme korrespondojnë në nivelin sekondar të përkujdesjes shëndetësore, përfshirë Spitalin Universitar të Prishtinës.
- **Përkujdesja Terciare Shëndetësore:** Spitali Universitar i Prishtinës është spitali i vetëm i cili siguron përkujdesje terciare shëndetësore.
- **Kujdesi Privat Shëndetësorë:** Ofron shërbime të ndryshme ambulatorore dhe specialistike të profileve të ndryshme diagnostike dhe terapeutike.

### Kapacitetet e sistemit shëndetësor të Gjiçanit

- Spitali Rajonal.
- Komuna e Gjiçanit ka një spital rajonal me 17 Reparte: reparti i Gjinekologjisë, interno, dializa, pediatria, kirurgjia, anesteziologjia, ortopedia, urologjia, infektiv, sëmundjet e mushkërive, ndihma e shpejtë, oftalmologjia, laborator, transfuzioni i gjakut dhe materniteti. Në qendrën Spitalore janë të punësuar 525 punëtorë.



Tab. 19: Tabela e të punësuarve sipas nivelit profesional, Burimi:Raportet Sektoriale

Përgatitja shkollore	Gjinekologjia	Interna	Dializa	Njis.koronare	Pediatria	Neonatologjia	Kirurgjia	Anestezjologjia	Ortopedia	Urologjia	ORL	Ofthalmologjia	Imunologjia	Pneumofiza	DAT	Emergjencia	Laboratorium	Transfuzioni	Këngeni	Neuropsiatria	Dermatologjia	Bamalojia	Drejtoria	Shërbime teknik	Gjithsejt
Mjek specialist	10	7		2	6	3	7	4	4	2	5	2	5	4	1	3	2	1	3	2	2				73
Specializant	3	8					3	3	1	1		2	2						2	2					27
Punëtor me fakultet			1																						1
Shk. lartë medie						1		1											2						4
teknik medicinal	40	25	15	11	15	13	14	26	10	10	7	2	11	10	3	25	13	0	7	15	2	1	4		207
teknik farmacia:																									
teknik anesteziolog								5																	5
teknik instrument								14																	11
laborant															2										2
tek. rentgen														2											2
tek.transfuz																									
Shk mesme	5		3		1		1	1	1							4			2	1			18	41	75
Të kualifik.																									1
pa kualifikim	8	8	3	2	2	1	3	4	1	2	2		2	2	1	4	2	1		3			1	32	84
Gjithsejt:	66	48	22	15	24	13	28	58	17	15	14	6	20	16	9	36	17	10	16	23	4	1	21	74	573

Tab. 20: Numri i shtretërve sipas reparteve në Spitalin Rajonal të Gjilanit, Burimi:Raportet Sektoriale

Repartet	Gjinekologjia	Interna	Dializa	Njis.koronare	Pediatria	Neonatologjia	Kirurgjia	Ortopedia	Urologjia	ORL	Infektologjia	Opsterika	Reanimi	Emergjencia	Pulmologji	Neuropsiatria	Intenziva kirurgjike	Intenziva anesteziologjike	Observimi	Gjithsejt
Shtretër	47	57	18	13	35	29	27	18	15	21	32	43	3	22	32	11	17	8	5	453

### Qendrat dhe Punktet e Mjekësisë familjare

- Institucionet shëndetësore bëjnë kontrollin dhe përkujdesjen e pacientëve. Në komunë është edhe shërbimi emergjent i cili ofron shërbimet e veta non-stop, në kuadër të Spitalit Rajonal sikur edhe ai në Shtëpinë e Shëndetit.

Gjendja e shëndetësisë në Komunë dhe qytet mund të shihet më qartë nga tabela në vijim.




Tab. 21: Numri i punëtorëve në institucionet shëndetësore

Lokacioni	Numri i punëtorëve						Gjithsejt të punësuar
	Mjekë	Tekni Medicinbal	Stomatolog	Admin.	Ngasës të autom	Punëtor ndihmës	
1. QKMF-ambulanca e qytetit	20	80	14	10	6	27	157
2. QMF – në lagjen “Dardania”	10	24	4		1	4	43
3. QMF - në lagjen “Arbëria”	4	8				2	14
4. QMF - Ish-emergjenca	6	15				2	22
5. QMF dheu i bardhë	2	3				1	6
6. QMF në fsh. Zhegër	3	5	1			1	10
7. QMF në fsh. Pogragjë	1	3	1			1	6
8. QMF në fsh. Mireshe	1	2					3
9. QMF në fsh. Bresalc	1	3					4
10. QMF në fsh. Cernicë	1	1					2
11. QMF në fsh. Malishevë	1	1					2
12. QMF në fsh. Perlepnice	1	2					3
13. QMF në fsh. Pasjan	2	7	1		1	2	13
14. QMF në fsh. Kufcë e Epërme	2	9	1		1	2	15
15. PMF në fsh. Uglar		1					1
16. PMF në fsh. Livoq i ulët		1					1
17. PMF në fsh. Kishnapole		1					1
18. PMF në fsh. Llashticë		1					1
19. PMF në fsh. Shurdhan		1					1
20. PMF në fsh. Livoq i Epërm		1					1
21. PMF në fsh. Partesh		3					3
22. PMF në kishën e qytetit	1	3				1	5
23. PMF në fsh. Shillovë	2	4				1	7
24. PMF në fsh. Koretishtë	2	5				1	8
25. PMF në fsh. Ponesh		1					1
26. PMF në fsh. Makresh		1					1
27. PMF në fsh. Strazhë		1					1
28. PMF në fsh. Parallovë		1					1
29. PMF në fsh. Budrigë e Poshtme	1	3				1	5
30. PMF në fsh. Stanishor		1					1
<b>Gjithsejt:</b>	<b>61</b>	<b>192</b>	<b>22</b>	<b>10</b>	<b>9</b>	<b>46</b>	<b>340</b>

Burimi: Raportet Sektoriale



Fig.13: Institucionet shëndetësore në Komunë







## Mbrojtja Sociale

Komuna e Gjilanit ka një qendër për mirëqenie sociale, që merret me këto çështje, e cila ndihmohet dhe paguhet nga UNMIK-u.. Ata ndihmojnë familjet me probleme për adoptim, shkurorëzim, gjejnë strehim për pleqtë, zakonisht ata i dërgojnë në Prishtinë. Në Komunën e Gjilanit marrin ndihma 1,775 familje, prej tyre 1,305 familje shqiptare me 15,660 anëtarë, 352 familje serbe me 4,266 anëtarë, 49 familje rome me 590 anëtarë, 43 familje të shpërngulura nga Kosova Lindore me 517 anëtarë dhe 26 familje të shpërngulur nga Maqedonia me 308 anëtarë.

## Kryqi i Kuq Lokal

Në Komunën e Gjilanit ekziston një zyre e Kryqit të Kuq. Ata distribuojnë me të mirat të cilat i marrin nga OJQ-të dhe organizatat tjera. Ata dhurojnë pako higjienike për fëmijë, prej 6 muaj deri në 2 vjet; gjithashtu kanë një program t'i ndihmojnë fëmijët e shkollave.

### S

#### përparësitë

- Kuadri i mjaftueshëm mjekësor,
- Nuk ka sëmundje epidemike,
- Mjekësia familjare,
- Spitali rajonal,
- Ekzistimi i ordinancave private.

### W

#### dobësitë

- Mossigurimi shëndetësor,
- Buxheti i pamjaftueshëm,
- Hapësira e pamjaftueshme,
- Mungesa e reparteve,
- Pajisjet teknike mungojnë.

### O

#### mundësitë

- Trajnimi i vazhdueshëm profesional,
- Sigurimi shëndetësor,
- Specializimi i kuadrit,
- Hapja e ambulancave të reja,
- Hapja e reparteve të reja të Spitalit.

### T

#### kërcënimet

- Rritja e sëmundjeve ngjitëse,
- Rritja e sëmundjes së varësisë,
- Largimi i kuadrit profesional nga instituti – komuna.



## Kultura, Rinia dhe Sporti

### Kultura

Për trashëgiminë kulturore, ka një interesim të shtuar pas luftës në Kosovë. Kurorëzim i këtij interesi për komunën e Gjilanit paraqet themelimi i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore në korrik të vitit 2004. Thënë kushtimisht, janë krijuar kushtet që urgjentisht dëshira të zëvendësohet me angazhim konkret. Qysh gjatë fazës së inventarizimit, QRTK në Gjilan ka konkretizuar evidentimin e objekteve me vlerë trashëguese në tërë komunën e Gjilanit, me gjithsej 162 objekte me vlerë arkitektonike, arkeologjike, historike, të vjetërsisë, artistike, mjedisore, rariteti, etj.

Objektet e Kulturës në Gjilan janë:

1. Teatri Profesionist i Qytetit,
2. Biblioteka Publike Kombëtare me 10 Biblioteka nëpër fshatra, prej tyre 4 në vendbanimet serbe,
3. Arkivi Historik,
4. Qendra e Trashëgimisë Kulturore,
5. Shtëpi të Kulturës në 6 fshatra,
6. Stadiumi i Qytetit,
7. Pasuri tjera Trashëgimore dhe Shpirtërore.

Në Gjilan organizohen edhe Manifestime Kulturore si Flaka e Janarit, Panairi i Librit dhe Takimet e Majit.

### Rinia

Në kuadër të zhvillimeve të gjertanishme, ballafaqimi me i madh dhe sfidues për shumicën e strukturës rinore ne komunën e Gjilanit, është mungesa e hapësirave te mjaftueshme për te zhvilluar aktivitetet dhe veprimtarit e tyre ne lëmi të ndryshme rinore dhe rekreative.

Niveli i përgatitjes se te rinjve në shkallë komune është i kënaqshëm por , jo ne masën adekuate dhe te përgatitjes superiore apo vende- vende, mungon edhe shkalla e përgatitjes se mesme shkollore– kryesisht nëpër disa vendbanime të thella rurale.

Grupmoshat rinore prej pesëmbëdhjetë vjeç e deri ne tetëmbëdhjetë janë te ndikuara nga zhvillimet negative në shoqëri e kryesisht mos edukatës së mjaftueshme dhe lakmisë së tyre për te pas qasje ne 4 dukuri negative si: rugaçëria , alkooli , prostituimi , dhe pjeshëm edhe në elemente narkotike.



Ne trend me zhvillimet ne komunën e Gjiçanit, mundësitë e punësimit të rinjve janë te vogla dhe kryesisht një punësim i tyre është e mundur vetëm në strukturat institucionale shërbyese dhe publike, si dhe ne një pjesë të sektorit privat, edhe pse ky punësim është i përkohshëm dhe jo i qëndrueshëm.

Përafërsisht 65% e popullatës se komunës sonë përbehet nga te rinjtë e te tri grupmoshave, megjithatë ne strukturën e tyre organizative ekziston potencial dhe energji e madhe për t'u zhvilluar dhe promovuar në arsimim e edhe në sfera të tjera. Është e theksuar edhe dëshira për të migruar ne vende të ndryshme euro perëndimore , pa dallim strukturën dhe kualifikimin e tyre.

Edhe qendra sportive që ekzistojnë, janë të pa mjaftueshme për te përmbushur nevojat e mëdha te të rinjve por edhe te vetë qytetarëve të grup moshave të rritura.

Terrenet sportive për të rijnë nëpër fshatra mungojnë fare përveç ne dy tre fshatra të komunës:

Ekzistojnë qendra kulturore dhe rinore në fsh. Zhegër e riparuar dhe pjesërisht e kompletuar. Në fsh. Bresalc qendra rinore është e riparuar por e pa kompletuar dhe tani është ne fazën e funksionalizimit,.Në fsh. Llashticë e rinovuar dhe funksionale dhe në fsh. Perlepticë po ashtu është funksionale etj.

Përveç në fsh. Zhegër që është menaxheri i shtëpisë së kulturës dhe rinisë, në vendbanimet tjera nuk është caktuar ndonjë person përgjegjës , pasi që të gjitha këto objekte janë ekzistuese dhe nën DKRS-në.

Ndërsa gati ne çdo vendbanim rural janë aktivizuar Qendrat apo Klubet rinore , përmes se cilave te rinjtë zhvillojnë aktivitete te ndryshme por që ju mungon infrastruktura, edhe pse te gjitha këto organizma te të rinjve janë te kyçur ne zhvillime te ndryshme pozitive ne nivel te komunës përmes sektorit te Rinisë .



Tab. 22: Organizatat rinore që veprojnë në Komunën e Gjiçanit

Nr.	Emri i organizates-subjektit rinor	Veprimtaria
1	Unioni i pavarur i Studentëve	Rinore -studentore
2	Rinia Shkollore	Rinore – shkollore ne nivel komunal
3	Asociacioni për avansim të Rinisë	Promovim rinor -avansim
4	Org . Rinore “universi”, Pogradjë	#####
5	Qendra Rinore”RINIA”, Bresalc	#####
6	Q.R. – Gjiçan	Edukative -trajnuese
7	F. R – LDK-së	#####
8	RD-PDK-së	#####
9	AR-AAK-së	#####
10	RiniaPSHDK-së	#####
11	Rinia PReK	#####
12	Qendra rinore Livoq i epërm	#####
13	Qendra Rinore Livoq i ulët	#####
14	Dardanica-Zhegër	Edukuese-trajnuese
15	Klubi Rinor “AGIMI”, Zhegër	#####
16	Rinia e Kryqit të Kuqë	Humanitare angazhuese
17	“ Lands downe”Gjiçan	Multietnike-rinore
18	Piktorët e rinjë “BOTART”	Promovuese -angazhuese
19	Q. R. “Zija Shemsiu “, Perlepnice	#####
20	Q.R. Studenti -Mires	#####
21	Q. R. Malishevë	
23	“Baro Amalipe “-romëve	Kult. Sport. -rome
24	Q. R. Luli –Llashtice	#####
25	Grupi Rinor”Ardhmëria jonë”, Verbicë e Zh.	#####
26	Grupi Rinorë –Bukovikë “GURËBARDHI”	#####
27	KCIC-Gjiçan	Organizata multietnike rinore

Burimi: Kuvendi Komunal Gjiçan

Sipas evidencës dhe angazhimeve të deritashme, këto organizma rinore kanë kontakte të përhershme me sektorin për rinjë, por ka edhe organizme të tjerë që nuk i posedojmë shënime për to.

Në kuadër të sektorit për Rini dhe në përfaqësim të shumicës së organizatave dhe subjekteve rinore, që nga qershori 2003 ekzistojnë Rrjeti “VULLNETARËVE RINORË AKTIV” që është shumë funksional në veprimin për çdo aktivitet rinor dhe manifestim institucional në nivel të komunës së Gjiçanit.

Ndërsa në kuadër të DKRS-së– Sektorit për Rini, funksionon Këshilli rinorë komunal që nga viti i kaluar. Kjo është një organizëm rinorë si trup këshillë dhënës për zhvillimet ndër rinore, e në të cilin përfaqësohen të gjitha organizatat dhe subjektet rinore.



Bashkëpunimi ne mes të Komunës dhe Organizatave rinore është i kënaqshëm dhe kryesisht zhvillohet përmes rrjetit rinor vullnetarë dhe Këshillit Rinorë, por edhe me secilën Organizatë apo subjekte rinore veç e veç, duke promovuar potencialin rinor ne pjesëmarrje të disa organizatave dhe sektorit për rini gjatë zhvillimit te aktiviteteve ne nivel te komunës. Kohëve të fundit në këto organizata është përfshirë edhe pjesëmarrja aktive e rinisë së fshatrave .

Një nivel me i lartë i zhvillimeve do te jetë më i pëlqyer nëse do te krijoheshin edhe më shumë hapësira rinore dhe po të siguroheshin me shumë mjete financiare.

Prandaj, Gjilani është e vetmja komunë në Kosovë që ka një organizim të këtyre formave për rininë ne përgjithësi, që meriton të përkrahët edhe më shumë.

### **Sporti**

Në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport, ekziston zyrtari i sektorit të Sportit i cili koordinon punët në këtë sferë. Ai harton planet e zhvillimit të sportit, përcjell punën e organizatave sportive kujdeset për mirëmbajtjen e objekteve sportive ekzistuese etj.

### **Asistenca e gjertanishme në këtë sferë**

Organizatat sportive janë ndihmuar nga KK me mjete materiale në bazë të kërkesave dhe projekteve të tyre që i kanë bërë Drejtorisë. Gjithashtu në mënyrë indirekte KK ka ndihmuar Organizatat sportive me investimet që janë bërë në përmasimin e infrastrukturës sportive: në rregullimin e Stadiumit të qytetit si dhe në Palestrën e Sporteve. Këto dy objekte Klubet dhe Ekipet sportive i kanë shfrytëzuar për zhvillimin e aktiviteteve të tyre pa kompensim.



Tab. 23: Regjistri I Klubeve Sportive dhe numri I anëtarëve sipas grup moshave

Nr	Emri i ekipeve	Pioner	Kadet	Junior	Senior	Gjithsej
1	KF. Drita	50	50	60	30	190
2	KF. Gjiçani	50	50	60	30	190
3	KB.Drita (M)	50	/	100	15	165
4	KB.Drita (F)	/	/	100	15	115
5	KH.Drita (M)	/	/	50	25	75
6	KH.Drita (F)	/	/	100	25	125
7	KV.Drita (M)	/	/	30	15	45
8	KV.Drita (F)	/	/	30	15	45
9	KK.Drita	30	30	30	50	140
10	KK.Gjiçani	20	20	20	40	100
11	K.Bok.Drita	/	/	20	20	40
12	K.P.P. Drita	/	/	10	10	20
13	K.P.P.Gjiçani	/	/	10	10	20
14	K.SH.Drita	/	/	15	10	25
15	KBOD	/	/	/	20	20
16	KS. Gjiçani	/	/	/	20	20
17	KJ. Gjiçani	20	20	20	20	80
18	KM.Gjiçani	20	20	20	20	80
19	KA.Gjiçani	/	/	/	/	40
	<b>Gjithsej</b>	<b>240</b>	<b>190</b>	<b>675</b>	<b>400</b>	<b>1540</b>

**S**

## përparësitë

- Traditë teatrore 60 vjeçare,
- Popullsi të re me energji krijuese,
- Pasuria e trashëguar Kulturore e Natyrore.

**W**

## dobësitë

- Hapësira e pamjaftueshme,
- Objektet janë të vjetruara,
- Mungesa e një Muzeu,
- Mungesa e Fushave Rekreative-Sportive dhe Parqeve,
- Mungesa e Buxhetit.

**O**

## mundësitë




- Ndërtimi i një Muzeu,
- Renovimi i Objekteve të vjetra të Kulturës,
- Ndërtimi i një Biblioteke Moderne,
- Ndërtimi i Shtëpisë së Rinisë,
- Renovimi i Arkivit Historik.

**T**

## kërcënimet

- Shkatërrimi i trashëgimisë kulturore.





**kufiri shtetëror fqitje**  
neighbour national border

**kufiri i Republikës së Kosovës**  
Republic of Kosovo border

**komuna e Gjilanit**  
municipality of Gjilan

**Kufiri kadastral**  
District border

**arsimi**  
education

**shkollë fillore /sh. E përzier**  
primary school/mixed school

**shkollë e mesme /komvikt**  
Middle school/hostel

**Fakultet**  
Faculty

**Administrata, O.fetare, kultura, sporti**  
Authorities: religion, culture, sport

**shtëpi e kulturës/administrata**  
culture house/administration

**Xhamia/Kisha**  
Mosque/church

**Teatri/arkivi**  
Theater/archives

**Sporti**  
Sport

**kujdesi shëndetësor**  
health care

**AMF / QMF / QKMF / Spitali**  
AFM / CFM / HCFM / hospitals

**Kuvendi Komunal Gjilan**  
Municipal Assembly Gjilan

**Plani zhvillimor komunal i Gjilanit**  
Municipal development plan of Gjilan

**Pozita e Komunitetit - infrastruktura sociale**  
Situation Municipality - Social Infrastructure


14.04.2008

Perfjeksi: Scale: 1:50,000

Plan 4

DIREKTOJA PËR URBANIZIM, RINDRIMIT DHE AMBIENT  
THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT

planingsgruppe 4





## 1.2.b ZHVILLIMI EKONOMIK

### Industria

Në komunën e Gjiçanit, industria ka qenë një faktorë i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik. Industria ka qenë e përfaqësuar nga shumë degë të prodhimit, si industria e përpunimit të çelikut, industria përpunuese e duhanit, prodhimi i radiatorëve të çeliktë, prodhimi baterive industriale, ndërtimtaria etj.

Shumica e këtyre ndërmarrjeve industriale punojnë me kapacitet shumë të vogël ose kanë ndërprerë aktivitetin e tyre prodhues për shkak të rrethanave të krijuara pas luftës në Kosovë.

Deri në vitet e 90-ta, Gjiçani kishte një ekonomi relativisht të qëndrueshme, dhe ajo përbëhej nga: Kombinati i Tekstilit, Kombinati i Duhanit, IBG, Fabrika e Radiatorëve, Çeliku, Grafikos, Elektrokosova, Morava e Binçës, Kosovatransi, PTK, Agrokultura, Veterinaria, Stacioni i Bujqësisë, Mirusha, Ekonomia e Pyjeve, 28 Nëntori, Anamorava, Qarkullimi, Teuta, Kristali, Drita, Hidroteknika, Ndërmarrja Komunale Publike, Kualiteti, Hekurishtja.

Mirëpo, shfrytëzimi dhe administrimi jo i drejtë i këtyre kapaciteteve, gjatë dhjetë viteve të kaluara, periudhë kjo kur shqiptarët ishin privuar nga e drejta e punës, kanë bërë që riaktivizimi i tyre të jetë i vështirë. Megjithatë, në shumicën e tyre ka rifilluar prodhimtaria.

**Fabrikat të cilat kanë qenë dhe mundë të jenë bartëse të zhvillimit të ekonomisë së Komunes së Gjiçanit janë:**

Ndërmarrjet bartëse të zhvillimit të ekonomisë së Gjiçanit, e ardhmëria e tyre qëndron në procesin e privatizimit i cili shkon me një ritëm shumë të ngadalshëm, edhe pse tani disa prej tyre punojnë me një kapacitet të kufizuar, janë:

- Fabrika për prodhimin e konstruksioneve të çelikut "Çeliku",
- Fabrika e radiatorëve dhe këmbyesve të nxehtësisë "Jugoterm",
- Fabrika për përpunimin e duhanit "IDGJ",
- Kombinati i tekstilit "Integj",
- Fabrika për prodhimin e Baterive Industriale IBG,
- Ndërmarrja Hidro Ndërtimore Industriale "Morava e Binçës",
- Ndërmarrja shoqërore- Grafikos,
- Industria ushqimore N.Sh. „Kualiteti“,
- Fabrika për prodhimin e ujit natyral të gazuar "Dea".



Këto kapacitete, edhe pse në shumicën e rasteve janë të vendosur në qytet, janë shumë të rëndësishme edhe për zhvillim rural sepse këtu mund të punësohen edhe punëtorë nga zonat rurale.

Fig.14: Fabrika për prodhimin e konstruksioneve të çelikut "Çeliku"



## Biznesi

Në Komunën e Gjiçanit sipas Regjistrimit të bizneseve në dhjetor 2002 kanë qenë 3,084 biznese të regjistruara me 9,961 të punësuar. Bizneset sipas sektorit të veprimtarisë janë: Tregtia me 1,730 biznese të regjistruara apo 56.1%, Industria përpunuese 277 apo 9.0 %, Transport dhe komunikacion 269 apo 8.7%, Hotelieri dhe restorante 256 apo 8.3 %, Ndërtimtari 166 apo 5.4 %, Afarizëm me pasuri të patundshme dhe shërbime të afarizmit 84 apo 2.7%, Arsim 45 apo 1.5%, Mbrojtje shëndetësore 36 apo 1.2 %, Bujqësi 30 apo 1.0 %, Industri minerale dhe ekstraktues 7 apo 0.2 %, Ndërmjetësim financiar 3 apo 0.1%, Furnizim me energji elektrike, gaz dhe ujë 2 apo 0.06 % dhe Veprimtari të tjera shoqërore 179 biznese të regjistruara përkatësisht 5.8 %.



Tab. 24: Numri i bizneseve të regjistruara në sektorin privat dhe shoqëror sipas seksionit të veprimtarisë

Lloji i Aktiviteteve	Gjithsej	A Bujqësia, Gjuetia dhe Pylltaria	B Peshkimi	C Industria e minierave dhe ekstraktues	D Industria Perpunuese	E Furniozimi me energji elektrike, gaz dhe uje	F Ndertimtaria	G Tregtia me shumice dhe pakice, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave dhe artikuljeve per perdorim personal dhe shtepiak	H Hotelet dhe restorantet	I Transporti, magazinimi dhe komunikacioni	J Ndermjetsimi financiar	K Afarizmi me patur i te patundshme, dhenja me qira dhe sherbimet e afarizmit	M Arsimi	N Mbrojtja shendetesore dhe sociale	O Veprimtarite te tjera shoqerore
Numri i Bizneseve sipas aktivitetit	3084	30	-	7	277	2	166	1730	256	269	3	84	45	36	179
Ndërmarrje	2422	22	-	6	206	2	153	1553	147	119	2	56	29	30	97
Ndërmarrës individuale	662	8	-	1	71	-	13	177	109	150	1	28	16	6	82
Të punësuar	9961	465	-	24	2983	75	1115	3455	635	425	7	175	142	65	395
Ndërmarrje me kapital te jashtem dhe perzier	36	1	-	-	6	-	3	19	2	-	-	1	2	2	-
Ndërmarrje që kanë nderprerë aktivitetin	124	-	-	-	12	-	4	59	12	28	-	1	-	-	8
Biznese me pronare femra (7.4 %)	231	2	-	-	16	-	8	157	2	-	1	-	7	6	32

Burimi: Kuvendi Komunal



Fillet e zhvillimit të bizneseve prodhuese janë nga fundi i viteve të tetëdhjeta, ndërsa hovi i zhvillimit dhe modernizimit të tyre është bërë në pesë vitet e fundit.

Furnizimin me lëndë të para bëhet nga importi prej shteteve ballkanike edhe ato të Evropës perëndimore dhe më pak nga tregu i brendshëm i Kosovës. Selitë e këtyre ndërmarrjeve prodhuese janë të vendosura kryesisht në pjesët periferike të qytetit dhe i përkasin kryesisht kategorisë së bizneseve të vogla dhe të mesme.

Në këtë Komunë janë 97 ndërmarrje prodhuese. Aktiviteti i tyre shtrihet në përpunimin e metaleve, përpunimin e drurit, tekstilit, industrisë ushqimore, etj.

Në këto ndërmarrje janë të punësuar 776 punëtorë, ndërsa qarkullimi vjetor në këto biznese është 5,622,765 €/vit.

Kapacitetet e këtyre ndërmarrjeve janë të nivelit të vogël. Për këtë arsye edhe u cek se i përkasin bizneseve të vogla dhe të mesme, ndërsa shfrytëzimi aktual i kapaciteteve është 50-70 %.

## Bujqësia

Komuna e Gjilanit, me një relief mjaft heterogjen dhe me një klimë të mesme kontinentale, ofron kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, përkatësisht degëve të saja: lavërtarisë dhe blegtorisë.

Vlerësohet se në etapa të ndryshme më se 60% e popullsisë së Gjilanit me rrethinë, është marrë me bujqësi dhe jo rastësisht qyteti njihet si agro-industrial.

Komuna e Gjilanit me një sipërfaqe prej 515 km<sup>2</sup> shtrihet në pjesën juglindore të Kosovës dhe vlerësohet se ka:

- rreth 14,200 ha, tokë të punueshme,
- mbi 20,000 ha pyje dhe kullosa, dhe
- 13,550 ha tokë djerrinë.

Para lufte bujqësia ka qenë bazë e mirë për sigurimin e jetës në zonat rurale dhe ka pasur ndikim të drejtpërdrejt, në zhvillimin e infrastrukturës së fshatit dhe avancimin e të gjitha sferave të jetës, përfshirë: arsimimin, kulturën, sportin etj.

Mirëpo, lufta në këto hapësira la gjurmë të rënda dhe me pasoja në infrastrukturën bujqësore, mekanizimin, varfëroi fondin edhe ashtu të varfër blegtoral. Pikërisht kjo gjendje ndikoi drejtpërdrejt në dyndjet e



popullatës në drejtim të qytetit, pa ndonjë perspektivë për ta dhe për vet fshatrat e boshatisura dhe sipërfaqet e tokave të lëna djerrina.

Sot, niveli i zhvillimit të bujqësisë është mjaft ekstensiv, në pamundësi të mbështetjes institucionale si dhe pa ndonjë stimulim që fermerët t'i qasen me përkushtim veprimtarisë bujqësore.

Ekonomia bujqësore, pas lufte kryesisht është orientuar në miniprojekte bujqësore, me vetiniciativë dhe pa ndonjë mbështetje financiare nga ana e mekanizmave institucional, por me disa ndihma në formë kryesisht të grandeve nga ana e disa OJQ-re, që veprojnë në Komunën.

Veprimtaria ekonomike bujqësore, kryesisht është e orientuar në miniferma të pulave vojse me kapacitete të vogla, kultivim të gjedheve me prodhimtari të kombinuar. Në fushën e lavërtarisë dominojnë kultura e grurit, misrit, thekrës dhe disa bimë foragjere. Zhvillim ka pasuar edhe nga lëmi i perimtarisë si në fushë të hapur, ashtu edhe në hapësira të mbuluara (minisera)

Tab. 25: Toka Bujqësore sipas Sektorëve

Sektori Shoqërorë	Sektori privat	Gjithsej
20.503 ha	30.962 ha	<b>51.466 ha</b>

Burimi: Kuvendi Komunal

Tab. 26: Toka Bujqësore sipas kulturave dhe sektorëve

	Sektori Shoqërorë
ara-kopshte	14 256 ha
pemë	186,6 ha
vreshta	10 ha
kullosa	5 746 ha
livadhe	1 350 ha
male	24 236 ha
Tokë e humbur	2 504,4
<b>Gjithsej</b>	<b>51 466 ha</b>

Burimi: Kuvendi Komunal





## Blegtoria

Blegtoria si një degë e Bujqësisë në Komunën e Gjilanit zë një vend të posaçëm kur kihet parasysh produktet dhe nënproduktet që merren nga bagëtitë, duke filluar prej mishit, qumështit e produkteve të tyre: leshit, gëzofit, lëkurës, plehut etj., ku popullata ka nevojë tepër të madhe e në veçanti për qumësht, mish dhe produkte të tyre.

Tab. 27: Fondi i bagëtisë në Komunë

Numri	Lloji	Krerë
1	Gjedhe	7200
2	Dhenë	4500
3	Dhitë	4000
4	Kuaj	217
5	Shpezë (pula vojse për konsum)	Afër 100.000
6	Derra	3000
7	Bletë	

**Vërejtje:** Fondi i gjedhëve, Dhenëve, Dhive, Kuajve, Derrave kryesisht është një fond i përbërë nga metisët e racave të ndryshme që nuk mundet të sigurojë një prodhimtari të dëshiruar nga to. Prandaj tek të gjitha këto lloje e në veçanti tek Gjedhet duhet shkuar në kultivimin e racave gjak pastërt dhe fisnike posaqërisht në raca qumështore (nga importi) kur dihet fare mirë se është nevojë shumë e madhe për qumësht dhe produkte të tijë të mbi 130,000 banorëve. Racat qumështore kryesisht do të kultivoheshin në vise të rrafshta.

Burimi: Kuvendi Komunal

## Agrobiznesi

Si pasojë e luftës dhe dëmtimeve që ka pësuar ekonomia bujqësore në sektorin e shtetëror është joaktive. Shumë kapacitete prodhuese, dikur shumë rentabile si Kombinati Bujqësor- Agrikultura me njësitë e saj dhe Stacioni për Përparimin e Bujqësisë, janë jashtë funksioni. Dikur, këto kompani kanë qenë gjigante të mëdha që kanë siguruar të hyra të larta për punonjësit e tyre.

Prona e pa definuar, mungesa e investimeve dhe konflikti i kompetencave me Shtyllën e IV-të të UNMIK-ut dhe AKM, i kanë sjellë këto kompani para shkatërrimit të pronës dhe mjeteve themelore të tyre.

## Ndërtimtaria

Fillet e zhvillimit të bizneseve ndërtimore dhe byrove projektuese janë nga fundi i viteve të tetëdhjeta. Ndërsa hovi i zhvillimit dhe i modernizimit të tyre është bërë në katër vitet e fundit. Selitë e ndërmarrjeve



ndërtimore janë të vendosura kryesisht në pjesët periferike të qytetit, ndërsa byrotë projektuese janë më tepër të vendosura në brendi të qytetit.

Në Komunën e Gjiçanit janë 85 ndërmarrje ndërtimore dhe byro projektuese të cilat iu ofrojnë qytetarëve shërbime: projekte ideore, projekte kryesore, dhe mbikëqyrjen e tyre gjatë realizimit (ndërtimit). Furnizimin me materiale ndërtimore bëhet nga tregu i brendshëm i Kosovës dhe nga importi nga shtetet ballkanike edhe ato të Evropës perëndimore.

Në komunën e Gjiçanit veprojnë edhe 6 gurëthyes.

Në këto ndërmarrje janë të punësuar 680 punëtorë, ndërsa qarkullimi vjetor në këto biznese është 4,671,120 €/vit. Kapacitetet e ndërmarrjeve ndërtimore dhe byrove projektuese janë: 9,340 m<sup>2</sup>/vit sipërfaqe të ndërtuara të objekteve banimi dhe afariste.

## Turizmi

Në komunën e Gjiçanit janë 244 ndërmarrje dhe punëtori hoteliere të cilat iu ofrojnë qytetarëve shërbime të fjetjes, ushqimit, pijeve alkoolike dhe joalkoolike, ahengjeve familjare, banketeve, seminareve, trajnimeve dhe shërbimeve të tjera. Hoteleria, furnizimin me mallra e bën nga tregu i brendshëm, mall i cili kryesisht është importuar nga shtetet ballkanike edhe ato të Evropës perëndimore.

Objektet hoteliere kryesisht janë të ndërtuara në brendi të qytetit dhe pjesërisht në pjesët periferike.

Në këto ndërmarrje janë të punësuar 976 punëtorë, ndërsa qarkullimi vjetor në këto biznese është 4,762,409 €/vit. Kapacitetet e objekteve hoteliere janë 14,640 m<sup>2</sup>.

Fillet e zhvillimit të bizneseve hoteliere janë nga fundi i viteve të tetëdhjeta, ndërsa hovi i zhvillimit dhe i modernizimit të hotelerisë është bërë në katër vitet e fundit.

## Tregtia

Në Komunën e Gjiçanit janë 1,813 ndërmarrje dhe shitore tregtare të cilat iu ofrojnë konsumatorëve lloje të ndryshme të mallrave si: mallra



ushqimore, higjienës, tekstilit, galanterisë së lëkurës, aparateve të amvisnisë, mobilierisë dhe mallrave të tjera të konsumit të gjerë.

Zhvillimit i tregtisë private në komunën e Gjilanit ka filluar nga fundi i viteve të tetëdhjeta, ndërsa hovi i zhvillimit dhe i modernizimit të tregtisë është bërë në 5 vitet e fundit. Mallrat kryesisht importohen nga Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, Turqia, Greqia dhe shtetet tjera të Evropës perëndimore por pak edhe nga tregu i Kosovës.

Objektet shitëse kryesisht janë të ndërtuara në brendi të qytetit dhe pjesërisht në periferi të tij dhe në fshatrat e Komunës së Gjilanit.

Në këto ndërmarrje janë të punësuar 6,345 punëtorë, ndërsa Qarkullimi vjetor në këto biznese është 64,915,597 Euro. Kapacitetet e objekteve shitëse janë 72,520 m<sup>2</sup>.

### **Analiza e zhvillimit ekonomik**

Mund të konstatojmë se ekonomia e komunës së Gjilanit është vazhdimisht e ballafaquar me probleme të shumta të shpenzimeve të mirëmbajtjes, normë të ulët të akumulimit, me punësim i cili ka stagnuar me vite dhe me probleme të transformimit të pronës. Orientimi kryesor dhe i përhershëm mbetet: zhvillimi ekonomik lokal nëpërmes procesit të privatizimit, zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, realizimi i projekteve të reja dhe krijimi i kushteve për një ambientit të shëndoshë dhe të sigurt i cili mundëson thithjen e kapitalit të jashtëm dhe nxitjen e NVM-ve vendore në veprimtari prodhuese.

Është me interes të thuhet se regjistrimi i bizneseve duhet të kthehet përsëri në kompetenca të zyrave për regjistrim të tyre në kuadër të qeverive komunale. Kjo duhet të behën për arsye të saktësisë së shënimeve që disponojnë këto zyre dhe për atë se në meset multietnike, siç është komuna e Gjilanit, minoritetet më parë i regjistruan bizneset e tyre në organet komunale. Kur ky regjistrim kaloi në kompetenca të Ministrisë për Tregti dhe Industri, shumica e tyre nuk i regjistruan në organet qendrore.

**S****përparësitë**

- Tradita industriale,
- Pozita e volitshme gjeografike,
- Ekzistimi i resurseve natyrore,
- Resurset njerëzore
- Ekzistimi i zonave të veçanta Industriale-Prodhuese
- Ekzistimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme prodhuese
- Procesi i privatizimit,
- Ekzistimi i tokave të pëlleshme bujqësore,
- Kuadër i mjaftueshëm profesional.

**W****dobësitë**

- Infrastruktura,
- Struktura e pavolitshme e bizneseve,
- Shfrytëzimi i vogël i kapaciteteve industriale,
- Teknologjia e vjetruar,
- Buxheti i pamjaftueshëm,
- Politika fiskale dhe kreditore jo e volitshme,
- Rritja e papunësisë,
- Degradimi i tokës bujqësore.

**O****mundësitë**



- Riaktivizimi i kapaciteteve ekzistuese,
- Riaftësimi i resurseve njerëzore- profesionale
- Ristrukturimi i proceseve të prodhimit bazuar në fleksibilitet
- Shfrytëzimi i kapaciteteve nga diaspora (joshja e investueseve),
- Krijimi i partneriteteve.

**O****kërcënimet**

- Largimi i kuadrit profesional nga komuna,
- Degradimi i mëtutjeshëm i tokës bujqësore,
- Investimi i pamjaftueshëm në prodhimtari.

**O****çështjet**

- Infrastruktura,
- Shfrytëzimi i kapaciteteve ekzistuese industriale,
- Shfrytëzimi i kapaciteteve tregtare,
- Mbrojtja e konsumatorit,
- Mbrojtja dhe stimulimi i prodhimeve,
- Përparimi i resurseve vendore turistike



Central institutions  
Institucionet gjendore  
Administration  
Administrata

Qendër rajonale  
Regional Capital

Central institutions  
Institucionet gjendore  
Administration  
Administrata

Qendër rajonale  
Regional Capital

Entrepreneurial tradition  
Tradita ndërmarrëse  
Mines  
Minierat  
Qytet industrial  
Industrial Town

Education  
Arsim  
Theatre  
Teatrit

Qendër kulturore  
Universitare  
Kinema  
Kinema

Tolerancë etnike  
Ethnic tolerance  
Culture houses  
Shtëpi kulturore

Komuna  
Gjiilan


Decent housing  
Kushite të mira banimi  
Qendra e  
Trekëndëshit të  
dyfishtë  
Jetesa urbane dhe rurale  
Social infrastructure  
Infrastruktura sociale

Rural development  
Zhvillimi rural  
Clean environment  
Ambient i pastër

Komunë bujqësore  
Agricultural Municipality  
Accessibility for villages  
Mundësia e kyqejeve të fshatrave  
Infrastruktura

Industrial production  
Produktimi industrial  
Cross-border trade  
Tregtia ndërkufitare  
Employment  
Punë

Entrepreneurial tradition  
Tradita ndërmarrëse  
Mines  
Minierat  
Qytet industrial  
Industrial Town



**Kuvendi Komunal Gjiilan**  
Municipal Assembly Gjiilan

Plani zhvillimor komunal i Gjiilanit  
Municipal development plan of Gjiilan

Potenciali zhvillimor ekonomike

14.04.2008

Plan 5  
Plan 6

DEPARTAMENTI PËR URBANIZIM, RINDERTIM DHE AMBIENT  
THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT

planungsgruppe 4



## 1.2.c MJEDISI DHE SHFRYTEZIMI I TOKËS


### Peizazhi dhe Mjedisi

qyteti i Gjilanit shtrihet në një fushëgropë të gjerë. Ndërkaq territori i komunës ka kushte të mira për bujqësi dhe njihet si komunë agro-industriale. Kategorizimi i tokave në bazë të përbërjes gjeologjike, mund të bëhet vetëm pas një hulumtimi të thellë pedologjik, por ajo që tash dihet është se në Komunën e Gjilanit dominojnë toka e kuqe argjilore të cilat shtrihen rrzëzë maleve, tokat aluviale që shtrihen në të dy anët e lumit Morava dhe lumenjve të tjerë më të vegjël, si dhe tipi i tokave smonicë, që kryesisht shtrihen në pjesën qendrore të komunës.

Në juglindje Gjilani i ka malet e Karadakut dhe një pjesë të Rrafshit të Kosovës – fushë pjellore.



Fig.15: Ndotësit e ambientit në Komunë



Gjilani karakterizohet me rrafshin e Anamoravës dhe zonat e larta malore përreth. Morava e Binçës, një ndër katërt lumenjtë më të mëdhenj të Kosovës, kalon përgjatë territorit të komunës.

Rrafshi i Anamoravës është një fushë bujqësore pjellore, dhe shumica e tokës së shkatërruar ka kualitet shumë të lartë. Shumica e tokës së



pjellëshme është punuar që nga mbarimi i luftës dhe vërehet një trend i avancimit të mëtutjeshëm.

Pjesët malore të komunës në shumicën e rasteve janë të mbuluara me shkurre dhe ngastra pemësh. Jugu është i dominuar nga malet e larta të Karadakut, të cilat gjithashtu e formojnë kufirin me Serbinë dhe me Maqedoninë. Zonat malore janë të pasura me resurse natyrore si p.sh. Argjend, Ar, Krom, Kopër, Hekur, Zing, dhe Volfram. Ekzistojnë disa miniera në këtë Komunë, të mbyllura dhe aktive. Lumi Morava e Binçes pjesërisht kalon nëpër malet e Karadakut, duke krijuar lugina pjellore rreth Pogradjës.

Teritorin e Komunës së Gjilanit e përshkon lumi Morava e Binçës, i cili mbledhë gjithë lumenjtë e vegjël, me një prurje mesatare mujore prej 6.7 m<sup>3</sup>/sekondë.

Komuna e Gjilanit përshkohet edhe nga tre lumenj të vegjël: Dobrusha, Stanishorka dhe Baja. Prurja maksimale e ujit të lumit Dobrusha është 0.22 m<sup>3</sup>/second, ndërsa sipërfaqja grumbulluese është 11.07 km<sup>2</sup>. Lumenjtë Stanishorka dhe Baja janë më të vegjël për nga prurja e ujit .

Në rrjedhat sipërfaqësore të ujërave në këtë komunë, lumi më i madh është Morava e Binçës, i cili rrjedhë nëpër pjesën e ulët të luginës së Gjilanit. Sasi më të mëdha të ujërave lumi Morava ka në muajin shkurt dhe mars, ndërsa sasia më e vogël është në gusht dhe shtator.

Rrjedha tjera të mëdha të lumenjve në territorin e komunës së Gjilanit janë: Lumi i Zhegovcit, Cernicës, Malishevës, Zhegrës, Llashticës, Llapushnikut, Pogradjës dhe Përlepticës.

Në territorin e kësaj komune gjenden dy liqe artificial, ai i Livoçit dhe i Përlepticës. Penda e Përlepticës shfrytëzohet për furnizimin e qytetit me ujë.



Fig.16: Pasuritë ujore të Komunës





## Flora dhe Fauna

Vegjetacioni i këtij territori në renditje vertikale mund të ndahet në këto breze vegjetative:

Brezi termofil i pyjeve të dushkut dhe qarrit.- Pyjet e dushkut përbëjnë brezin më të ulët, të cilat rriten në lokalitetet e ngrohta. Nga përbërja vegjetative dhe floristike, përveç qarrit, në këtë brezë bëjnë pjesë edhe llojet si: bungu ( *Quercus petraea* ), frashri ( *Fraxinus ornus* ), krekza , bliri ( *Tilia argentea* ), murrizi ( *Crategus monogyna* ), thana ( *Cornus mas* ), molla e egër ( *Mallus silvestris* ), lajthia ( *Corullus avellana* ).

Brezi kalues mezofil i pyjeve të bungut.- përveq bungut si lloj dominues i këtij brezi kalimtar hasim edhe llojet tjera përcjellëse si: krekza, frashëri, thana, shkozbardha, qershia, bliri etj.

Në katin e bimëve barishtore – llojet më të shpeshta janë: *Melica uniflora*, *Lathyrus venetus*, *Dactylus glomerata*, *Poliginatum officinalis*, *Galium sp.* *Latyrus inermis* etj.

Brezi mezofil i pyjeve të ahut.- Pjesa më e lartë, e sidomos në ekspozicionet veriore, pastaj një pjesë e madhe e Karadakut dhe Zhegovcit, është e mbuluar me pyje të ahut. Këto janë pyje të ulta dhe gradualisht kalojnë në pyje mesatare, të cilat lajmërohen në formacione të pastra dhe lokalitete të kufizuara.

Nga llojet barishtore dallohen *Violla silvestris*, *Fragaria vesca*, *Primulla vullgaris*, *Lonicera caprifolium* etj.





Fig.17: Vegjetacioni në Komunë





Ajo që e dallon florën dhe faunën e këtij rajoni janë ndryshimet intensive si pasojë e veprimtarisë së njeriut.

Zvogëlimi i sipërfaqeve pyjore, dhe shndërrimi i tyre në sipërfaqe të zhveshura kanë ndikuar në ndërrimin e mesit dhe zvogëlimin e llojeve të shtazëve dhe popullimit të tyre.

Derri i egër - në këto terrene tani është mjaft i pranishëm.

Ariu.- tërësisht është i shtytur nga këto terrene, sepse pyjet e degraduara, i kanë zvogëluar burimet ushqimore.

Nga llojet e sisorëve me vlerë ekonomike, të cilat edhe ashtu janë të rralla në pyjet e këtij territori janë kaprojtë të cilët janë të rrezikuar nga gjahtarët dhe ujqit gjatë gjithë vitit. Kushtet tjera ekologjike janë optimale për rritjen e fondit të tyre.

Dhelpra.-popullimi i tyre është gjithnjë në ngritje në tërë territorin e komunës.

Macja e egër, Vjedulla, Bukla, numri i këtyre shtazëve me të madhe po zvogëlohet.

Lepuri i arave.- në këto hapësira territoriale shikohet si lloj mjaft i dëmtuar për shkak të gjuetisë së tepruar dhe ekziston bindja se nëse nuk ndërmerren masa mbrojtëse, rrezikohet reproduksioni normal i këtij lloji.

Zogjtë e tjerë të pranishëm, janë: rrëmbyesit e natës, familja e sorrave, çukapikthi, lejleku, etj.

Zvarranikët në këtë rajon përfaqësohen nga: Breshka e moçaleve dhe breshka pyjore, gjarpinjtë e ndryshëm, bretkosa, hardhuca etj.

Peshqit .- në këtë territor janë të përfaqësuar me llojet e tyre karakteristike si: krapit, bërcaku, mlyshi etj.

Kushtet më të volitshme për rritjen e peshqve janë në akumulacionet e Livoçit dhe Përlepnicës, ndërsa uji i lumit Moravë dhe degëve të saj është i ndotura nga mbeturina dhe ujerat industriale.

Ajri që ne e thithim, uji që e pimë dhe ushqimi që e hamë, të cilat rriten në tokat përreth nesh, janë të gjitha me interes vitale për shëndetin e popullsisë. Mjedisit i ndotur është pasojë e kërcënimit serioz. Megjithatë gjendja e mjedisit në Gjilan është më e mirë se në Prishtinë, (Gjilani ka mjedis relativisht të pastër për jetesë), ruajtjes së mjedisit duhet kushtuar kujdes edhe me të madh..

Ndotja e ajrit shkaktohet nga përzierja e substancave që lirohen prej natyrës ose prej njeriut. Burimet më të mëdha të ndotjes së ajrit janë: trafiku, (makinat me motor, shpeshherë pa katalizator), industria, bujqësia (metani, nitrogjeni dhe oksidet e nitrogjenit) dhe deponitë e hapura (metani dhe CO<sub>2</sub>). Industria ka qenë ndër ndotësit më të rëndë gjatë viteve të 1980-ta, kur prodhimi ishte i lartë. Gjatë viteve të 1990-ta





dhe veçanërisht gjatë luftës më 1999, prodhimi në shumë reparte industriale ose ka rënë shpejt ose është ndaluar në tërësi. Si pasojë, ndotja e ajrit nga industria është zvogëluar. Me rritjen e aktiviteteve ekonomike në vitet e fundit, është rritur edhe ndotja, por është akoma më e vogël se në fund të viteve të 1980-ta.

Uji është një nga burimet më të rëndësishëm natyrore. Përdoret për pije, për përdorim industrial, për ujitjen e tokës bujqësore, për rekreacion etj. Disa nga problemet kryesore të kualitetit të ujit, janë mungesat e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza. Shumë depo ilegale të mbeturinave, përdorimi i plehrave kimike në bujqësi dhe nxjerrja e rërës dhe zhavorrit nga shtretërit e lumenjve ndikojnë në kualitetin e ujit në këtë rajon. Një problem tjetër i madh është vetëdijesimi i ulët i popullatës mbi përdorimin e ujit. Morava e Birçes është lumi më i madhë në Gjiçan. Pjesa më e lartë është klasifikuar si kategori II-të (në një shkallë prej I deri IV, ku I- uji më e pastër dhe IV- uji më e ndotur), pjesa më e ulët (pas qytetit të Gjiçanit) është klasifikuar si kategoria II-b.

Fig.18: Shishet e plastikës dhe mbeturinat tjera në Moravën e Binçes



Shumica e fushave dhe vendbanimeve rreth Moravës së Birçes, si dhe zona jug-lindore e qytetit të Gjiçanit janë të rrezikuara nga vërshimet. Shtretërit e lumenjve kanë qenë të shkatërruar në sipërfaqe të mëdha



nga nxjerrja e pakontrolluar e rërës dhe zhavorrit. Hedhja e mbeturinave në shtretërit e lumenjve, derdhje e ujërave të zeza përgjatë shtratit të lumit, uzurpimi i tokës në të dy anët e lumenjve dhe mungesa e mirëmbajtjes së shtretërve të lumenjve nga institucionet përkatëse, janë disa nga faktorët që ndikojnë në shkatërrimin shtretërve të lumenjve. Vërshimi i ujërave përtej shtretërve të lumenjve është gjithashtu rezultat i faktorëve natyror, siç janë reshjet për një periudhë të gjatë kohore, dhe pasojat e vërshimeve që përhapën sipër tokave bujqësore. Afërsisht 6% e shtretërve të lumit Morava e Birçes është e shkatërruar .

Bujqësia është një nga fushat më të rëndësishme ekonomike në Gjilan dhe Kosovë. Toka e mirë bujqësore është limituar. Humbja e tokës bujqësore është rritur në vitet e fundit. Arsyeja kryesore e humbjes së tokës bujqësore është shtrirja e vendbanimeve. Edhe nxjerrja e rërës dhe zhavorrit, erozioni dhe degradimi, gjithashtu kanë një rol të rëndësishëm në humbjen e sipërfaqeve bujqësore.

Druri në Kosovë përdoret për ndërtim, artizanale tradicionale, përpunim industrial dhe nxehje. Në komunë disa pjesë e prera të maleve janë pyllëzuar.

Gjilani shtrihet në një zonë të rrezikuar nga tërmetet. Niveli i fuqisë sizmike në jug-lindje të Kosovës është 9R. Tërmeti i fundit që ka ndodhur në Kosovë ishte më 24 Prill 2002 në Gjilan dhe fshatrat përreth. Fuqia e tij ishte 5.4 shkallë të Riterit.

## **Pasuritë minerale**

Rrethina e Gjilanit është e pasur me xehe (hekur e leucid) dhe me burime minerale (Nasalë, Pidiq, Kmetoc, Pogragjë, Perlepticë). Dallohet nga komunat tjera me një pedologji më homogjene. Në pjesën më të madhe dominojnë tokat ngjyrë kafe në gëlqerore dhe dollomit e më pak toka fluviale dhe smonica.


Hulumtimin e kreu Instituti i Gjeologjisë në Beograd – 1977. Hulumtimi i mostrave në rajonin e Gjilanit ka përfshirë 42 mostra. Hulumtimi i këtij materiali është bërë me qëllim të caktimit të përbërjes minerale në aspektin kualitativ. Mostrat e këtij rajoni japin ndryshime të dukshme ndërmjet vete në përbërjen e komponentëve të mineraleve. Sipas koncentrimin të disa mineraleve ato janë ndarë në disa grupe.

Grupi i parë- në mostrat e këtij grupi është e theksuar koncentrimi i LliminitEpidotit dhe Hematitit.



Sipas përfaqësimit, pastaj vijnë Granat, Magnetit, Amfibol, Cirkon, Pirit, ndërsa mineralet e tjera Kuarc, Felspat, Turmalin, Rutil, Piroksen, Titanit, Biotit, Klorit, Apatit, Brukit, Kromit, Muskovit, Staurolit, Disten, janë të përfaqësuar në sasi më të vogla ose në disa thërmija.

Fig.19: Pasuritë minerale të Komunës



Nga mineralet e rralla dhe interesante janë konstatuar: Shiliti dhe Galeniti.



Grupi i dytë- në mostrat e këtij grupi janë të koncentruar: Kromi, Magnetiti dhe Opidoti- dukshëm më i theksuar në krahasim me mineralet tjera. Nga përmbajtja pastaj vijnë: Amfiboli, Ilmeniti, Granati, Cirkoni, ndërsa mineralet e tjera si Hematiti, Turmalini, Rutili, Piriti, Pirokseni, Biotiti etj. janë më pak të përfaqësuar.

Grupi i tretë- te këto prova është vërejtur dominimi komponentësh të Hematitit. Në sasi më të vogla janë konstatuar Epidoti, Piriti, Amfiboli, Ilmeniti, Cirkoni, Magnetiti, ndërsa komponentët e mineraleve të tjera: Turmalini , Rutili, Pirokseni, Titani, Biotiti, janë konstatuar në sasi minimale.

### **S** përparësitë

- peizazh atraktiv bujqësorë në rrafsh-luginë,
- lumenj dhe përranj të pastër,
- tokë pjellore dhe kushte të mira për bujqësi,
- malet janë të pasura me pasuri natyrore.

### **W** dobësitë

- shumë groposje ilegale,
- mbeturinat dhe kanalizimi derdhen direkt në lumenj,
- konflikti mes gurores dhe lumenjve,
- shumica e tokës bujqësore është e papunuar,
- Nën-ndarja e pafavorshme, shkalla e ulët e tokës bujqësore,
- pyjet janë të rrezikuara nga shpyllëzimi.

### **O** mundësitë

- Bujqësia me kohë mund të zhvillohet në një industri të rëndësishme,
- Peizazhi atraktiv mund të jetë bazë për zhvillimin e industrisë së turizmit.

### **T** kërcënimet

- Ndotja e mjedisit e kërcënon bujqësinë, turizmin dhe shëndetin e banorëve të Gjilanit,
- Problemet ekonomike dhe vetëdijesimi i ulët i popullsisë, e pengojnë mbrojtjen e mjedisit.

### **→** Çështjet

- Mbyllja e groposjeve ilegale,
- Zhvillim i qëndrueshëm i bujqësisë,
- zhvillimi i strategjisë për mbrojtje të ambientit.





## Trashëgimia Kulturore

### Detyrat institucionale

Mbrojtja e monumenteve historike në Kosovë është përgjegjësi e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit. Detyra lidhur me identifikimin, dokumentimin, shqyrtimin, arkivimin dhe kujdesin për mbrojtjen e monumenteve historike në Kosovë i është dhënë Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës (IMMK) në Prishtinë. Krahas zyrave lokale të institutit, ekziston edhe niveli komunal. Në këtë nivel përfaqësohet edhe Gjiçani. Zyra lokale e Gjiçanit (Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore / Regional Centre for Cultural Heritage) është e vendosur në ndërtesën e teatrit në qendër të qytetit. Puna e instituti është e penguar nga fakti se të gjitha dokumentet mbi monumentet historike të prodhuara para luftës janë transferuar në Beograd.

Puna e stafit të zyrës së Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve në Gjiçan, është përqendruar në identifikimin e llojeve të ndërtesave dhe strukturën e vendbanimeve si pjesë e trashëgimisë kulturore lokale. Këto të dhëna dhe njohuri do të jenë në shërbim të popullatës me qëllim të njohjes me vlera historike dhe kulturore nga e kaluara duke mbajtur gjallë kujtesën për të kaluarën e kësaj ane. Kjo normalisht është e siguar, pasi që kjo zyrë është e konsultuar rregullisht, dhe nga kjo gjithmonë kërkohet pëlqimi në aplikimin e lejeve urbanistike në qendrën historike të qytetit, dhe gjithashtu në zonat tjera ku gjendja e ndërtesave me vlerë historike dhe struktura e vendbanimeve është shqetësuese.

Për të lehtësuar kushtet e punës së zyrave lokale, dhe për ta treguar rëndësinë e punës së tyre është e dëshirueshme për ta zhvendosur atë në një vend më të gjerë- dhe më të përshtatshme për publikun. Ishte sugjeruar që të përdorej ndërtesa Saraji i M. Pashës, e cila për momentin është duke u përdorur për Shkollë të Muzikës.

### Baza Ligjore

Deri në vitin 1949 në Kosovë si pjesë e ish Jugosllavisë, ishin identifikuar dhe klasifikuar ndërtesat me vlera historike si monumente historike. Gjithsej 426 objekte në Kosovë janë mbrojtur sipas Ligjit akoma të aplikueshëm të Kosovës mbi Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore të vitit 1977. Në vitin 1992 dhe 1996 ishin miratuar ligje të reja në Serbi, por

---

<sup>7</sup> " Ligji mbi mbrojtjen e Monumenteve Kulturore "; Ligji i Kosovës nr. 19/77. Në përmbledhjen e ligjeve : 1977



që nuk janë pranuar dhe shpallur në Kosovë. Kështu, ligji i vitit 1977 është ende në fuqi. Pas viti 1968, megjithatë, asnjë ndërtesë më nuk është atribuuar për mbrojtje formale me ligj në Kosovë. Për disa objekte ka vetëm sugjerime të përkohshme. Për shkak të situatës politike para luftës, konsiderohet si e dyshimtë që zgjedhja e objekteve që duhet të mbroheshin ishin përzgjedhur vetëm për nga rëndësia shkencore. Preferencat kulturore dhe vlerësimet nga kjo pikëpamje varen shumë nga funksionet e objekteve përkatëse. Një qëndrim korrekt i arsyeshme dhe i drejtë është i nevojshme për të ardhmen, për ti mënjanuar prirjet e tilla të përzgjedhjes dhe për ti ruajtur të gjitha llojet e objekteve të jetës kulturore, dhe shenjat e historisë lokale të cilët e përbëjnë kulturën specifike të Kosovës dhe gjithashtu Gjilanit.

Rëndësia e mbrojtjes së Monumenteve historike për zhvillimin komunal nuk është vetëm prosperiteti ekonomik, apo ai që krijon pamjen e një qyteti modern, por gjithashtu faktorët e bukurisë së peizazhit të atij qyteti, peizazhi i tij përreth, llojllojshmëria e tij kulturore, indigjeni "shpirti" i lokacionit dhe tipari i tij i veçantë i mjaftueshëm së paku i paraqitur nga ndërtesat e tij historike. Në këtë shtesë, vetëdija e historisë lokale, shkon larg përtej kohës së mesjetës në origjinën Romane, Ilirike dhe madje parahistorike. Kështu që brenda një strategjie gjithëpërfshirëse për zhvillimin e komunës, rruajtja e vendqëndrimit të ndërtesave historike është më shumë se thjesht një çështje kulturore. Por ajo gjithashtu kontribuon në faktorët (e këndshëm) të zhvillimit komunal brenda një shoqërie moderne. "Trashëgimia kulturore dhe natyrore siguron ndjenjën e identiteti dhe ndihmon në dallimin e komuniteteve në atmosferën e globalizimit" (MESP 2005, 14). Rëndësia e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Kosovë është e nënvizuar me notifikimin e tij në dokumentin zyrtar "Standardet për Kosovën" të cilët duhet të arrihen: "Trashëgimia kulturore e Kosovës është respektuar si pronë e përbashkët e të gjitha etnive, religjioneve dhe komuniteteve gjuhësore të Kosovës."<sup>8</sup>. Ky qëllim duhet të ushtrohet sipas standardeve të BE-së.





Fig.20: Një fushatë nga Ministria e Kulturës ka për qëllim ngritjen e vetëdijesimit të publikut për trashëgimin kulturore.

Në komunën e Gjiçanit ekzistojnë shumëllojshmëri të ndërtesave historike si në qytet dhe në fshatrat që i kanë mbijetuar rrjedhën e kohës qoftë të periudhat e vlerësimit të lartë të këtyre ndërtesave apo edhe të periudhat e neglizhencës dhe shkatërrimit. Ato janë dëshmi të individualitetit kulturor lokal dhe rajonal të cilat janë zhvilluar nën kushtet e veçanta historike, socio-ekonomike, etnike dhe fetare. Gjatë luftës së fundit Gjiçani nuk i ka përjetuar shkatërrimet e ashpra të luftës sikur rajonet tjera të Kosovës, kështu edhe trashëgimia kulturore lokale nuk ishte dëmtuar aq shumë sa në vende tjera.

Asgjë nuk është ndërtuar përnjëherë, megjithatë, edhe substancat me të vogla historike duhet të pranohen. Sidoqoftë, për çfarëdo ndërgjegje të shoqërisë, të së kaluarës së saj dhe origjinës së saj, është e domosdoshme që të definohet pozita e saj në kohën e tashme. Kjo veçanërisht është me interes për komunitetin shqiptar dhe kulturën e tyre që duhet të përballen me rregullat mbizotëruese Otomane dhe Serbe. Kultura ka qenë një bazë e rëndësishme për kohezionin e tyre, si komunitet. Kjo natyrisht është me interes edhe për komunitetet e tjera etnike, sidoqoftë, ndërtesat historike relevante veçanërisht për këto komunitete në komunën e Gjiçanit janë të rralla. Për ta ruajtur atë që ka mbetur nga trashëgimia kulturore e ndërtesave historike dhe vendndodhjeve parahistorike, këto objekte dhe lokalitete duhet të përfshihen gjithashtu për planifikimin e tanishëm të zhvillimit të qytetit dhe fshatrave të komunës së Gjiçanit.

Për Planin Zhvillimor qëllimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore, duhet të shndërrohet në veprime konkrete dhe duhet të reflektohet se si të garantohet menaxhimi i duhur. Megjithëse prioriteti i



parë duhet të futet në një strategji në rritjen e vlerave të ndryshme të objekteve të ndryshme, dhe përdorimi i tyre ,p.sh.

- Zgjerimin e mundësisë lokale për kohë të lirë,
- Prezantimi i tërheqës për turizëm,
- Rritja e mirëkuptimit të ndërsjellë të komuniteteve të ndryshme,
- Tërheqja e investuesve, sigurimi i punës etj.

(MMPH 2005, 15)

Kujdesi meritor i ndërtesave historike dhe mjedisi urban në Gjilan të llogaritura për trashëgimi kulturore.

Ndonëse vendbanimi më i hershëm është dokumentuar se daton që nga shekulli i 14<sup>th</sup> qyteti i tanishëm i Gjilanit është daton nga gjysma e dytë të shekullit 18<sup>th</sup> nga familja Gjinaj. Kështu që qyteti është aq i "hershëm" si edhe momentet e tij historike. Për shkak të situatës politike të mëparshme në Kosovë dhe zgjedhja e njëanshme etnike e objekteve të trashëgimisë kulturore që duhet të mbrohen me ligj, nuk ekzistojnë shumë ndërtesa të veçanta të mbrojtura me ligj në komunën e Gjilanit. Shumica e monumenteve të rëndësisë përkatëse historike e kulturore ende nuk janë të mbrojtura me ligj.



Tab. 28: Lista e Monumenteve Historike të mbrojtura me ligj /1/

Qarku I Kosovës dhe Anamoravës Komuna e Gjiçanit

Nr.	Lokalitet		Shekull	
1.	Pogradj	Kalaja	XIV	nr.v.E.K.251/56
2.	Kmetovc	Mbeturinat e Kishës së Shën Varvarës (Shën Dhimitrit)	XIV	nr.v. E.K. 02-369/63
3.	Koretishtë	Lokalitet Arkeologjik "Grançaricë"	III-VI	nr.v. E.K. 02-118/80
4.	Strazh	Manastiri i Shën Nikollës	XVI	nr.v. E.K. 02-119/80
5.	Stanishor	Lokalitet Arkeologjik në Qendër të Fshatit me Kishë	III-VII	nr.v. E.K. 120/80
6.	Pasjanë	Kisha e Shëndrrimit	1861	nr.v. E.K. 02-121/80
7.	Gjiçan	Kolekcion Ikonash në Kishën e Shën Nikollës	XIX,	nr.v. E.K. 02-153/80
8.	Gjiçan	Shtëpi në Rr. Stojan Trajkoviçi, Nr. 19	XIX	nr.v. E.K. 02-254/80
9.	Gjiçan	Atik Xhamia	XVII	nr.v. E.K. 02-156/80
10.	Llashticë	Tumat në Potezin "Gomula"	X-VIII para eres sonë	nr.v. E.K. 02-393/80
11.	Veleknicë	Lokalitet në Potezin "Koka e Ilisë"	II-VI	(1984)
12.	Dragancë	Manastiri i Kryeengjullit		Pakoja e Ahtisarit

**Shënim** /1/ Ligji mbi mbrojtjen e Monumenteve Kulturore nga Ish-Republika Federale e Jugosllavisë, (1977); cili ende është i aplikueshëm.

**Burimi** : Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës

Me qëllim që të freskohet dhe kompletohet kjo listë e monumenteve historike, në vitet 2002 deri 2004, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore, ka punuar në një inventarizim, duke i grumbulluar të dhënat mbi objektet me rëndësi kulturore në Kosovë, i cili mund të jetë një burim tjetër i informatave mbi ndërtesat që të radhiten në trashëgimin kulturore të vendit (cf. Tab 12-2). Për më tepër ekzistojnë ndërtesa dhe vendqëndrime ose grupe ndërtesash me vlera historike dhe kulturore tanimë të caktuara si ndërtesa historike të radhitura në bazën e të dhënave relevante. Puna e mëtejme është bërë nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Gjiçan. Të gjitha këto ndërtesa duhet të kujdesen në mënyrë të barabartë derisa të vendoset për statusin e tyre ligjor për mbrojtje.



Tab. 29: Listat e inventarizimit të Monumenteve Historike dhe Objekteve në Komunën Gjiçan sipas lokacioneve - Inventarizimi i Vlerave të Kulturës Materiale në Gjiçan.

Nr.	Komuna dhe vendi	Objekti	Periudhe, Shekull, Viti
766	Bresalc	Xhamia e Re	2003
	Budrik e Ulët	Kisha e Shën Pjetrit	
774	Capar	Xhamia e Fshatit	Shekull XX
760	Cernice	Xhamia e Fshatit	Shekull XIX
	Cërnice	Kisha Ortodokse	
	Cërnice	Kisha Ortodokse	
775	Doberçane	Xhami Fshati	1422 Tani E Re
776	Doberçane	Xhamia e Fshatit	1902
	Draganc	Manastiri i Kryengjullit	
759	Gjiçan	Xhamia Qenëer Qeshme	Shekull XIX
758	Gjiçan	Xhamia Xhedit	Shekull XIX, Tani E Re
757	Gjiçan	Xhamia e Madhe	Shekull XIX – XX
797	Inatovc	Lokalitet Arkeologjik Inatovci	Periudha Romake
	Koretisht	Kisha Ortodokse	
780	Kravaric	Mesxhidi i Fshatit	Shekull XX
	Kusic e Epërme	Kisha Ortodokse	
765	Livoq e Eperm	Xhamia e Fshatit	Shekull XX
764	Livoq I Ulet	Xhamia e Fshatit	Shekull XX
791	Lladove	Llambari i Sh. Mahmutit	Shekull XIX
781	Lladove	Mesxhidi i Lladovit	Shekull XX
763	Llashtice	Xhamia e Fshatit	Shekull XX
788	Llashtice	Shtëpia e R.Selimit	Shekull XIX
789	Llashtice	Oda e B.Selimit	Shekull XIX
790	Llashtice	Hambari i F. Llapashtices	Shekull XIX
787	Llovce	Kishe Varrezore	Periudha Osmane
773	Llovce	Xhamia e Fshatit	Shekull XX
783	Makreshe i Ulet	Mesxhid Fshati	Shekull XIX
782	Malisheve e Eperme	Mesxhidi i Fshatit	Shekull XX
769	Malisheve e Ulet	Xhamia e Fshatit	Shekull XX



798	Melc	Rrenojat e Kishes	
767	Muçibabe	Xhamia e Fshatit	Shekull XX
792	Nasal	Koshi i T.Selimiti	Shekull XX
	Partesh	Kasha Shën Trinit	
	Pasjan	Kisha e Shndrrimit	
777	Perlepnice	Xhamia e Fshatit	Shekull XIX
762	Pidiq	Xhamia e Fshatit	Shekull XX
796	Pogragje	Lokalitet Arkeologjik "Pode"	Periudha Osmane
771	Pograxhe	Xhamia e Fshatit	Shekull XX
	Shillov	Kisha e Shën Markut	
	Sjilan	Kisha e Shën Nikollës	
779	Sllakoc i Epërm	Xhamia e Fshatit	1770
784	Sllakoce i Ulet	Mesxhid Fshati	Shekull XX
772	Sllubice	Xhamia e Fshatit	Shekull XX
785	Stanishor	Kisha e Shen Gjergjit	Periudha Osmane
795	Stanishor	Nekropole e nek antikes se vone	Shekull IV-VI
786	Strazha	Kisha e Shen Premtes	Periudhe Osmane
794	Strazhe	Tuma	Parahistori
770	Uglare	Xhamia e Fshatit	Shekull XX
768	Veleknic	Xhamia e Fshatit	1936
793	Verbic e Zhegovcit	Hani i Shefkut	Shekull XIX
778	Verbice e Zhegovcit	Xhamia e Fshatit	1866
761	Zhege	Xhamia e Fshatit	Shekull XX

**burimi:** Inventarizimi i trashëgimisë kulturore të objekteve në territorin e Kosovës (02); IKMMK Prishtina 2004 / 2006

**Shënim:** Puna e inventarizimit ende është në progres, e përgatitur nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë e Gjiçanit.

## Monumentet Historike në fshatra dhe në peizazhet e hapura

Fortifikata antike janë gjetur në fshatrat Gadish, Miresh, Resul, Përlepnice dhe Pograxhë. Një ndër më të mbrojturat është fortifikata / kalaja e Pograxhës nga shekulli i 16-të, me muret që akoma arrijnë lartësinë në 4m dhe kështjellat nga të cilat më e madhja, që është mbrojtur, me



lartësi prej 10m. Ato duhet të mbrohen me kujdes nga prishjet e mëtejme. Fortifikata shtrihet në një peizazh të bukur dhe ka rrethinë shumë të mirë natyrore.



Fig.21: Fortifikata/ kalaja e Pograxhës nga shekulli i 16 është i vendosur në peizazhin dhe rrethinën e bukur. Kjo zonë mund të zhvillohet në park.

Zona përreth kalasë mund të zhvillohet si një park i peizazhit të hapur për publikun për ekskursionë, vikende dhe shëtitje për familje. Kjo do të zgjerohet mirë me vendkalimin e këmbësoreve që të dërgojnë në grykën e lumit Llapushnica e që e krijon një zonë të mrekullueshme natyrore për rekreacion.

Në kohët e mëparshme zona e Gjilanit ishte shumë e njohur për burime natyrore të ujit. Disa nga to kanë mbetur në funksion edhe në ditët e sotme p.sh. fontana e Sahit Agës. Këto burime të ujit duhet të mbrohen dhe mjedisi i tyre duhet të organizohet në mënyrë të përshtatshme.





Fig.22: Burimi i i Sahit Ages në Gjilan, Çezma e Sahit Agës



Objekte tjera të rëndësishme në zonën rurale të Komunës janë mullinj të vjetër që e paraqesin jetën bujqësore tradicionale të së kaluarës, dhe artizanalet dhe ndërtesat fetare. Kujdes i veçanët duhet ti kushtohet Xhamisë së vjetër në Zajçe e cila për shkak të ndërtimit të saj tradicional me dru dhe argjila është në gjendje të keqe dhe ka nevojë për mbrojtje. Gërmadhat madhështore të kishës së St. Barbara (të shekullit 14<sup>th</sup>) në Kmetofc, e cila ishte pjesë e manastirit e cila i ishte dedikuar St. Demetrios e shkatërruar në shekullin 18<sup>th</sup>, gjithashtu duhet të mbrohet.



Fig.23:Dy kulla në Kurexhaj dhe një në Terziaj.

Kulla në Kurexhaj ka nevoj për mbrojtje urgjente nga shkatërimi i mëtejshëm. Vetëm një në Terziaj ende është e banueshme - një parakusht i mirë për mbrojtjen e saj.



Kullat në fshatrat e zonave të ulëta të Anamoravës janë të ndryshme nga ato të zonave të ulëta të Dukagjinit për nga materialet e tyre specifike dhe dizajni. Ato kanë nevojë për kujdes të veçantë për ta mënjanuar shkatërrimin e mëtejme. Disa tanimë janë në prishje dhe duhet të restaurohen sipas ndërtimit të tyre tradicional. Nuk mund të pritet që pronarët të jenë të zotët ti bëjnë ato restaurime. Kështu që është e nevojshme përkrahja adekuate, si më poshtë:

- Këshilla praktike për një përdorim më adekuat të mëtejme,
- Këshillë teknike, si të mbrohen ato, si dhe
- Subvencione së paku në financa për mbrojtje bazë nga shkatërrimet e mëtejme.

Zonat e gërmimit janë të vendosura në fshatrat Cernicë, Koretishtë, Llashticë, Mireshe, Përlepnicë, Pidiç, Pograxhë, Stanishor dhe Velekincë. Zona e gërmimit në Cernicë është një nga më të mëdhatë, ku shumë objekte parahistorike të fisit Dardan ishin gjetur. Në fshatin Pograxhë objektet e Romanëve dhe epokës së vjetër Romane ishin gërmuar. Këto zona duhet të sigurohen nga gërmimet ilegale që e shkatërrojnë funksionin e tyre si dritare të së kaluarës.

## **S** përparësitë

- Ndërtesat e trashëgimisë kulturore në qytet si dhe fshatra që kanë shërbyer më herët ose edhe tani për çështje të ndryshme shoqërore, komerciale, kulturore ose fetare ose që janë përdorur për shtëpi private, kontribuojnë në bukurin e qytetit dhe imazhin e Gjilanit si një komunitet me tradita të shëndosha kulturore.
- Gërmimet në vende të ndryshme në komunë, e vërtetojnë periudhën e gjatë të vendbanimeve në pjesët e ulëta të Anamoravës.
- Disa objekte janë pika referimi që e përcaktojnë pamjen, si dhe mjedisin urban, p.sh. fortifikatat/kalatë ose xhamit dhe kishat

## **W** dobësitë

- Për shkak të shkatërrimeve gjatë luftës, objektet historike kishin humbur ose ishin shkatërruar tërësisht. Por gjithashtu shumë ndërtesa të kohës së fundit të vlerave



historike, si p.sh. Xhamia e madhe ishte rrënuar për një ndërtim të ri.

### **O** mundësitë

- Ekzistojnë objekte atraktive të trashëgimisë kulturore në fshatra dhe më peizazhin e hapur si kalatë e vjetra, kullat dhe mullinjtë dhe rrethinat e tyre përkatëse, mund të zhvillohen si zona atraktive për turizëm dhe kohë të lirë.
- Disa fusha të gërmimit janë me interes kombëtar dhe mund ti tërheqin vizitorë qoftë edhe nga jashtë, nëse ekspozita profesionale e objekteve është siguruar dhe udhëzimi është i gatshëm.

### **T** kërcënimet

- Humbja e mëtejme e objekteve në të ardhmen mund të shkaktohet nga fakti se, shtëpitë e vjetra nuk i ndeshin performancat e tanishme, renovimi është i shtrenjtë dhe rezultate janë shumë pak atraktive për pronarët sesa të ndërtojnë shtëpi të reja.
- Për shkak të materialit të tyre të ndërtimit, p.sh. argjilë dhe dru, ndërtesat tipike për rajonin janë kërcënuar nga shkatërrimi për shkak të kushteve atmosferike.
- Veçanërisht në fshatra ndërtesat tradicionale ose pronarët privat shpeshherë kanë qëndrim neglizhuese.

### **→** objektivat

- Ndërtesat historike në qytet dhe në fshatra duhet të ruhen fizikisht dhe mbrohet nga shkatërrimet e mëtejme.
- Pronarët privatë duhet të mbështetën me informata teknike.
- Ndihma financiare duhet të jetë e gatshme për pronarët që ju mungojnë mjetet e mjaftueshme për mirëmbajtjen e objekteve të tilla.
- Punët rehabilitues mund të integrohen në një program për trajnime profesionale për rinin të pa anagazhuar.
- Vetëdijesimi i publikut për çështjet në lidhje me ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore duhet të rritet.

## **Trashëgimia Natyrore**

Mbrojtja e objekteve dhe zonave të trashëgimisë natyrore është në kompetencë të MMPH-së. Korniza ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe



ruajtjen e biodiversitetit në Kosovë është siguruar me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit të vitit 2003. Sikurse trashëgimia kulturore gjithashtu edhe trashëgimia natyrore është një e mirë e përgjithshme, për tu shfrytëzuar dhe ruajtur nga të gjithë, të trashëgohet nga ne dhe gjenerata e ardhshme. Momentalisht vlerat e trashëguara natyrore janë të rrezikuara, pasi që pas luftës zonat e mëdha kishin qenë subjekte të zhvillimit të pakontrolluar për një të ardhme më të afërt dhe brenda tyre (MESP 2005-2, 59).



Fig.24: Lugina Llapusha duhet të mbahet e lirë nga vendbanimet dhe të mbrohet si trashëgimi natyrore.

Me hapësirë relativisht të vogël, Kosova është e pasur me llojet e bimëve dhe drunjve. Ky është rezultat i bashkëveprimeve komplekse të faktorëve fizik duke krijuar llojllojshmërinë e gjerë të kushteve të vendbanimit për rritjen e bimëve. Këta faktor gjithashtu krijojnë kushte për nivelin e lartë të llojeve të kafshëve (USAID 2003). Shumëllojshmeria bimëve dhe kafshëve është gjetur në komunën e Gjiçanit, veçanërisht në rajonet malore në pjesën veriore të Anamoravës së ulët, dhe në pjesën jugore të saj, lart në kufirin me Serbin dhe Maqedoninë, p.sh. në zonat të cilat nuk kanë qasje të mirë dhe deri më tani nuk janë përguar nga



intervenimet e njeriut, ( ndërtimit të vendbanimeve dhe kultivimeve bujqësore).

Uji është burimi kryesor natyror dhe në të njëjtën kohë element strukturorë në mjedis. Lumenjtë, liqet dhe burimet janë të vendosura aty ku njerëzit dëshirojnë të shkojnë në peizazh të hapur.

Në fshatin Doberqan ekziston një burim i ujit mineral. Kjo pjesë do të mund të zhvillohet në një park të gjelbër rekreativ. Sheshi i afërt do të mbyllet dhe të integrohet në parkun e gjelbër rekreativ të peizazhit.



Fig.25: Burimi i ujit mineral në Doberqan.

Kjo pjesë duhet të zhvillohet në park të gjelbër rekreativ. Gurorja duhet të mbyllet dhe të integrohet në park.

Përkundër elementeve të peizazhit të hapur kujdes i veçanët duhet ti kushtohet grykës së lumit Llapushnicës afër Pograxhës (shih më lartë). Duhet të definohen mbrojtje e veçantë për zonat e caktuara.

## **S** përparësitë

- Zonat e gjera malore në veri dhe jug të anamoravës së ulët kanë nivel të lartë të biodiversitetit.



- Gjilani është i vendosur në peizazhin e bukur kodrinor me lumenj dhe lugina.

**W****dobësitë**

- Çështjet e zhvillimit ekonomik momentalisht janë duke e preokupuar vëmendjen e publikut. Prapë ekziston kujdes më i vogël në ruajtjen e bukurive të peizazhit natyror dhe kulturorë.
- Prioritetet financiare do të shihen me plotësimin e kërkesave urgjente shoqërore, kështu kjo mund të jetë e vështirë për ti gjetur parat e nevojshme për ruajtjen edhe zhvillimin e peizazhit të bukur dhe trashëgimisë natyrore.

**O****mundësitë**

- Në të ardhmen dhe në hapat e mëtejme të zhvillimit ekonomikë, megjithatë vlerat "soft" si vlerat më të bukura të peizazhit do të jenë faktor gjithashtu të zhvillimit
- Elementet e bukur të peizazhit siç janë, lumenjtë, liqet dhe luginat mund të zhvillohen si shpresë për natyrën.
- Burimet e ujit mineral mund të jenë pjesa qendrore e shpresës së mirë për të ardhmen.

**T****kërcënimet**

- Disa zona të peizazhit të komunës së Gjilanit janë shumë të ndotura dhe kanë nevojë për kujdes të veçantë dhe intervenim të menjëhershëm për ti rikthyer vlerat e tyre natyrore.
- Ndërtimet ilegale dhe përdorimi i paqëndrueshëm i zonave natyrore veçanërisht i maleve mund të shkaktoj dëme të mëdha të riparueshme.

**→****objektivat**

- Çfarëdo shkatërrimi i mëtejme i peizazhit dhe objekteve për trashëgimi natyrore duhet të parandalohet.
- Është i duhur një plan i veprimit, për ti zbukuruar dhe pastruar zonat e peizazhit që janë ndotur me hedhjen ilegale të mbeturinave.
- Drejtimet e rekreacionit për aktivitetet e jashtme me objektet e duhura ndihmëse për familje duhet të krijohen gjithashtu.
- Zonat me vlera të veçanta natyrore dhe me shkallë të lartë të biodiversitetit duhet të sigurohen, duhet të





ndalohet qasja e makinave dhe çfarëdo eksploatimi komercial .

### Vendbanimet Joformale

Vendbanimet joformale janë definuar si vendbanime njerëzore të cilat, nuk u mundësojnë banorëve të vet t'i gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të jetesës, në veçanti banim adekuat. Si të tilla ato shquhen me karakteristikat si vijon:

- Zotërimi joformal ose jo i sigurt i pronësisë
- Qasje joadekuade ose privim nga shërbimet elementare,
- Pjesëmarrje joadekuade ose mospjesëmarrje në qeverisje,
- Rrezikshmëria deri në diskriminim.

Ministria e Mjedisit është përgjegjëse për Standardin 6 'E Drejta Pronësore në vendbanimet joformale'. Zbatimi i të drejtave pronësore është qenësor për të inkurajuar kthimet dhe trajtimin e barabartë të të gjitha bashkësive etnike.


Prandaj, Ministria e mjedisit, së bashku me Komunat, UN-habitatin dhe Fakultetin e Ndërtimitarisë dhe Arkitekturës kanë bërë një hulumtim të VBJF në 4 qytete të Kosovës dhe atë në Prishtinë, Mitrovicë, Gjakovë dhe Gjilan.

Në Gjilan janë identifikuar këto vendbanime joformale

1. Pjesa mbi hallën e sporteve, 50Ha
2. Rruga e Malishevës, 30Ha
3. Zabeli i Sahit Agës, 70Ha
4. Arbëria, 80Ha
5. Kombinati Bujqësorë, 50Ha
6. Rr. Avdulla Presheva, 4Ha
7. Rr. E Gllamës, 10Ha
8. Dheu i Bardhë, 50Ha
9. Përgjatë Rrugës Qarkore, 30Ha
10. Livoq i Epërm, Pasjak, 70Ha
11. Rreth rrugës së Prishtinës, 15Ha
12. Pjesa nën St. E Autobusëve, 4Ha



Fig.26: VBJF të identifikuara nga zyrtarë komunal



Përveç këtyre, nga zyrtarët komunal janë identifikuar edhe 6 vendbanime tjera joformale nëpër qendrat dytësore të përzgjedhura si qendra të zhvillimit policentrik. Këto qendra janë:

1. Bresalci
2. Përlepnicë
3. Dobërçani
4. Pogradja
5. Zhegra dhe
6. Cërnica

Tani është e domosdoshme që të aprovohen rregullore të aplikueshme për ndaljen e aktiviteteve dhe rregullimin e kushteve në këto vendbanime për aktivitete të parapërcaktuara me statusin e tyre.

## Katastrofat natyrore dhe te shkaktuara

Territori i komunës së Gjilanit, vazhdimisht është ballafaquar me fatkeqësi natyrore dhe aksidente të ndryshme, nga të cilat shkaktohen dëme materiale si në pjesën urbane ashtu edhe në atë rurale. Shpesh herë nga fatkeqësitë aksidentale, pos dëmeve materiale, ka pasë edhe humbjen e jetës së njerëzve.

Kështu që Drejtoria e MC dhe Emergjencës ka përgjegjësi në menaxhimin e këtyre situatave emergjente, si që janë :

- Zjarret
- Vërshimet
- Tërmetet
- Fatkeqësitë tjera elementare

Fig.27: Harta e zonave maksimalisht të rrezikuara nga tërmetet në Kosovë



Burimi Plani Hapësinor i Kosovës



Fig.28: Harta e zonave maksimalisht të rrezikuara nga Erozioni në Komunë







Fig.29: Harta e rregullimit antieroziv







Fig.30: Harta e zonave maksimalisht të rrezikuara nga Vërshimet në Komunë





**Kuvendi Komunal Gjilan**  
Municipal Assembly Gjilan

Plan zhyllimor komunal i Gjilanit  
Municipal development plan of Gjilan

Mjedi dhe shtyllëzimi i tokës  
Environment and land use

Plan 6  
14.04.2008

Fajtesq:  
Scale:

0 5 km

DEPARTAMENTI PËR URBANIZIM, REKONSTRUKTION DHE AMBENTIN  
DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT

Plan 6  
14.04.2008

Fajtesq:  
Scale:

0 5 km

DEPARTAMENTI PËR URBANIZIM, REKONSTRUKTION DHE AMBENTIN  
DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT








**Plan zhyllimor komunal i Gjilanit**

**Natursurte natyrore:**

- guri, aktiv / i pasiv
- deponi në funksion / jashtë tij
- landfill, active / closed
- mundësi të kontaminuar
- mundshëm
- hapësirë me kontaminim të
- lumi / rrjedhë / liqeni
- river / stream / lake
- pyll
- forest
- Vershimet
- Flooding
- tokë e rëndësishme bujqësore
- valuable agricultural land
- topografia
- topography
- komuna e Gjilanit
- municipality of Gjilan
- kufiri i Kosovës
- Kosovo border
- kufiri national
- national border

**Psjellje:**

- Cr chrome
- CaFe çeliku / hekur
- coposition
- Pb,sh plumb
- Zn, W zink/vollfram
- trazhëgimta kulturore
- cultural heritage





## 1.2.d INFRASTRUKTURA

### Rrjeti rrugor dhe hekurudhor

Gjilani është mirë i lidhur me qytetet më të mëdha të Kosovës si dhe rrjetin ndërkombëtar të transportit. Komuna e ka rrjetin e centralizuar të rrugëve, me të gjitha rrugët e rëndësishme që të drejtojnë për në qytetin e Gjilanit. Kjo strukturë i jep qytetit mundësi hyrjeje, por gjithashtu edhe probleme me trafikun e panevojshëm që kalon nëpër qendër. Përderisa struktura e vendbanimit në komunë është e koncentruar përreth qytetit, shumica e popullsisë kanë qasje të lehtë në një rrugë të rëndësishme.

Dy rrugë magjistrale kalojnë nëpër komunë; M25-2 dhe M25-3. M25-2 kalon në drejtim të veri-jugut nga Prishtina për në Preshevë në Serbi, dhe M25-3 nga Bujanovci drejt Ferizajt dhe Prizrenit. Te dy rrugët kryqëzohen njëra me tjetrën në qytetin Gjilanit.

Të dyja rrugët janë të asfaltuara, edhe pse asfaltimi i tyre është i cilësisë me të dobët krahasuar me standardin Evropian. Rrugët janë bukur të ngushta dhe janë të mangëta në cilëndo rrugicë ose vendkalimet e kalimtarëve. Përderisa ato përdoren nga këmbësorët si edhe trafik për makina, duke përfshirë këtu një pjesë të madhe të nxënësve që gravitojnë nëpër to, zgjerimi edhe me trotuare paraqet një problem serioz e që kërkon zgjidhjet shpejt.

Tab. 30: Rrugët Magjistrale në Komunë

Nr.	Emërtimi i rrugëve	Gjatësia
1	Rruga Gjilan-Muqybabë (kufiri me Serbinë)	13.8 km
2	Rruga Gjilan-Ferizaj (deri në fsh. Budrikë e epërme)	12.2 km
3	Rruga Gjilan-Prishtinë (deri në fsh. Llabjan)	17.3 km
4	Rruga Gjilan-Dardanë-Kamenicë (deri në fsh. Petrit)	15.3 km
	TOTALI	58.6 km

Burimi:Kuvendi Komunal

Rrugë magjistrale dhe rajonale në komunën e Gjilanit janë: 100.9 km, Rrugë magjistrale gjithsej 58.6 km dhe me gjerësi 6.0 m', ndërsa gjatësia e përgjithshme e urave është 94.0 m, këtu nuk janë llogaritur ujë lëshuesit me hapje deri në l = 5.0 m.



Tri rrugët rajonale, gjithashtu kalojnë nëpër komunë. R213 e lidh Gjilanin me Artanën. R209 është një shkurtes për Fushë Kosovë dhe komunën e Lipjan. R 212 kalon përmes Zhegrës dhe drejt zonës së Kumanovës në Maqedoni. Kryqëzimi i kufirit dhe pjesa e fundit e kësaj rruge është në fazë të planifikimit. Standardi i rrugëve rajonale është i kënaqshëm. R212 është riparuar kohët e fundit, dhe e ka kualitetin e rrugës magjistrale. .

Tab. 31: Rrugët Rajonale në Komunë

Nr.	Emërtimi i rrugëve	Gjatësia
1	Gjilan - Zhegër R212	22.3 Km
2	Gjilan – Makresh R213	13.0 Km
3	Rruga Gjilan-Fushë Kosovë-Lipjan R209(e planifikuar)	15.5 KM
	<b>TOTALI</b>	<b>50.8 KM</b>

Burimi:Kuvendi Komunal

Shumë fshatra, veçanërisht ato në zonat malore, janë të lidhura nga rrugët lokale. Rruga më e rëndësishme lokale kalon gjatë Moravës së Binçes, për Pogradjë.

Tab. 32: Rrugët Lokale në Komunë

Nr.	Emërtimi i rrugëve	Gjatësia
1	Gjilan – Pogradjë	13 Km
2	Pogradjë – Llovcë	2.5 Km
3	Pogradjë - Bilinicë	2.6 KM
4	Gjilan – Kuvcë	2.0 Km
5	Gjilan – Koretishtë	2.0 Km
6	Kuvcë - Prekovc	30 Km
7	Gjilan - Livoq i Epërm	2.0 Km
8	Cërnice – Rrugë nacionale	2.0 Km
9	Shillovë - Rrugë nacionale	2.0 Km
10	Përlepnicë - Rrugë nacionale	2.0 Km
	<b>TOTALI</b>	<b>32.1Km</b>

Burimi:Kuvendi Komunal

Gjilani nuk është i lidhur në rrjetin hekurudhor. Qyteti është i vendosur ndërmjet dy linjave hekurudhore të ndryshme. Në përfundim është linja kryesore e Kosovës Mitrovicë-Fushë Kosovë-Shkup me stacionin në Ferizaj. Në lindje, linja hekurudhore e përshtatshme për Serbi, kalon gjatë E75 si pjesë e pan-transportit evropian, korridori X. Stacionet më të afërta janë në Bujanovc dhe Preshevë. Në "Planin Hapësinor të Kosovës " ka plane për ndërtimin e linjës hekurudhore nga Ferizaj për në Bujanovc,





me stacion në Gjilan. Kjo mund ta lidh qytetin me rrjetin e hekurudhave të Kosovës, si dhe me rrjetin evropian.

Fig.31: Rruga kryesore M 25-2 në drejtim të kufirit me Serbin



### Transporti dhe Mobiliteti

Gjilani nuk ka lidhje hekurudhore. Transporti publik në distanca të gjata kryhet me autobus. Përgjegjës për transport në Komunë është Drejtoria për Shërbime Publike. Ekziston një stacion qendror i autobusëve në jug të qendrës së qytetit. Transporti publik në Gjilan është i ndare në:

- Transportin Urban ,
- Transportin Urban-Periferik dhe,
- Transportin Ndër-urban.

**Transporti Ndër urban** apo ndër rajonal lidhë qendrat tjera urbane të Kosovës dhe shteteve fqinje me Gjilanin. Ky lloj transporti është mjaft i dendur. Nisja bëhet nga Stacioni Qendror i Gjilanit.

Transporti Urban-Periferik lidhë Gjilanin me vendbanimet dhe fshatrat e Komunës në mes veti. Janë gjithsejtë 19 linje rajonale dhe itinerari i tyre përcaktohet nga Drejtoria për Shërbime Publike. Të gjitha këto linja



fillojnë nga Stacioni Qendrorë i Autobusëve të Gjilanit prandaj edhe formohet një tollovi e madhe në komunikacion.

Si dobësi e këtyre linjave mund të përmendet edhe se autobusët Ndër-urban ndalojnë edhe në vendbanime komunale, pra, krijohet një paqartësi ndërmjet Transportit Ndër-urban dhe atij Urban-Periferik.

Si dobësi tjetër është edhe mos mbulimi i zonës perëndimore të Komunës me Transport Publik.

Transporti Publik në përgjithësi pengohet nga rrugët e ngushta, udhëkryqet joadekuate, mungesa e parkingjeve dhe stacioneve urbane, trasave rrugore të parapërcaktuara për autobusë lokalë si dhe nga mungesa e shtigjeve për këmbësorë dhe atyre për çiklistë.

#### **S** përparësitë

- lidhje të mira me korridoret e transportit Pan-evropian,
- relativisht standard i mirë i rrugëve magjistrale.

#### **W** dobësitë

- standard i ulët i rrugëve sekondare dhe rajonale,
- Pjesë të komunës kanë rrjet të rrugëve të cilësisë së dobët,
- pjesë të komunës nuk kanë qasje gjatë kushteve të liga atmosferike,
- asnjë lidhje hekurudhore.

#### **O** mundësitë

- Ndërtimi i një linje hekurudhore përmes rrafshit të Anamoravës.

#### **T** kërcënimet

- Nëse është zgjedhur dhe ndërtuar një rrugë e pafavorshme për linjën e hekurudhës, mund ta pengoj Gjilanit për lidhje të mirë të linjës hekurudhore për një periudhë të gjatë kohore.

#### **→** Çështjet

- Asfaltimi dhe zgjerimi i rrugëve magjistrale dhe rajonale,
- Qasja në të gjitha stinët për të gjitha pjesët e komunës,
- Lidhja e komunës me rrjetin hekurudhor të Kosovës.



## Infrastruktura Teknike

Në përgjithësi infrastruktura është në nivel jo të kënaqshëm dhe nuk i plotëson nevojat për banorët e Komunës, duke filluar nga sasia jo e mjaftueshme e ujit të pijes, kanalizimit i pamjaftueshëm si dhe rrjeti i vjetruar i PTT-së dhe ai energjetik. Prandaj është nevojë e domosdoshme investimi në evitimin e problemeve të cilat na rrjedhin si pasojë e mosfunksionimit të infrastrukturës.

Parakusht për zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik është edhe modernizimi i infrastrukturës energjetike dhe të trafikut që nënkupton modernizimin e trafikut rrugor, rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, rrjetit energjetik dhe racionalizimin e komunikacionit dhe lidhjeve.

Shërbimet komunale të cilat iu ofrohen qytetarëve në Komunën e Gjilanit janë:

- Furnizimi me ujë të pijes,
- Furnizimi me rrymë elektrike,
- Shërbimi i zjarrfikësve,
- Ndriçimi i rrugëve dhe i parqeve,
- Ndërmarrja për distribuimin e energjisë elektrike "KEK-Njësia Gjilan",
- Ndërmarrja për furnizim me ujë të pijshëm dhe mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit "Hidromorava",
- Ndërmarrja për mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike "Higjiena".

Transporti – Në Komunën e Gjilanit është një ndërmarrje transportuese shoqërore dhe 21 kompani private transportuese si dhe 136 auto-taksi; nuk ka hekurudhë, stacioni më i afërt i trenave është në Ferizaj 33 km larg. Aeroporti më i afërt është në Prishtinë rreth 60 km larg nga Gjilani

## Ujësjellësi

Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit është mbi 70 km, me dimensione Ø50 - Ø400. Rreth 75-80 % e rrjetit e ka kaluar afatin e eksploatimit. Prej vitit 2000 janë punuar dy rrjete të reja, rrjeti i spitalit, 4 000 m gjatësi dhe rrjeti nëpër qytet 5100 m gjatësi. Vëllimi i pendës së Përlepticës është 4 000 000 m<sup>3</sup>, ndërsa vëllimi shfrytëzues është 3,200,000 m<sup>3</sup>. Kapaciteti maksimal i prodhimit është 300 l/s, ndërsa kapaciteti i prodhimit momental është 100 l/s. Në këtë ndikon rrjeti i ngushtë Ø 400 i ujësjellësit Përlepticë - Gjilan. "Guri i Hoxhës", varësisht nga stina, jep 60-80 l/s, ndërsa Baja e Qytetit, varësisht nga stina, jep 25-30 l/s. Në sistemin qendror të ujësjellësit janë të kyçura tri fshatra, Përlepnica, Shillova dhe Velekinca. Në përfundim e sipër janë edhe tri projekte të ujësjellësit në tri fshatra, me gjatësi të rrjetit





19 km, kapaciteti i prodhimit 25 l/s. Por, të gjitha këto nuk mjaftojnë. Si rrjedhojë e instalimeve të vjetra, shumë ujë humbet gjatë qarkullimit. Gjithashtu, shumë zona nuk janë të lidhura në rrjet. Prandaj, prioritet në këtë fushë duhet të jetë zgjerimi i rrjetit në zonat rurale.

Për furnizim me ujë ujësjellësi i qytetit shfrytëzon këto burime kryesore:

- Akumulacioni "Penda" në Përlepticë, kapaciteti i prodhimit 110 – 120 l/s, distribuimi i ujit me gravitet.
- Kaptazha "Guri i Hoxhës", kapaciteti i shfrytëzimit 60-70 l/s, distribuimi i ujit me gravitet,
- Burimi "Baja" në qytet, kapaciteti 25-30 l/s, distribuimi i ujit me pompim.

Kompania "HIDROMORAVA" Gjilan menaxhon me këto asete:

- "Penda" në Përlepticë H=30 m e lartë, vëllimi akumulues V= 4 milion m<sup>3</sup> dhe duke përfshirë arealin prej 33 ha,
- Fabrika për përpunimin e ujit në Përlepticë,
- Rezervuari i ujit në "Kodrën e Dëshmorëve" në qytet, me vëllim prej 500 m<sup>3</sup>,
- Kaptazha "Guri i Hoxhës", 3 km larg akumulacionit në Përlepticë,
- Stacioni i pompimit "Baja" në qytet.

Tab. 33: Prodhimi mesatar i ujit në vitin 2004


Burimi	Kapaciteti mesatar l/s	Prodhimi orë/ditë	Sasia vjetore m <sup>3</sup>	Humbjet	
				%	m <sup>3</sup>
"Penda"	110 – 120	24	3,421.440		
"Guri i Hoxhës"	60 - 70	24	2,332,800		
"Baja"	25 – 30	24	855,360		
<b>Gjithësej:</b>	<b>185 – 220</b>		<b>6,609.600</b>	<b>50</b>	<b>3,304.800</b>

Burimi:Kuvendi Komunal

Duke pas parasysh nevojat për ujë të pijshëm që sillen prej 450 deri 550 l/s, është e qartë nevoja e gjetjes së mundësisë tjera për plotësimin e nevojave për ujë të qytetit. Për momentin, kapacitetet e furnizimit me ujë në Gjilan janë maksimalisht 230l/s.

Duke pasur parasysh rëndësinë e ujit të pijshëm, një nga projektet kyçe më përparësi do të ishte hulumtimi për sigurimin e kapaciteteve të mjaftueshme për ujin e pijes.

Fig.32: Harta hidrologjike e Gjilanit



## kanalizimi

Gjilani ka përafërsisht mbi 80.000 banorë, ndërsa për rrjet të kanalizimit nuk ka shënime të sakta, por vlerësohet se rrjeti i kanalizimit ka përafërsisht gjatësinë prej rreth 65 km.

Rrjeti ekzistues nuk i përmbush kërkesat e popullsisë. Mu për këtë qytetarët gjenden ashtu siç munden. Edhe ujërat fekale derdhen në



lumenjtë (Mirusha, Baja dhe Stanishori) që kalojnë nëpër qytet, të cilët janë mjaft të ndotur.

- Gjilani disponon me rrjetin e ujërave të zeza (ujërat teknologjik, fekale dhe ujërat atmosferike),
- Kanalizimi i ujërave atmosferike, edhe pse ka ekzistuar në disa pjesë: rrugën Medllin Ollbrajt, Gjon Sereqi dhe një pjesë e Dradanisë, është në gjendje shumë të keqe. Në këtë rrjet janë të kyçur edhe shumë qytetarë duke mos pas zgjidhje tjetër. Mu për këtë, Gjilani nuk ka sistem të ndarë të kanalizimit.
- Rrjeti i kanalizimit të qytetit ka filluar të ndërtohet në vitin 1970- 1978 kur edhe është bërë pranimi teknik i tij. Sipas statistikë, Gjilani në atë kohë ka pas 21258 banorë. Gjatësia e kanalizimit ka qenë rreth 25 km me diametër të gypave prej Ø 150- Ø 400. Sistemi i pastrimit të ujërave të zeza edhe pse ishte ndërtuar në vendin e quajtur "Mulliri i Arapit", asnjëherë nuk ka funksionuar. Ndërsa rrjeti i kanalizimit është realizuar edhe në këto fshatra: Shillovë, Kmetoc, , Vërbic e K., Lladovë, Llovca, Sllubic, Ponesh, Uglare dhe Velekicë – projekt i papërfunduar. Edhe fshatarët ujërat e zeza i derdhn në lumenjtë duke i ndotur edhe më shumë. Në disa fshatra , këto sisteme nuk funksionojnë.
- Edhe ujërat fekale derdhe në lumenjtë pa ndonjë trajtim adekuat. Gjithashtu edhe kolektori kryesor derdhet në lum të vendi i quajtur "Mulliri i Arapit".

SWOT analizat e ujësjellësit dhe kanalizimit

#### **S** përparësitë

- Hidrografia e pasur,
- Mundësia e zgjerimit të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit,
- Burime potenciale të ujit.

#### **W** dobësitë

- Mungon trajtimi i ujërave të zeza,
- Mungon kanalizimi i ujërave industrial,
- Mospasja e të gjitha vendbanimeve rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit,
- Shfrytëzimi joracional i ujit të pijshëm,
- Mosekzistimi i kadastrit nëntokësor.

#### **O** mundësitë



- Rregullimi i sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit,
- Ndërtimi i një impianti për trajtim të ujërave të zeza,
- Hulumtimi i burimeve të reja të ujit,
- Mbrojtja e zonave ujore.

**T**

## kërcënimet

- Ndotja e ambientit,
- Sëmundjet e rrezikshme,
- Mbyllja e korridoreve për zhvillim të mëtejshëm të rrjetit.

**Menaxhimi i Mbeturinave**

Kompania rajonale e grumbullimit të mbeturinave "Higjena"- Gjiçan i ka të punësuar 141 punëtorë në tri njësi punuese:

- Gjiçan,
- Viti dhe
- Kamenicë.

Vetëm në Gjiçan janë të punësuar 102 punëtorë të cilët bëjnë grumbullimin e mbeturinave nga kontenierë dhe mbeturinat e amvisërisë ( derë më derë), grumbullon mbeturina edhe të 15 fshatrave (Gjiçani ka 55 fshatra), bën pastrimin e rrugëve, trotuareve dhe shesheve si dhe pastron rrugët nga bora në sezonin e dimrit. Kjo kompani mirëmban sipërfaqet e gjelbëruara të Gjiçanit.

Në deponin rajonale të Gjiçanit, në vitin 2006 janë grumbulluar rreth 15 723 ton mbeturina.

SWOT analizat e menaxhimit të mbeturinave

**S**

## përparësitë

- Infrastruktura ligjore,
- Ekzistimi i ndërmarrjes publike për menaxhim të mbeturinave,
- Ekzistimi i deponisë rajonale.

**W**

## dobësitë

- Mos ekzistimi i deponive të ndara për mbeturina industriale, mjekësore dhe ndërtimore,
- Mostrajtimi i deponive të mbyllura ekzistuese,
- Deponitë ilegale.

**O**

## mundësitë

- Definimi i kompetencave në menaxhim,
- Vetëdijesimi i popullatës për problemet e mjedisit,
- Shpërndarja e shërbimit për mbledhjen e mbeturinave.



- në zonat rurale,
- Ndërimi i mënyrës së mbledhjes së mbeturinave.
- T** kërcënimet

- Mosdefinimi i kompetencave në menaxhim,
- Përhapja e ndonjë sëmundje të rrezikshme,
- Hapja e deponive të reja ilegale.

### Furnizimi me energji elektrike

Komuna e Gjilanit furnizohet nga trafostacioni **Prishtina IV**, TS 2x150MVA, 220/110kV përmes largpërçuesit nr.184/1, Al-Ge 3x240mm<sup>2</sup>-35.3 që e furnizon TS110/35(20+31.5)MVA. Në komunën e Gjilanit ekzistojnë 4 TS 35/10 kV: GL-1, GL-2, GL-3 dhe Lladova, 24 km lidhje kabllovike dhe 347 km lidhje ajrore me gjithsej 3 476 shtylla elektrike dhe 271 trafostacione 10/0.4 kV, me gjithsej 57 MVA fuqi instaluese 35/10(Kv) dhe 51.5 MVA fuqi instaluese Ts 110/35 (KV). Edhe pse pas luftës janë bërë shumë investime në infrastrukturë nga donacionet për të forcuar rrjetin energjetik, akoma mbetet shumë për të bërë edhe në aspektet tjera të infrastrukturës fizike. Sikur edhe në pjesët tjera të Kosovës, ekziston mungesë e energjisë elektrike, në mënyrë të veçantë gjatë stinës së dimrit. Kjo është duke ndikuar negativisht në funksionimin në jetën normale të banorëve si dhe të firmave biznesore.

Tab.34: Gjatësia e rrjetit elektrodistributiv

Rrjeta e Tensionit kV	Rrjeta Ajrore në Km							Rrjeta Kabllovike	Gjithsej
	Në shtylla të drurit			Në shtylla çelik-beton			Gjithsej		
	Të painpr egrume	Të impregurime	Gjithsej	çelik	Beton	Gjiths.	a + b		
110									
35				33.88	49	82.818	82.818	0,342	83.16
20		15.23	15.23	5.036	32.416	37.452	52.682	83	60.982
10	677.546		677.546	08. Mai	189.024	197.524	875.07	34.074	909.144
0.4							1,926.68	24.21	1950.89






Fig.33: Rjeti Elektrik i Kosovës



Burimi: Plani Hapësinorë i Kosovës

Fig.34: Nënstacionet e reja 110/20(10)kV në Kosovë  
**Nënstacionet e reja 110/20(10)kV në Kosovë**



Burimi: KEK





## SWOT analizat e energji elektrike dhe ngrohjes qendrore

- S** përparësitë
- Mbulimi i tërë territorit me rrjet energjetik,
  - Pozita e mirë gjeografike dhe afërsia me burime termoenergjetike,
  - Ekzistimi i pasurisë pyjore,
  - Ekzistimi i rrjetit energjetik rajonal.
- W** dobësitë
- Infrastruktura energjetike e vjetruar,
  - Mosshfrytëzimi i mundësive alternative,
  - Menaxhimi i dobët,
  - Format joadekuate të shfrytëzimit të energjisë elektrike.
- O** mundësitë
- Ndërtimi i sistemit të ngrohjes qendrore,
  - Ndërtimi i rrjetit nëntokësor elektroenergjetik,
  - Privatizimi,
  - Organizimi i partneriteteve publik- privat.
- T** kërcënimet
- Ngecja e zhvillimit,
  - Degradimi i ambientit dhe kualitetit të jetës.

## Telekomunikacioni

Kapaciteti i centralit telefonik në Gjilan është 10,000 numra. Viti i prodhimit 1980, viti i instalimit 1989. Numri i parapaguesëve 9000. Numri i parapaguesve të Vala 900 është 10,000.

Numri i antenave në: Gjilan – 6 antena, Capar – 1, Livoq – 1, Maja e Gjelbërt – 1 dhe Mireshe – 1. Numri shtyllave në Gjilan dhe fshatra është 785 copë.

Gjilani është një nga komunat që ka pas një përfaqësim të kënaqshëm në shtyp dhe media. Pos klubit të korrespondentëve që raportojnë nga Gjilani në mediat qendrore të Kosovës, në Gjilan ekzistojnë edhe dy televizione të pavarura si dhe pesë radiostacione. Klubi i Gazetarëve: TV Vali, TV Men, Radio-Gjilani, Radio-Viktoria, Radio-Energji, Radio-Rinia, në territorin e komunës operojnë edhe dy televizione private të cilat gjuhën Serbe. Ato janë : Tv ZOOM në Kufcë dhe D TV në Shillovë, i cili menaxhohen nga minoriteti serb dhe të cilat transmetojnë program në gjuhën serbe.

**S****përparësitë**

- Kalimi i fibrit optik nëpër territor të komunës,
- Teknologjia e avancuar (pjesërisht),
- Pozita strategjike e (volitshme) komunës,
- Digjitalizimi i centraleve,
- Telefonia në Lagjen "Dardania II".

**W****dobësitë**



- Rrjeti i pavolitshëm i zyrave postare,
- Rrjeti i zgjatur telekomunikues,
- Mosmbulimi i territorit me rrjet të telefonisë,
- Rrjeti kabllor i vjetruar,
- Mos afrimi i shërbimeve në brezin e gjerë.

**O****mundësitë**

- Mbulimi i tërë territorit me rrjet të telefonisë fikse,
- Përmirësimi i rrjetit kabllorë,
- Vendosja e centraleve periferike
- Ofrimi i shërbimeve të brezit të gjerë,
- Vendosja e centraleve periferike.

**T****kërcënimet**

- Monopoli në shërbime,
- Mungesa e kadastrit nëntokësor,
- Zhvillimi i paplanifikuar.



- kufiri shtetere fqinje  
neighbourational border
- kufiri i Republikës së Kosovës  
Republic of Kosovo border
- komuna e Gjiçanit  
municipality of Gjiçan
- bazë e rëndësishme e KFOR-it  
important KFOR-base
- rrugë magjistrale  
magistral road, existing
- rrugë rajonale/e planifikuar  
regional road/planned
- rrugë lokale  
local road
- vendkalim kufitar  
border crossing
- hekurudha  
railway
- Hekurudha (e planifikuar)  
Railway (planned)
- vijat e rrymës elektrike  
35KV/110 KV/220 KV/400KV  
0.6KV/10KV/35KV/110 KV/  
220 KV/400KV
- trafostacionet 110,35  
35KV/110KV/220KV/400KV  
transformer stations  
SS 35-10 / SS 110-35
- përpunimi i ujit/Crumbullimi  
i ujërave të zeza (nuk është  
në funksion)  
water treatment plant /  
sewage plant (out of order)

**Kuvendi Komunal Gjiçan**  
Municipal Assembly Gjiçan

**Plani zhvillimor komunal i Gjiçanit**  
Municipal development plan of Gjiçan

**Infrastruktura teknike dhe ruqore**  
Traffic and technical infrastructure


14.04.2008

Perpleqes:  
Plan 7  
Plan 7

Scale:  
0 5 km

THE OFFICE FOR SPATIAL PLANNING, RESEARCH AND  
INFRASTRUCTURE DEVELOPMENT  
THE DEPARTMENT OF URBAN AND ECONOMIC PLANNING

**planingsgruppe 4**





### 1.2.1 Analiza e profilit

Kjo analizë shqyrton ndikimin e çështjeve të hulumtuara të cilat në formë të përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve (SWOT analizat) paraqesin faktorët kryesorë për zhvillimet e ardhshme.

SWOT analizat janë të prezantuara veç e veç nëpër fushat tematike.

### 1.2.2 Analiza e ndërlidhjeve ne mes të çështjeve, politikave dhe programeve

#### Qeveria Lokale

Forma e qeverisjes lokale në Kosovë është Komuna. Komuna rregullon dhe udhëheq çështjet publike brenda territorit të saj për të siguruar kushte për jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët. Ajo kujdeset, gjithashtu, për çështje me interes të përgjithshëm që ndërlidhen me komunën dhe nuk mund të shqyrtohen vetëm nga pushteti qendror apo ndonjë organ tjetër.

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë përfaqësues i komunës, i cili zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në Komunën e Gjilanit Kuvendi ka sot 41 delegatë, që përfaqësojnë parti të ndryshme politike.


Veprimtaria e pushtetit lokal drejtohet nga Kryetari i Komunës dhe nga dy Nënkryetarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Komunës nga përbërja e këshilltarëve të tij.

Kjo veprimtari realizohet përmes administratës së komunës, e cila drejtohet nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe Bordi i Drejtorëve. Në Bordin e Drejtorëve bëjnë pjesë drejtorët e 11 Drejtorive, të cilat formojnë strukturën organizative të administratës së komunës. Këto Drejtori janë:

- Administratë Komunale,
- Kulturë, Rini dhe Sport,
- Buxhet, Financa dhe Investime,
- Arsim
- Shërbime Publike,
- Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient,
- Ekonomi dhe Menaxhment,
- Shëndetësi dhe Çështje Sociale,
- Siguri dhe Emergjencë,
- Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi,
- Bujqësi dhe Pylltari,
- Zyra për Komunitete Lokale.

Komuna e Gjiçanit qeveriset sipas Rregullores së UNMIK 2000/45, e cila qartazi definon përgjegjësitë e qeverisë komunale në Kosovë. Mirëpo, ekzistojnë disa ligje dhe rregullore të tjera që janë miratuar nga pushtetit qendror të cilat kanë krijuar konflikt interesash ndërmjet komunës dhe qeverisë qendrore në fushën e shërbimeve të kompanive publike, shërbimit civil të Kosovës, arsimit fillor dhe atij të mesëm, menaxhimit të tokës komunale dhe/ose shoqërore, ku problematika e fundit rrjedh nga fakti se në të kaluarën, në shumë raste, dallimi ndërmjet tokës në pronësi komunale dhe shoqërore nuk ka qenë i qartë.

Fig.35: Organizimi i Komunës së Gjiçanit (Gjendja 2007)




## Bashkëpunimi Ndërkufitare

(Gjilan, Preshevë, Kumanovë)

Një iniciativë e parë e bashkëpunimit të fillë u mbajte me 20 Nëntor, 2003 ne Preshevë, përderisa e dyta iniciativë është mbajtur me 16 Shkurt 2004 ne komunën e Gjilanit, që u mirëprit nga Qendra Rinore, e titulluar: "Roli Mikro-rajonat i të Rinjve në Zgjedhjen e Problemeve të tyre të përbashkëta" (tryeze e rumbullaket).

Fig.36: Harta e Iniciativës dhe Emblema e sajë



Kjo ngjarje multietnike do te përgatitet ne bashkëpunim te ngushte me tri Grupet Punuese komunale dhe partneret e tyre lokal përkatës të cilët punojnë me të rinjtë e moshave 16-18 vjeçare (OJQ-të, klube të mediave, asociacionet e mësimdhënësve, zyrtaret e Komunitetit Lokal etj), nën kushte te favorshme te EWl-te menaxhuar TFC-Projekti në Kosove.

Objektivat e bashkëpunimit ndërkufitar janë:

- Ta ndihmojnë një kontakt të fillë të rëndësishëm pas konfliktit, ndërmjet nxënësve të shkollave të mesme në mikro-rajon, me qëllim të kthimit të multi-etnicitetit në vepër;
- Të ofrojnë studentëve një forum të lartë bashkëveprues për diskutime në një përpjekje për të ofruar zgjedhje për të ardhmen, për gjeneratat e së ardhmes;
- Të dëshmojë potencial për bashkëpunim bazë e cila tashmë ekziston në rajon me vullnetin e manifestuar nga zyrtarët lokal komunal;
- Të iu japin rast qe gjeneratat e reja të ndërtojnë rrjetin ndërmjet tyre në mikro-rajon;





- Të fillojnë identifikimin e liderëve potencial të gjeneratës së re të mikro-rajonit dhe të iniciojnë modelin e bashkëpunimit ndërmjet tyre;
- Të zgjerojnë anëtarët e Grupeve Punuese përmes participimit direkt të NGO-ve të Rinjve dhe Asociacioneve të mësimdhënësve në ngjarje;
- Të vazhdojnë të ngritin vetëdijen për realizimin e projektit, përmes participimit në media dhe buletine informative të shkollave.

Pjesëmarrës ishin 30 nxënës të shkollave të mesme të moshës 16-18, për të përfaqësuar komunën e Kumanovës, Preshevës dhe Gjiçanit në Tryezën e Rrumbullaket (7-10 nxënës nga secila komune); 3 mësimdhënës (1-2 mësimdhënës prej secilës komunë) t' i bashkëshoqërojnë nxënësit nga komunat përkatëse dhe 2 Përkthyes/delegacion komunal.

### Programet zhvillimore

(E marrë si synim i Grupeve Punuese dhe Sektorit Privat dhe Publik nga „Agjenda Zhvillimore Komunale“

**Vërejtje** : Për implementimin e suksesshëm të këtyre projekteve duhet bërë përpjekje të arrihet përmes :

- Buxhetit vetanak,
- Ndihmës së Komunitetit Ndërkombëtarë / OJQ –ve, Ndërkombëtare dhe Institucioneve të tjera,
- Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës,
- Donacionet dhe iniciativat afariste të qytetarëve të komunës

Tab. 35: Projektet në Arsim

1	Ndërtimi i objekteve të shkollave fillore : -Qytet : Zabeli i Sahit Ages, Lagjeja nr,II, Dardania II -Fshatra : Kmetovc, Bukovike, ,Kishnapole, Zheger, Selisht, Ponesh,
2	Meremetimi i objekteve ekzistuese
3	Ndërtimi i objektit të shkollës së mesme të muzikës



Tab. 36: Projektet në Shëndetësi

1	Shtimi i numrit të punkteve shëndetësore dhe furnizimi me paisje dhe instrumente bazë për mjekësinë familjare / Muqibab, Lagjeja nr,8
2	Finalizimi i dy projekteve për qendren e përkujdesjes dhe shërimit mental
3	Përfundimi i të gjitha punëve / Iyerja, dyshemja, rrjetit elektrik etj,/ i Ambulantes në lagjen Dardania
4	Ndërtimi i fabrikës për prodhimin e medikamenteve farmaceutike,
5	Renovimi i Qendrës për rehabilitim të familjes dhe fëmijës, e cila gjendet në objektet e Fabrikës së Tekstilit,
6	Ndërtimi i objektit për Hendikep
7	Ngritja e qendrave shëruese- rekreative / Vrella-Pidiq, Uglar, Miresh /

Tab. 37: Projektet në Ujësjellës dhe Mjedis

1	Sistemi regjional i ujësjellësit " LEPENC " Rregullimi i sistemit regjional të ujësjellësit për Ultësirën e Moravës dhe pjesa e Kosovës
2	Rregullimi i rrjetit të kanalizimit për gjatë lumit Dobrusha dhe Stanishorka dhe rregullimi i shtratit të lumejve
3,3	Rregullimi i kolektorit të qytetit për neutralizimin e ujërave të zeza
4	Ndërtimi i pendës " Llapushnica " Ndërtimi i pendës në lumin " Llapushnica " me qëllim të furnizimit të komunës me ujë të
5	Pyllëzimin dhe gjelbërimin i sipërfaqeve të reja
6	Rregullimi i shtretërve të lumenjve në fshatra & Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në fshatëra
7	Organizimi i aksioneve me qytetarë për rregullimin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit,

Tab. 38: Projektet në Energjetikë, Telefoni dhe Komunikacion Rrugorë

1	Shtimi i rrjetit të lartëpërquesve dhe modernizimi i rrjetit
2	Rregullimi i rrethërrotullimit në qendër të qytetit
3	Ndërtimi i rezervarit të ujit të pijshëm për nevojat e qytetit
4	Ndërtimi i rrjetit për ndriçim publik në qytet dhe fshatra,
5	Ndërtimi i rrjetit të telefonisë fikse në tërë territorin e Komunës së Gjilanit
6	Caktimi i lokacionit të ri të stacionit për transportin publik të udhëtarëve,
7	Asfaltimi dhe sanimi i rrugëve në lagjet e qytetit dhe fshatra

Tab. 39: Projektet në Kulturë, Rini dhe Sport

1	Renovimi i objektit të Teatrit dhe Bibliotekës / pjesa e mbrendshme
2	Përfundimi i punëve „ Fusha e Lirisë „ të qendrës rekreative sportive mbi Hallen e Sporteve
3	Renovimi i në fshatra Malisheva & Perlepnica
4	Ndërtimi i shtëpive të kulturës / Cernice & Livoq i Eperm
5	Themelimi i Muzeut Regjional dhe Ndërtimi i objektit të ri të Arkivit regjional
6	Mbrojtja dhe përkujdesja e objekteve të kultit fetar dhe monumenteve historike,
7	Ndërtimi i objektit të Bibliotekës Regjionale " F, Noli " Gjilan



Tab. 40: Projektet në Urbanizëm dhe Gjeodezi

1	Përgatitja e Planeve Zhvillimore Komunale
2	Përgatitja e Planeve Zhvillimore Urbane
3	Përgatitja e Planeve Rregullative Urbane
4	Përcaktimi i zonave të reja urbane në qytet,
5	Zgjerimi i varrezave të qytetit dhe caktimi i lokacionit të ri për varreza,
6	Përfundimi i punëve në ndërtimin e kazermes "Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha "
7	Ndërtimi i sallës së Kuvendit dhe pajisja me inventar
8	Planifikimi dhe eksproprimi i tokës me interes të përgjithshëm
9	Renovimi komolet i objektit të Gjeodezis
10	Rrjeti referent i rendit të tretë dhe inçizimi i rrugës qarkore / 7 km
11	Eliminimi i pasojave të Termetit
12	Eliminimi i pasojave të termetit / rregullimi i kulmeve dhe rregullimi i ashensorëve të banesave
13	Ndërtimi i shtëpisë për persona të moshuar dhe pa perkuqjesje familjare

Tab. 41: Projektet në Ekonomi, Bujqësi dhe Pylltar

1	Hartimi i Rregullores për thjeshtësimin/përgjysmimin e procedurave administrative biznesore
2	Promovimi i zhvillimit të ndërmarrjeve me pronësi private,
3	Inkurajimi i investimeve kapitale të mërgatës shqiptare dhe investitorëve të huaj
4	Themelimi i zyrës për shërbime të shpejta biznesore (OSS or One-Stop-Shop)
5	Qasje dhe mbështetje Agjencionit Kosovar për Mirëbesim / AKM
6	Krijimi i Zonës Industriale / Rruga Gjilan-Bujanoc dhe Gllama e Livoqit të Epërm ( 14,264 ha )
7	Revitalizimin e fondit blegtoral dhe mekanizmit të infrastrukturës bujqësore,
8	Themelimi i grantit komunal për rivitalizimin e fondit blegtoral dhe bletar
9	Ndërtimin e kopështeve, serave dhe ngritjen e fermave në fshat,

Tab. 42: Projektet e Bashkëpunimit ndërkufitarë dhe ndërajonal

1	Organizimi i një panairit të përbashkët ndërkufitar / NVM
2	Organizimi i një konference të donatorëve për financimin e projekteve ndërkufitare
3	Bashkëpunimi me të gjitha organizatat dhe institucionet që e mbështesin projektet ndërkufitare
4	Sanimi i gjendjes së rrugës Gjilan – Presheve
5	Përfundimi i rrugës Gjilan- Stançiq- Kumanovë dhe kyçja në koridorin e 8 & 10
6	Realizimi i projektit të rrugës Gjilan-Ponesh-Kishnapolë-Lypjan
7	Realizimi i projektit të rrugës Zhegër-Goden-Stubëll-Viti

### 1.3 VLERËSIMI I KAPACITETEVE INVESTUESE

Kapacitetet investuese janë potencial i financimit të projekteve ekonomike etj. e që ndikojnë në vlerësimet brenda projekteve zhvillimore. Në këtë grup bëjnë pjesë edhe investimet për projekte kapitale publike dhe private.



Në rrethanat aktuale në Kosovë, duke pas parasysh mundësitë e kufizuara financiare, sidomos vlerësimi i kapaciteteve investuese publike (sektorët dhe burimet), ka rëndësi të veçantë.

Kuvendi Komunal Gjilan 12/2006

## INVESTIMET 2008-2017

Kapacitetet ndahen në ato ekzistuese dhe të mundshme.

### 1. Kapacitetet ekzistuese përfshijnë:

- Buxhetin Komunal,
- Sektorin privat,
- Sektorin publik,
- Burimet natyrore,
- Kapacitetet e infrastrukturës fizike (ndërtesat ),
- Potenciali njerëzor (rinia)

### 2. Ndërsa kapacitet e mundshme përfshijnë:

- investimet e mundshme të Qeverisë.
- Investimet nga jashtë,
- fondet ndërkombëtare,
- Pakti i Stabilitetit,
- BE dhe donacionet tjera Gjilan 09/2007
- kreditë dhe grantet,

## Buxheti komunal

Në situatën aktuale vetëm buxheti komunal është i mundshëm të vlerësohet, ndërsa sektorin privat, publik apo donacionet mund të vlerësohen duke u bazuar në përqindjen e pjesëmarrjes së tyre mesatare në Kosovë (25%, 75%, 5%).

Komuna për vitin 2008 ka aprovuar buxhetin prej 10.842,000 €. Dhënia (grandi) qeveritar merr pjesë me 7.790,000 €, ndërsa të hyrat vetjake janë të vlerësuara prej 3,052,000 €.

Komuna ka aprovuar stafin maksimal prej 2488 punëtorëve, për të gjitha programet.

Komuna mbledh dhe merr të hyrat vetanake nga kontributet dhe taksat komunale, duke përfshi gjobat në trafik, tarifatat administrative, licencat, tatimin në prone, lejet e ndërtimit. Normat e mbledhjes kanë qenë të ulëta deri tash. Ka pasur vetëm rritje të kufizuar në të hyrat vetanake krahasuar me llojet tjera të hyrave, kështu që komuna është shumë e varur nga dhëniet (grantet) e qeverisë qendrore. Punë substanciale




është bërë për zbatimin e një sistemi të tatimit në pronë në komunë dhe kjo ka ofruar fushëveprimin më të madh të rritjes të hyrave vetanake komunale. Komuna në mënyrë aktive ka kërkuar mënyra për të zgjeruar bazën e të hyrave vetanake dhe për të përmirësuar inkasimin e të hyrave buxhetore. Burimi kryesor i të hyrave vetanake të komunës është tatimi ne pronë.

Vitet	Të hyrat	Pagat/mallrat/shërb.	Invest.kapitale	
2008	10,842,000	8,604,000	2,238,000	
2009	11,322,000	9,002,000	2,320,000	
2010	11,564,000	9,018,000	2,546,000	
2011	11,738,000	9,420,000	2,318,000	
2012	12,048,000	9,447,000	2,601,000	
2013	12,556,000	9,869,000	2,687,000	
2014	13,176,000	9,893,000	3,283,000	
2015	13,642,000	10,351,000	3,291,000	
2016	13,946,000	10,380,000	3,566,000	
2017	14,206,000	10,860,000	3,346,000	
	125,040,000	96,844,000	28,196,000	

Taksat për infrastrukturë të përmirësuar:

Vitet	Koncesionet	Lejet O.kolekive	Legalizimi ON.	Gjithsej
2008	3,100,000	210,000	2,500,000	5,810,000
2009		235,000	3,400,000	3,635,000
2010	2,980,000	254,000	3,700,000	6,934,000
2011	3,120,000	225,000	3,900,000	7,245,000
2012		300,000	4,200,000	4,500,000
2013	2,450,000	245,000	4,500,000	7,195,000
2014	3,200,000	187,000	5,000,000	8,387,000
2015	2,400,000	234,000	5,100,000	7,734,000
2016		190,000	4,900,000	5,090,000
2017	3,050,000	275,000	3,500,000	6,825,000
	20,300,000	2,353,000	40,700,000	63,353,000



Kapacitetet e mundshme:

Vitet	B.Ministror	Kredit	Donacionet	Diaspora	Gjithsej euro
2008	950,000		700,000	650,000	2,300,000
2009	4,225,000	8,000,000	680,000	1,500,000	14,405,000
2010	1,810,000		650,000	2,000,000	4,460,000
2011	4,590,000		900,000	2,400,000	7,890,000
2012	2,380,000		890,000	1,800,000	5,070,000
2013	2,570,000		550,000	1,100,000	4,220,000
2014	900,000		780,000	950,000	2,630,000
2015	4,540,000		840,000	2,100,000	7,480,000
2016	820,000	7,000,000	790,000	3,400,000	12,010,000
2017	2,770,000		920,000	4,900,000	8,590,000
<b>Totali</b>	<b>25,555,000</b>	<b>15,000,000</b>	<b>7,700,000</b>	<b>20,800,000</b>	<b>69,055,000</b>

#### 1.4 SFIDAT KRYESORE ZHVILLIMORE

##### Zhvillimi i paplanifikuar dhe shkalla e lartë e papunësisë

- I tërë zhvillimi në komune është bërë pa planifikim institucional , është bërë dyfishimi i kapaciteteve dhe nuk janë shfrytëzuar resurset lokale dhe potencialet për zhvillim të qëndrueshëm bujqësisë.
- Gjatë planifikimit duhet të përcaktohen mënyrat për institucionalizim (vënia nën kontroll) e këtij zhvillimi, dhe të planifikohet zhvillimi i ardhshëm duke u bazuar në potencialet lokale.

##### Shfrytëzimi joracional i hapësirës

- Shumica e ndërtimeve janë bërë në tokë bujqësore (humbje e pa kthyeshme e tokës bujqësore) dhe përgjatë korridorit të rrugëve (pamundësi e zgjerimit të rrugëve ekzistuese).
- Si mund t'i ndalojmë këto ndërtime dhe si të vepojmë me ato ekzistuese ?





## Mjedisi

- Mjedisi jetësor ne zonën urbane dhe atë rurale është i kualitetit te dobët (shërbime jo te mjaftueshme ne mbledhjen e mbeturinave dhe mos trajtim i ujërave te zeza).
- Gjatë planifikimit duhet te përcaktohen mënyrat se si ti përparojmë këto shërbime që ta rrisim kualitetin e mjedisit jetësor.

## Infrastruktura e dobët teknike

- Infrastruktura teknike në përgjithësi si në zonën urbane ashtu edhe në atë rurale është e dobët si në aspektin kualitativ dhe kuantitativ.
- Si mundemi ti përshtatim korridoret ekzistuese zhvillimeve aktuale dhe ti planifikojmë korridoret e reja në harmoni me nevojat për zhvillimin të ardhshëm.

## Trashëgimia natyrore

- Trashëgimia natyrore është në shkatërrim e sipër.
- Gjatë planifikimit duhet te kemi parasysh shfrytëzimin e këtyre vlerave dhe mbrojtjen e tyre për brezat e ardhshëm.

## Niveli i ulët i shërbimeve shëndetësore dhe sociale

- Shërbimet shëndetësore dhe sociale në përgjithësi janë jo të kënaqshme në zonën urbane e sidomos ne atë rurale.
- Si mundemi që këto shërbime ti përmirësojmë që të jenë më afër banorëve.

## Standardet, Normat dhe Parimet

- Pjesa dërmuese e zhvillimeve janë bërë jashtë standardeve , normave dhe parimeve të aplikueshme të cilat janë obliguese edhe për ne.
- Si të planifikojmë zhvillimin për të ardhmen në mënyre që të arrihen standardet ndërkombëtare , transparenca si dhe pjesëmarrja në vendimmarrje.



## 2 VIZIONI, PARIMET DHE CAQET

### 2.1 VIZIONI PËR TE ARDHMEN E KOMUNËS

Plani Zhvillimor Komunal i Gjilanit është duke e përgatitur të ardhmen e komunës për 15 vitet e ardhshme dhe më tej. Për këtë periudhë kohore, vizionet, parimet dhe qëllimet në vijim do ta udhëzojnë dhe orientojnë zhvillimin e komunës.

#### Gjilani – Forca lëvizëse në Anamoravë

Bazuar në burimet e tij të mineraleve, traditës industriale, dhe njohurive të teknologjisë të afërta me të, Gjilani do të funksionoj si qendër e madhe në rajonin e Anamoravës. Një politikë adekuate për tokën, dhe objektet dhe pajisjet e reja të rrjetit të komunikacionit, do ti ndihmojnë Gjilanit që ta realizoj potencialin e rritjes ekonomike. Edhe tregtia do të ndikoj pozitivisht në zhvillimin ekonomik të Gjilanit. Për ta arritur këtë qëllim, Gjilani duhet të ketë shfrytëzim të mirë edhe lidhjet e tij të mira tradicionale me qytetet e Bujanovcit, dhe Preshevës (në Serbi) dhe Kumanovë (në Maqedoni).

#### Gjilani – Kualiteti i jetës së banorëve dhe vizitorëve

Përmirësimi i zonave ekzistuese të banimit dhe zhvillimi i zonave të reja banuese, si dhe përmirësimi i objekteve dhe pajisjeve të infrastrukturës teknike dhe sociale do ta zhvilloj Gjilanin si komunë atraktive dhe me banim të qëndrueshëm.

Cilësia e jetës në komunë gjithashtu ndikohet edhe nga vlerat rekreative të trashëgimisë së tij natyrore.



## Deklarata e VIZIONIT

Duke shfrytëzuar pozitën qendrore në trekëndëshin e dyfishtë Gjilani do të bëhet një urë moderne ndërlidhëse, do të ofroj shërbime cilësore në një mjedis të qëndrueshëm, edukim dinamik me teknologji moderne që mbështet rritjen ekonomike me theks në bujqësi në funksion të përmirësimit të kushteve të jetës urbane dhe rurale në partneritet të plotë, identitetin do ta fuqizoj në vlerat e veta e sidomos ato kulturore e qytetare si një qendër rajonale universitare.(komuna, shoqëria civile dhe Habitati).

### 2.2 PARIMET E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIM

Vizioni i komunës së Gjilanit i vendos prioritetet e mësipërme përreth parimeve dhe qëllimeve të zhvillimit në vijim:

- Zhvillimin e objekteve dhe pajisjeve për një infrastrukturë adekuate sociale dhe teknike, e cila i merr parasysh nevojat e banorëve,
- Promovimin e ekonomisë së qëndrueshme të komunës , duke siguruar punë të mjaftueshme për banorët e qytetit
- Promovimi i kohezionit territorial përmes zhvillimit socio-ekonomik më të balancuar të rajonit dhe përmirësimit të konkurrencës
- Inkurajimi i zhvillimit të gjeneruar nga funksionet urbane dhe përmirësimi i raportit zhvillimor në mes të qytetit dhe fshatit,
- Ngritjen e kushteve për banim të shëndetshme dhe atraktive në zonat urbane dhe zonat fshatare,
- Furnizimin e mjedisit urban dhe fshatar me ujë të mjaftueshëm, duke kontribuar në përmirësimin e kualitet të jetës
- Mundësimi i qasjes në informata dhe njohuri,
- Zvogëlimi i dëmeve mjedisore,
- Përparimi dhe mbrojtja e resurseve natyrore dhe të trashëgimisë natyrore.
- Promovimin e infrastrukturës për rekreacion dhe turizëm,
- Zhvillimin e sistemit të përshtatshëm të trafikut të/transportit të lëvizshëm / (duke siguruar qasje të mirë urbane).




Fig.37: Gjiçani, qendra e trekëndëshit të dyfishtë

### 2.3 CAQET ZHVILLIMORE AFATGJATE

Qëllimi i analizës situacionale nuk është vetëm gjetja dhe evidentimi i problemeve por më shumë gjetja dhe sigurimi i mundësisë buxhetore për ti zgjidhurato. Komuna ka burime të limituar buxhetore në dispozicion. Megjithatë, është e rëndësishme që këto burime të përqendrohen në sektorët të cilët po e bëjnë Gjiçanin të dallueshëm nga pjesët tjera të Kosovës, dhe të cilat mundësojnë që ta zhvillojnë komunën më tutje.



Fig.38: Potencialet zhvillimore Komunale



Qëllimet për zhvillim afatgjatë janë:

- Përmirësimi i kushteve të mjedisit, trajtimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore si dhe mbështetja gjithëpërfshirëse e bujqësisë përmes mbrojtjes më të mirë të tokës bujqësore .
- Sigurimi i infrastrukturës së përgjithshme për aktivitete ekonomike në pjesët urbane dhe rurale
- Zgjidhja e mungesës së lokacioneve, hapësirave dhe objekteve në fushat kryesore të infrastrukturës publike dhe sociale në funksion të përmirësimit të qasjes në shërbimet e caktuara.
- Vënia në zbatim e rregullimit, zhvillimit si dhe shfrytëzimit racional të tokës me qëllim që të ofroj një organizim të qëndrueshëm të vendbanimeve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në pjesët rurale dhe urbane.
- Zhvillimi i infrastrukturës së mjaftueshme adekuate dhe shërbimet publike në hapësirat urbane dhe rurale
- Vënia në zbatim e lëvizshmërisë së lirë dhe të sigurt , tërheqëse dhe e shumëllojshme për të gjithë qytetarët dhe fuqizimi i Gjiçanit, si një urëlidhëse dhe integrimi i tij, në rrjetin Kosovar dhe ndërraonal të transportit
- Përmirësimi i cilësisë së mjedisit jetësor për të gjithë qytetarët e komunës .

## 2.4 PRIORITETET STRATEGJIKE

### PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I VENDBANIMEVE

#### Fushëveprimet

- Planet rregulluese për zgjerim urban dhe nën qendrave të identifikuar,
- Menaxhimi i shfrytëzimit të tokës,
- Trajtimi i vendbanimeve joformale,
- Bashkëpunimi ndërkufitar,
- Ndërtimi objekteve sipas standardeve në hapësirat jo të ndërtuara dhe masat mbrojtëse për reduktimin e pasojave nga tërmetet, vërshimet, erozionet etj.
- Partneriteti Publiko Privat ( PPP)





- Vënia në zbatim e rregullave të ndërtimit për banim në dobi të rritjes së dendësisë për sipërfaqe në zonat e banimit.
- Mbrojtja e objekteve dhe zonave të trashëgimisë kulturore dhe historike.

### Prioritetet Strategjike

- Hartimi i Planeve rregulluese të nën qendrave: Zhegër, Pogragjë, Miresh, Përlepnice, Bresalc dhe Cërnicë.
- Trajtimi i vendbanimeve joformale
- Trajtimi i 17 vendbanimeve të ndryshme komunale në bazë të koncepteve të zhvillimit hapësinor.

## DEMOGRAFIA DHE ÇËSHTJET SOCIALE

### Fushëveprimet

- Fushëlojat dhe kopshtet për fëmijë,
- Objekte dhe hapësira shkollore të reja për ciklin e ulët (në vendbanimet urbane dhe rurale),
- Edukimi i avansuar (Shkollat e mesme : për bujqësi, mjekësi dhe fushat tjera),
- Zgjerimi i edukimit të lartë universitar,
- Qendër aktivitetesh për grupmosha të ndryshme,
- Qendra për asistencë, shërbime sociale dhe strehim,
- Qendra të kulturës, (Teatër, Bibliotekë, Muze),
- Objekte dhe hapësira për sport dhe rekreacion.

### Prioritetet Strategjike

- Krijimi i infrastrukturës për edukim në varësi me konceptin e nën qendrave,
- Sigurimi i lokacionit për edukim të lartë në hapësirat urbane,
- Krijimi i infrastrukturës për objektet kulturore dhe sportive,



## ZHVILLIMI EKONOMIK

### Fushëveprimet

- Hapësira të reja industriale të pajisura me infrastrukturë .
- Ndërtim të tregjeve,
- Inkubator Biznesi,
- Qendra zejtare
- Përmirësim të infrastrukturës rurale në varësi me zhvillimin e aktiviteteve bujqësore dhe procedimin e produkteve ushqimore.
- Ujitja dhe infrastruktura përcjellëse teknike për të lehtësuar dhe mbështetur prodhimet bujqësore,
- Sigurimi i lokacioneve të reja për aktivitete fermerë në pajtim me parimet planifikuese,
- Rivitalizim të burimeve dhe hapësirave termale,
- Zhvillim të hapësirave turistike dhe rekreative.

### Prioritetet Strategjike

- Zonat Industriale
- Hapësirat aktive rurale
- Zhvillimi i zonave turistike në Kalanë e Pogragjës, Përlepnice, Mires, Uglar, Nasalë, Pidiq etj .
- Zhvillimi i zonës rekreative në Stanishor,
- Zhvillimi i zonës së lirë doganore në Stanqiq dhe Muqibabë.

## MJEDISI DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS

### Fushëveprimet

- Sigurim , mbrojtje, rigjenerim dhe shfrytëzim i tokës për bujqësi.
- Sistem i menaxhimit të tokës dhe fond për këmbim të tokës,
- Ripyllëzim,
- Reduktim i ndotjeve dhe pastrim të lumenjëve,



- Mbrojtje e zonave ujore,
- Parandalim i vërshimeve,
- Mbrojtje e hapësirave dhe objekteve me vlera natyrore,
- Mbrojtje e hapësirave - zonave me resurse nëntokësore.

### Prioritetet Strategjike

- Realizimi i projektit të lumit Mirusha,
- Mbrojtja e tokës së vlefshme bujqësore,
- Mbrojtje e resurseve nëntokësore.

### INFRASTRUKTURA TEKNIKE

#### Fushëveprimet

- Burimet dhe furnizimi me ujë.
- Sistemi i kanalizimit.
- Mbrojtja e lumenjëve.
- Mbledhja dhe trajtimi i mbeturinave.
- Furnizimi me energji elektrike,
- Rrjeti i Telekomunikimit,
- Ndriçimi publik,
- Shfrytëzimi i burimeve të reja energjetike dhe energji efektive për sistemet e ngrohjes,
- Rregullim më i mirë i komunikacionit urban, vendparkimeve dhe masave mbrojtëse,
- Transport publik (rrugor dhe hekurudhor),
- Lidhje ndër-regjionale,
- Ndërtim dhe zgjerimi i rrugëve në zonat rurale,
- Rehabilitim dhe zgjerimi i rrugëve në hapësirat urbane,
- Shtigje për këmbësorë dhe rrjeti për biçiklizëm,
- Përmirësim i hapësirave të gjelbëruara publike dhe i kushteve në hapësirat urbane dhe rurale,
- Ndërtim i fushëlojave dhe terreneve të vogla sportive,
- Hapësira për varreza të reja,




## Prioritetet Strategjike

- Trajtimi qendror i ujit të pijshëm,
- Impianti,
- Penda e Llapushnikut,
- Burimet dhe furnizimet me ujë,
- Furnizimi me energji për ngrohje,
- Hidrosistemi i Ibër – Lepencit,
- Përmirësim i rrjetit rrugor me infrastrukturë përcjellëse në drejtim të Maqedonisë dhe Serbisë,
- Rrugë e re për Lypjan,
- Mbështetje zhvillimit policentrik dhe lehtësim të qasjes së nën-qendrave,
- Siguri dhe rregullim të komunikacionit urban,
- Lidhje të re të rrjetit hekurudhor me infrastrukturë përcjellëse Ferizaj-Gjilan me korridoret VIII-të dhe X-të.
- Krijim dhe përmirësim të kualitetit të hapësirave publike në pjesën urbane dhe rurale të Gjilanit (varrezat, stacioni i autobusëve, vendparkimet, hapësirat e gjelbëruara, rehabilitimi i hapësirave tregtare urbane dhe rurale).



Fig.39: Harta e Vizionit Komunal nga Punëtorja në Ohër



Në Ohër, në bashkëpunim me shoqërinë civile u zgjodh sistemi policentrit si formë e zhvillimit Komunal



## Projektet prioritare të dala nga Punëtorja e Vizionit Komunal në Ohër

Qështjet	Prioriteti (me pikët më)	Shoqëria Civile		D.U.R.A - Ekipi Komunal i Planifikimit					
		Rëndësia		Urgjent		Buxheti		Korrespondenca	
		I	II	Po	Jo	Afat shkurte	Afat gjate	Po	Jo
Furnizimi me uje te pijshem (24 h/dite)	18	8	2			X		X	
Univeristet i Ri	16	6	4		X		X	X	
Gjelberimi ne hapsirat urbane	16	7	2	X		X		X	
Shkolla te reja filloret(3/6)	16	7	1	X		X		X	
Qender per te moshuarit	14	6	2	X		X		X	
Impianti i trajtimit të ujrave te zeza	14	7	0			X		X	
Sistemi i ri i transportit publik urban dhe rural	14	6	2		X	X		X	
Ndriçimi i rrugëve	14	5	4	X		X		X	
Projekti i integruar urban i lumit Mirusha dhe Stanishorka	13	4	5	X		X			
Mbakalimet, nenkalimet dhe shtigjet per kembesore ne rruget kryesore dhe ne qender te qytetit.	13	4	5	X		X		X	
Rivitalizimi i objektit ne shfrytezim nga Sh.Muzikes ne Muze te qytetit + muzeu regional	13	6	1	X		X		X	
Shkollë e re bujqesore	12	5	2		X		X	X	
Qender Rinore (2)	12	3	6		X	X		X	
Ndertimi i parqeve te reja	12	5	2	X		X		X	
Ndertimi i fushelobjave dhe terreneve sportive	12	4	4	X		X		X	
Zhvillimi i fermave te bleqetorisë	12	4	4		X		X	X	
Qender e re multikulturale dhe shkollë e arteve	11	4	3		X		X	X	
Qendra te sportit dhe rekreacionit (2)	11	4	3	X		X			X
Rivitalizimi i Teatrit ekzistues	11	4	3		X	X		X	
Zonat per kultivimin e prodhimeve bujqesore	11	5	1		X		X	X	
Dezinfektimi dhe rikonstruktimi i pallateve ne qender te qyt.	9	2	5	X		X		X	
Permiresimi i rrugëve kryesore	9	4	1		X	X		X	
Ndertimi i rruges qarkore	9	3	3	X		X		X	
Permiresimi i burimeve termale ne Mireshe (Dobercan) Margesh (Uglar)	9	4	1		X	X		X	
Rikonstruimi i Sahat Kullës/ rehabilitimi i monumenteve historike	9	4	1	X		X		X	
Varrezat e reja /adaptimi i hapsirave te reja per varreza	8	3	2	X		X		X	
Ripylezimi dhe Pylezimi	8	4			X	X		X	
Ndertimi i qendres per artizanate	8	4			X				X
Permiresimi i rrjetëve, informatave dhe trajnimeve per zhvillim ekonomik. Agjensioni per Zhvill. Ekonomik.	8	3	2		X	X		X	
Shkollë e re e mjeksise (e mesme)	7	3	1		X		X	X	
Qendra multikulturale (2)	7	2	3		X	X			X
Zhvillimi i zones industriale pergjate magjistrales Gjilan-Bujanoc	7	3	1	X		X		X	
Sistemet per mbrojtjen nga te reshurat atmosferike	7	2	3		X		X	X	





Qështjet	Prioriteti (me pikët më)	Shoqëria Civile		D.U.R.A - Ekipi Komunal i Plnifikimit					
		Rëndësia		Urgjent		Buxheti		Korrenspondenca	
		I	II	Po	Jo	Afat shkurte	Afat gjate	Po	Jo
Zhvillimi i Zonës industriale për prodhim të drurit	7	2	3		X		X		X
Zhvillimi i qendres industriale në Cernice, Kravarice dhe Gumnishtë	7	2	3		X		X		X
bujqësor (zona industriale 2)	7	1	5		X		X		X
Hapja e rrugës Gjilan-Lipjan	7	3	1		X	X		X	
Shkollë e re e mesme në Zheger	6	2	2		X		X	X	
Trajtimi i shtratit të lumit Morava për parandalimin e permbytjeve	6	2	2		X	X		X	
Qënder për studime seizmike	6	2	2		X	X		X	
Permirësimi i infrastruktures në pjesët rurale (rrugët, energjia, telekomunikimi)	6	3			X			X	
Zhvillimi i zonës prodhuese bujqësore	6	3			X		X		X
Restaurimi dhe konsolidimi i Kalasë së Pogradecit	6	3		X		X		X	
Ndërtimi i linjës hekurudhore dhe të stacionit hekurudhor	5	1	3		X		X	X	
Stadiumi i ri Olimpik	3	1	1		X		X	X	
Ndërtimi i tregut të gjelbër në lagjen Dardania	3	1	1		X	X		X	
Shtigjet për biçiklizem	3	1	1		X	X		X	
Puset e reja për furnizim me ujë industriale	2		2		X	X		X	
Zona industriale për prodhimin dhe përpunimin e frutave natyrore	2	1			X		X		X
Ndërtimi i tregut të gjelbër në Ramiz Cernica	2		2		X	X			X
Permirësimi i kryqezimeve të rrugëve kryesore/kryqezimet Qarkore	2	2		X		X		X	
Legal institutional improvement	2	1		X		X		X	
Qendra e burimeve në Gjilan ? (Burimet njerezore)	1		1		X				X
Zhvillimi i zonës industriale në	1		1		X				X
Ndërtese e re për Arkivin Regional									
Biblioteka e re regjionale									
Shtëpia e Paqes /te përfundohet/									
2 mini Spitale në zonat rurale									
Parkingjet dhe hapësirat e reja për parkim									
Shfrytëzimi i Sistemit të Informacionit GIS për tokat									
Shfrytëzimi dhe menaxhimi i tokës (planet destinuese)									
Partneriteti publik privat /konsesioni/									
Mbrojtja me ligj e vlerave dhe trashëgimisë natyrore									



### 3 KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR KOMUNAL

#### 3.1 KONCEPTET KRYESORE TË ZHVILLIMIT HAPËSINORË

##### Konceptet Hapësinore

Përpara se të krijohet modeli i zhvillimit hapësinor, janë diskutuar instruksione të ndryshme bazike konceptuale në lidhje me zhvillimin hapësinor të komunës. Këto rrethana janë prezantuar në pesë plane të veprimit duke e treguar secila zhvillimin e ndryshëm dhe të mundshëm.

##### Skenari A “Zhvillim intensiv linearë Ferizaj–Bujanovc”

Ky skenarë veçohet me këto karakteristika të zhvillimit:

- I gjithë zhvillimi është i koncentruar në rrafshin e Anamoravës,
- Qyteti linear është i zhvilluar me rrugë magjistrale M 25-3 si një aks,
- Funkcionet qendrore, linja e re hekurudhore dhe zonë e gjelbërimit janë të zhvilluara përgjatë këtij aksi,
- Stacionet e trenave për trenat rajonal janë ndërtuar në 3 lokacione të ndryshme të qytetit,
- Fshatrat përgjatë aksit janë inkorporuar në qytet , fshatrat tjera nuk janë zhvilluara.



##### përparësitë

- Zhvillimi në aksin rajonal,
- Struktura lineare krijon distanca të shkurta në qendër dhe park,
- Qasje e mirë në qytet,
- Përcillet trendi i zhvillimit,
- Kostoja e përballeshme e infrastrukturës tekniken zonën urbane.



##### dobësitë

- Mos zhvillimi i fshatrave,
- Lidhshmëria i dobët ndërmjet fshatrave dhe qytetit,
- Rreziku i formimit të shpërndarjes së vendbanimeve,
- Ndërtimi në tokë bujqësore,
- Degradimi i ambientit,
- Centralizimi institucional.
- Qasja e dobët e fshatrave në infrastrukturën sociale,



- Lartësia e kostos së infrastrukturës në zonat rurale,
- Trafik i rëndë nëpër qytet,
- Distanca të gjata brenda qytetit,
- Lidhja e dobët e fshatrave me zonën urbane.

**konkluzion:**

- Skenari nuk do të zhvillohet më tutje.

**Skenari B “Zhvillim i koncentruar”**

Ky skenar veçohet me Zhvillim të theksuar të qytetit,

- i gjithë zhvillimi është i koncentruar në qytetin e Gjilanit,
- E gjithë rruga qarkore është e ndërtuar përreth qytetit,
- Korridoret e gjelbërimit futen nga periferia në qendrën e qytetit,
- Qyteti zhvillohet në mes korridoreve të gjelbra,
- Linjë e re hekurudhore është e ndërtuar në jug të qytetit, me stacion afër qendrës së qytetit,
- Fshatrat në periferi janë inkorporuar në qytet , fshatrat tjera nuk janë zhvilluar.

**përparësitë**

- Struktura kompakte e qytetit krijon distanca të shkurta – “qyteti distancave të shkurta”,
- Sistem unazor i rrugëve i efektshëm e mbron trafikun,
- Korridoret e gjelbërimit sigurojnë qasje në gjelbërim të qytet,
- Stacioni i trenave në qendër të qytetit,
- Lidhje relativisht e mirë e fshatrave me qendrën urbane,
- Kosto më e ulët e infrastrukturës teknike.

**dobësitë**

- Mos zhvillimi i fshatrave,
- Lidhshmëria e dobët ndërmjet fshatrave dhe qytetit,
- Centralizimi institucional,
- Qasja e dobët e fshatrave në infrastrukturën sociale,
- Ndërtimi në tokë bujqësore,
- Rreziku i formimit të shpërndarjes së vendbanimeve
- Lidhja e dobët e fshatrave në mes veti.

**konkluzion:**

- Ky skenar do të zhvillohet në kombinimin me skenarë tjerë.



## Skenari C: Zhvillim përgjatë korridoreve”

Zhvillimi me theks në rrugët magjistrale

- I gjithë zhvillimi ndodh në fshatrat përgjatë rrugëve kryesore,
- Fshatrat janë të ndara në mes veti me zona gjelbërimi,
- Linjë e re hekurudhore është ndërtuar në veri të qytetit, me stacion në rrugë për Prishtinë.



### përparësitë

- Sigurimi i infrastrukturës bazike për fshatra,
- Zhvillimi i fshatrave.



### dobësitë

- Zhvillimi i dobët i zonës urbane,
- Rreziku i zhvillimit të qytetit përgjatë rrugës kryesore,
- Çmimi i lartë i infrastrukturës,
- Burime të pamjaftueshme për zhvillimin e fshatrave,
- Pjesë të komunës të pazhvilluara,
- Ndërtimi në tokë bujqësore
- Rreziku i formimit të shpërndarjes së vendbanimeve,
- Lidhja e dobët e fshatrave në mes veti,
- Vështir të realizohet,
- Nuk është real zhvillimi më i madh në fshatra se në qytet.



### konkluzion:

- Skenari nuk do të zhvillohet më tutje.

## Skenari D “Zhvillimi poli-centrik”

- Zhvillimi është i ndarë në mes qytetit të Gjilanit dhe fshatrave më të mëdha të komunës,
- Fshatrat e mëdha i furnizojnë fshatrat tjera me shërbime institucionale, infrastrukturë teknike dhe sociale,
- Linjë e re hekurudhore është ndërtuar në veri të qytetit, me stacion në rrugën për Prishtinë.



### përparësitë

- Zhvillimi si i qytetit ashtu edhe i fshatrave më të mëdha,
- Stacioni i trenave në qendër të qytetit,
- Lidhje relativisht e mirë e fshatrave me qendrën urbane
- Kosto më e ulët e infrastrukturës teknike,
- Sigurimi i infrastrukturës bazike për fshatra,



- Shpërndarja e mirë institucionale dhe e infrastrukturës teknike dhe sociale.
- Numër i vogël i qendrave sekondare bëjnë koncentrimin e burimeve,
- Mundësia e lidhjes së qendrave sekondare mes veti me një 'Unazë Komunale'.

**- dobësitë**

- Zhvillimi i pamjaftueshëm i qytetit,
- Pamundësia e shtrirjes së linjës hekurudhore.

**→ konkluzion:**

- Ky skenar do të zhvillohet në kombinimin me skenarë tjerë.

	kufiri shtetërorë national border
	kufiri i Kosovës Kosovo border
	kufiri komunal i Gjilanit Gjilan municipality border
	kufiri komunal municipality border
	qyteti ekzistues/ fshat me qendër existing town / village with centre
	zhvillim i vendbanimit me qendër settlement development with centre
	rrugë magjistrale magistral road
	boшти i zhvillimit development axis
	korridorret e gjelbra green corridors
	pyll forest

**Kuvendi Komunal Gjilan**  
Municipal Assembly of Gjilan

---

**Plani zhvillimor komunal i Gjilanit**  
Municipal development plan of Gjilan

---

**Skenari hapsinor**  
Spatial Scenarios





14.04.2008

Përpjesa: 1:10000  
Scale: 1:10000

Plan 8  
Plan 8

DIREKTORIA PER URBANIZEM, RINDERTIM DHE AMBIENT  
THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT

**planingsgruppe 4**







## 3.2 STRUKTURA DHE LOKACIONI HAPËSINORË PËR ZHVILLIMIN DHE ORGANIZIMIN E ARDHSHËM

Secili skenarë është analizuar veç e veç - në bazë të kriterëve siç janë: Popullsia, shtrirja hapësinore, largësia e lëvizjes, zhvillimi i infrastrukturës teknike dhe asaj sociale, kostoja e realizimit, ndikimi mjedisor, trendët e rritjes, ruajtja e tokës bujqësore etj, - për të ardhur kështu deri te zgjidhja e preferuar ose MODELI I ZHVILLIMIT HAPËSINORË.

Ky model është i bazuar në konkluzionet nga analiza situacionale, në planet hapësinore të veprimit si dhe i tregon bazat kualitative në lidhje me zhvillimet hapësinore të komunës. Pikat kryesore në vijim nga bazat e modelit të zhvillimit hapësinor:

### Zhvillimi policentrik

Të gjitha pjesët e komunës duhet të kenë mundësi që të zhvillohen. Burimet e limituara që janë në dispozicion të komunës sidoqoftë duhet të përdorën në mënyrë efektive. Prandaj, zhvillimi është i ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet qytetit të Gjilanit dhe pesë qendrave tjera dytësore që janë të përhapura rreth komunës.

Qytetit i Gjilanit është qendër komunale. Të gjitha funksionet publike qendrore, salla e qytetit, spitali dhe fakulteti, shkollimi universitar janë të përqendruara në qytet. Shumica e tokës ndërtimore për banim privat dhe shfrytëzim komercial gjithashtu është e furnizuar në qytet.

Përmes afërsisë me qytetin e Gjilanit, fshatrat që kalojnë drejtpërdrejt përreth tij, janë shtyllë e fortë e zhvillimit. Nga kjo ato mund të kenë funksion nën-urban.

Fshatrat të cilat janë zgjedhur si qendra policentrite janë:

1. Bresalci
2. Përlepnica
3. Dobërçani
4. Pogragja
5. Zhegra dhe
6. Cërnica

Qendrat dytësore janë përzgjedhur në bazë të këtyre kriterëve:

- Partneriteti Urban – Rural,
- Numri i Popullsisë,
- Institucionet dhe infrastruktura ekzistuese,
- Potencialet zhvillimore,



- Shtrirja gjeografike,
- Trendët e rritjes etj.

dhe janë duke i furnizuar fshatrat përreth me infrastrukturë publike dhe private. Disa funksione bazike publike shoqërore si për shembull, shkollat e mesme, qendrat e mjekësisë familjare, dhe zyrat komunale janë të vendosura aty. Për ta përforcuar rritjen e qendrave dytësore, gjithashtu iu është ofruar tokë ndërtimore për banim dhe përdorim komercial.

### Dendësia në fshatrat më të mëdha të Komunës

Dendësia e Banorëve në Komunë					
Nr.R.	Emërtimi	E.i mëhers	Sj	Nr.i banorëve	
				1998	2004
			Ha		
1	<b>Gjilani</b>	<b>Gjilani</b>	<b>1695</b>	<b>59897</b>	<b>76932</b>
2	Zhegra	Zhegra	2327	5563	5927
3	Malishta	Malisheva	1396	3710	5210
4	Mireshti	Dobërçani	1312	3434	3760
5	Bresalci	Bresalci		3494	3250
6	Përlepi	Përlepnica		2677	2852
7	Idrizaj	Velekinca	438	2592	2800
8	Livoqi I Epërm	Livoqi I Epërm		2334	2738
9	Livoqi I Poshtëm	Livoqi I Poshtëm		2541	2700
10	Llashtishti	Lashtica	1164	2070	2450
11	Cernica	Cernica		3097	2340
12	Pasjani	Pasjani	1527	2160	2317
13	Margeshi	Uglari	851	1578	2200
14	Kalaja	Pogragja	1846	1890	2100
15	Kufca	Kufcë e Epërme		2241	1827
16	Shillova	Shillova		1346	1745
17	Parteshi	Parteshi	807	1434	1615
18	Poneshi	Poneshi		1744	1380
19	Budrika e P.	Budrika e P.	530	1250	1285
20	Kuretishta	Kuretishta		1238	1070
21	Urbishti e Zhegocit	Vërbica e Zhegocit		1040	1070
22	Kmetoci	Kmetoci		1135	1057
23	Muhaxheraj	Pasjaku		589	800
24	Fushëmiri	Lladova	273	763	755
25	Lamishta	Gumnishta		662	720
26	Stanishori	Stanishori		551	534
27	Gadishi	Gadishi		572	510



Tabelat në vijim tregojnë përfshirjen e fshatrave dhe numrin e popullatës në Qendrat dytësore ( policentrike )

	Qendra po	Rrethina	Nr.i popullatës
<b>1</b>	<b>Zhegra</b>		<b>5927</b>
	1	Lipovicë	23
	2	Burincë	12
	3	Muqibabë	64
	4	Llashticë	2450
	5	Nasalë	245
	6	Lladovë	755
	7	Kurexh	0
	8	Terzijaj	0
	9	Haxhaj	0
	10	Selishtë	0
	11	Goden i Ul	105
	12	Demiraj	0
	13	Isufaj	0
	14	Pidiq	378
	15	Shurdhan	152
	16	Stanqiq	55
	17	Dunav(Tun	0
	18	Çelik	91
			<b>10257</b>

	Qendra po	Rrethina	Nr.i popull.
<b>4</b>	<b>Përlepnica</b>		<b>2852</b>
	1	Kmetoci	1057
	2	Kufcë e Ep	1827
	3	Dragancë	25
	4	Mozgovë	12
	5	Makreshi i	130
	6	Makreshi i	153
	7	Strazhë	382
	8	Stanishor	534
			<b>6972</b>



	Qendra po	Rrethina	Nr.i popull.
<b>2</b>	<b>Pograxha</b>		<b>2100</b>
	1	Llovca	220
	2	Kokaj	40
	3	Bilinica	480
	4	Sllubica	117
	5	Stublina	160
	6	Uglari	2200
			<b>5317</b>

	Qendra po	Rrethina	Nr.i popull.
<b>3</b>	<b>Mireshti</b>		<b>3760</b>
	1	Bukovik	130
	2	Capar	204
	3	V.e Kmeto	430
			<b>4524</b>

	Qendra po	Rrethina	Nr.i popull.
<b>5</b>	<b>Bresalci</b>		<b>3250</b>
	1	Ponesh	1380
	2	Parallovë	302
	3	V.e Zhego	1070
	4	Zhegoc	163
	5	K.Pole	363
	6	Gadish	510
	7	Sllakoc i E	429
	8	Sllakoc i P	112
	9	Koretishtë	1070
			<b>8649</b>

### Sjellja e natyrës në qendër të qytetit!

Për ta përmirësuar klimën lokale në Gjilan, dhe për ta lidhur pjesën e brendshme të qytetit me fshatrat përreth, janë propozuar korridore të gjelbra përmes qytetit. Kjo është e mundur e zbatueshme, sepse korridoret komunikojnë me lumenjtë që rrjedhin përmes zonës urbane. Në këto raste, këto zgjidhje do të shërbejnë gjithashtu për qëllim të mbrojtjes nga ndotja e ujit të lumenjve.



Mbrojtja e trashëgimisë natyrore!

Malet dhe bjeshkët janë shpallur "zona e mbrojtur pyjore". Këto pjesë të komunës janë zona parësore për mbrojtjen e natyrës dhe ripyllëzim. Lumenjtë që kalojnë përgjatë komunës kanë të definuar zonat mbrojtëse të tyre.

### Mundësia e hyrjes në tërë komunën!


Rrugët magjistrale dhe rajonale kalojnë përmes zonave më të dendura banuese të komunës, dhe formojnë shtyllën kurrizore të sistemit rrugorë. Të gjitha qendrat dytësore, përveç Pogradjës, janë të lidhura me këtë sistem kryesorë. Rruga lokale që kalon përgjatë luginës së Moravës, ka përfituar prioritet të lartë. Për ta përmirësuar rrjedhën e trafikut përreth Gjilanit dhe për ta ndihmuar brendinë e qytetit nga trafiku, është propozuar një rrugë unazore përreth qytetit.

Një rrejt i zhvilluar i rrugëve dhe transportit publik do ta rris mundësinë e lëvizjes së lirë të banorëve dhe për ti ndihmuar fshatrat dhe për ta ngritur linjën vepruese për institucione shoqërore, siç janë shkollat dhe kujdesi shëndetësorë. Sistemi kryesor rrugor duhet të plotësohet me rrjetin e rrugëve lokale.

Për ta thyer izolimin e Gjilanit nga rrjeti i hekurudhave, është propozuar një linjë e re përgjatë rrafshit të Anamoravës. Për ta maksimizuar mundësin e hyrjes në hekurudhë, stacioni në Gjilan do të jetë sa më afër me qendrën. Për ti minimizuar konfliktet ndërmjet hekurudhës dhe tokës së përdorshme, dhe për ta minimizuar shqetësimin nga zhurma e pashmangshme, është propozuar një lidhje e hekurudhave dhe rrugëve ekzistuese.

**hapsirë pyjore e mbrojtur**  
 forest protection area  
**hapsirë prioritare për bujqësi**  
 priority area for agriculture  
**lum/rrijedhë me hapsirë e mbrojtur**  
 river / stream with protection area  
**qendra komunale**  
 municipal centre  
**qendra e qytetit**  
 city centre  
**hapsirë banuese / e përzier**  
 residential / mixed area  
**hapsirë industriale**  
 industrial area  
**korridorori i gjelbër**  
 green corridor  
**qendra sekondare**  
 secondary centre  
**periferia**  
 suburb  
**rrugë magjistrale**  
 magistral road  
**rrugë rajonale**  
 regional road  
**rrugë lokale**  
 local road  
**'Unaza Policentrike'**  
 'Municipal ringroad'  
**rruga qarkore e Gjilanit**  
 Gjilan ring road  
**hekurudha**  
 railway  
**stacioni hekurudhor**  
 railway station  
**stacioni i autobusëve**  
 Bus station

**Kuvendi Komunal Gjilan**  
 Municipal Assembly Gjilan  
**Plani zhvillimor komunal i Gjilanit**  
 Municipal development plan of Gjilan  
**Skenari i zgjedhur-Modeli i zhvillimit hapsinor**  
 Preferred Scenario-Spatial Development Model  
 14.04.2008  
 Përpjesa:  
 Scale:  
 0 5 km  
**Plan 9**  
 Plan 9  
**DREJTORIA PER URBANIZEM, RINDERTIM DHE AMBIENT**  
 THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT  
**TECH**  
**IWM**  
**planungsgruppe 4**



**Demografia dhe Qëshitet Sociale**

- Kontrolli i migrimeve të popullsisë në Qendra Sekondare (QS)
- Ndalohej imigrimi i popullsisë në qendrat komunale (Gjilan)
- Ofrimi i shërbimeve administrative, institucioneve sportive dhe rekreative si dhe infrastrukturës sociale në QS.

**Zhvillimi ekonomik**

- Ruajtja e tokës bujqësore dhe favorizimi i bujqësisë duke i koncentruar ndërtimet në Gjilan dhe qendra sekondare
- Shpërndarja më efiçente e zhvillimeve ekonomike
- Ndarja e përgjegjësisë edhe në QS

**Infrastruktura Teknike**

- Unaza Policentrike lidhe edhe vendbanimet edhe më të largëta mes vedit, të cilat pastaj përmes QS-ve kanë lidhje direkte me qendrën komunale
- Ofrimi më i lehtë dhe i lirë i infrastrukturës teknike si qendra shpërndarëse.

**Mjedisi dhe shfrytëzimi i tokës**

- Shfrytëzimi më racional i tokës dhe hapësirës
- Ndajja e zhvillimeve të pakontrolluara
- Mbrojtja e lumenjëve dhe ujërave nëntokësorë
- Mundësia më e lehtë e menaxhimit me impiante dhe mbledhje të mbeturinave
- Shfrytëzimi racional i resurseve nëntokësore
- Ripyllizimi





### 3.2.1 Zhvillimi ekonomike, regjenerimi, rekreacioni, tregtia

#### Zhvillimi ekonomik i rrafshit

Fusha pjellore e Anamoravës është shpallur zonë parësore për bujqësi. Kjo zonë do ta përkrah bujqësinë dhe zhvillimin ekonomik nëpër fshatra, por gjithashtu dhe ruajtjen e peizazhit kulturor të rrafshit të Anamoravës. Të gjitha zhvillimet e fshatrave janë të drejtuara në këto zona. Kjo gjithashtu do ta lehtësoj "Zonën e Mbrojtur Pyjore" nga presioni i zhvillimit ndërtimor.

#### Zhvillimi rural

Ekzistojnë dy objektiva kryesore për zhvillimin rural të komunës. Nga një anë natyra e cenueshme dhe e vetme duhet të ruhet për gjeneratat e ardhshme. Në anën tjetër ekziston një fshat vital i jetesës për ekonominë lokale të Gjiçanit. Për ti ndeshur këtë dy objektiva, zona rurale e komunës është e ndarë në dy zona: zona malore dhe zona e rrafshët.

Zona malore kryesisht e përfshin malin e pyllëzuar dhe majat e bjeshkës në komunë. Zona malore është shpallur zonë me prioritet për mbrojtjen e natyrës, ripyllëzimin dhe rikrijimin.

Pjesët tjera të komunës, kryesisht rrafshi i Anamoravës dhe anët e tij në luginë, janë shpallur si zona fushore. Qëllimi është mbrojtja e sektorit të rëndësishëm të bujqësisë dhe përforcimi i zhvillimit ekonomik të fshatrave, por gjithashtu edhe mirëmbajtja e peizazhit kulturor në rrafshina, duke e liruar zonën malore nga shtypja e zhvillimit.

Zona e rrafshinës është shpallur si zonë me prioritet për zhvillim ekonomik dhe bujqësorë. Qendrat dytësore e furnizojnë zonën e rrafshinës me shërbime publike dhe private siç janë edukimi, qendrat shëndetësore dhe shitjet me pakicë. Industria, tregtia dhe aktivitetet tjera tregtare jashtë qytetit të Gjiçanit duhet të përqendrohen në qendrat dytësore.



## Zhvillimi i Bujqësisë dhe Blegtorisë

Toka ndërmjet fshatrave do të përdoret kryesisht për bujqësi. Si prioritet, janë paraparë bujqësia nga toka e lëruar, dhe rritja e kafshëve shtëpiake, por gjithashtu edhe mënyra tjera të bujqësisë të cilat ndihmojnë në ruajtjen e peizazhit kulturor në rrafshinë, p.sh. toka e kullotave dhe pemëtaria. Përdorime tjera të tokës janë paraparë vetëm në raste të veçanta.




Fig.40: Zonimi i zhvillimit të bujqësisë dhe blegtorisë.



Komuna është ndarë në 6 zona zhvillimore dhe atë:

**Zona 1 – Rrafshi i Moravës, në të cilat janë paraparë zhvillimet e**

- Fermave, lopët qumështore
- Fermave, trashja e viçave,
- Fermave, bojlerë,
- Bletaria.

**Zona 2– Gryka e Karadakut, e cila është e përshtatshme për**

- Përpunim të qumështit,
- Ferma, lopët qumështore,
- Ferma, trashja e viçave
- Ferma, bojlerë,
- Bletaria,
- Pika grumbulluese të qumështit,
- Ferma dhensh dhe dhish.

**Zona 3– Zona e Bresalcit, në të cilën parashihen**

- Fermat, trashja e viçave,
- Fermat, pula vojse,
- Bletaria,
- Pika grumbulluese të qumështit.
- Ferma dhensh dhe dhish.

**Zona 4– Zona e Pogragjës, e cila është e përshtatshme për**

- Ferma, Lopët qumështore,
- Ferma, trashja e viçave,
- Ferma, pula vojse
- Bletaria,
- Pika grumbulluese të qumështit,
- Ferma dhensh dhe dhish.

**Zona 5– Zona e Përlepticës, në të cilat janë paraparë zhvillimet e**

- Përpunimit të qumështit,
- Fermave, Lopët qumështore,
- Fermave, trashja e viçave,
- Fermave, pula vojse,
- Bletaria,
- Pika grumbulluese të qumështit,
- Fermave dhensh dhe dhish.

**Zona 6– Zona e Cërnicës, në të cilën parashihen:**

- Ferma, Lopët qumështore,
- Ferma, trashja e viçave,
- Fermat, pula vojse,
- Bletaria,
- Pika grumbulluese të qumështit,
- Ferma dhensh dhe dhish.

**Rekreacioni dhe turizmi**

Zonat për rekreacion janë të rëndësishme për shumë arsye. Jo vetëm që banorët e Gjilanit kanë nevojë për rekreacion, por edhe turizmi natyror në të ardhmen do të zhvillohet në një degë të rëndësishme ekonomike. Rekreacioni dhe turizmi natyror janë të mundshëm në pjesët e mëdha të zonave malore. Dy zona, megjithatë janë identifikuar me rëndësi të veçanet dhe janë propozuar që të zhvillohen në qendra për turizëm dhe rekreacion: burimi i ujit mineral afër Dobërçanit dhe një liqe i ri artificial afër Pogragjës.

Burimi i ujit mineral në Dobërçan është një atraksion për veten e saj. Lokacioni kyçet lehtë nga rruga M25-3, dhe do të jetë pika fillestare për ti ngre turistët.

Ekzistojnë pika të ndryshme të interesit në dhe përreth Pogragjës. Gërmadhat e kështjellës mund ti tërheqin turistët e interesuar të kulturës, ose ajo mund të përbëj pikën përfundimtare të gjurmëve. Një qendër vizitorësh në fshat mund të jetë pika fillestare e gjurmëve të tilla të ndryshme. Qendra e zonës rekreative e Pogragjës mundet me qenë



liqeni artificial i ri. Liqeni mund ta furnizoj me ujë të pijshëm për komunën dhe mund të përdoret për peshkim.








Fig.41: Zonat e zhvillimit ekonomik dhe turistik





**Oendra-Gjianni**  
 Zonat e zhvillimit ekonomik dhe bujqësorë  
 Qendrat turistike dhe kultur.  
 Zonat e interesit turistik  
 Tokat Bujqësore  
 Zona e lirë doganore

**Zonat e zhvillimit të Bujqësisë**

**Zona 1- Rrahzi / Moravës,**

- Ferma bujqë kombëtare
- Ferma, kishë e vepave
- Bikëshat

**Zona 2- Gryfa e Korandaur,**

- Ferma bujqë kombëtare
- Ferma, kishë e vepave
- Bikëshat

**Zona 3- Zona e Drenasit,**

- Ferma bujqë kombëtare
- Ferma, kishë e vepave
- Bikëshat

**Zona 4- Zona e Pogradit,**

- Ferma bujqë kombëtare
- Ferma, kishë e vepave
- Bikëshat

**Zona 5- Zona e Përfaqës,**

- Procesore të qumështit
- Ferma bujqë kombëtare
- Ferma, kishë e vepave
- Bikëshat

**Zona 6- Zona e Çerçedës,**

- Ferma bujqë kombëtare
- Ferma, kishë e vepave
- Bikëshat

**Kuvendi Komunal Gjiann**  
 Municipal Assembly Gjiann

Planimi zhvillimor komunal i Gjiannit  
 Municipal development plan of Gjiann

Zhvillimi Ekonomik  
 Economics development

14.04.2008


Plan 10  
 Plan 10

Perpjesi: 1:5000  
 Scale: 1:5000

0 1 2 3 4 5 km

DIREKTORI PËR URBANIZIM, INZHENERI DHE AMBIENT  
 THE GOVERNMENT OF URBANIZATION, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT

planungsgruppe 4







### 3.2.2 Infrastruktura – komunikimet

#### Trafiku dhe transporti

Rrjeti i rrugëve magjistrale dhe rajonale formojnë shtyllën kurrizore të sistemit të transportit rrugor në komunë. Qyteti i Gjilanit është i rrethuar nga rruga unazore. Rrugët përgjatë M25-2 dhe M25-3 janë të vendosura në rrugën unazore. Për shkarkim vendbanimeve përgjatë M25-3 në drejtim të Ferizajt, një rrugë e re edhe më në veri është propozuar. Rruga rajonale R212 është zgjeruar deri në kufi me Maqedoninë.

Veç rrjetit të rrugëve magjistrale dhe rajonale, rrugës lokale që kalon përgjatë luginës së Moravës, që e lidhë Malishevën, Pogradjën dhe Uglarën, i është dhënë prioritet i lartë. Do të jetë e mundur që rruga të mbahet e hapur nëpër të gjitha motet gjatë gjithë vitit. Për përmirësimin e lidhjes së kësaj pjese të Gjilanit dhe Preshevës e Bujanocit në Serbi, dy kalime malore të vogla janë propozuar për përmirësim dhe asfaltim.

Linja hekurudhore është propozuar që të kalojë përgjatë pjesës juglindore të komunës, në jug të rrugës M25-3. Është e vështirë të parashihet se në çfarë kohe hekurudha mund të ndërtohet. Detyra kryesore e këtij plani është që ta sigurojë një korridor, që të bëhen të mundshme ndërtimet e mëvonshme.

#### Transporti dhe mobiliteti

Për pjesëmarrje në jetën shoqërore dhe ekonomike mund të thuhet se mobiliteti është kushti kryesorë për të gjithë njerëzit.

Ky mobilitet duhet të planifikohet në atë mënyrë që të minimizojë ndikimet negative në ambient në njërën anë, ndërsa nga ana tjetër duhet ta risë qasshmërinë e qytetarëve në destinacione të dëshiruara, duke ndikuar pozitivisht edhe në sigurinë në trafik dhe kualitetin e jetës.

Stacioni kryesor i hekurudhës për komunën do të vendoset në qytetin e Gjilanit. Për ta ndihmuar përdorimin e transportit publik, për ta bërë hekurudhën më profitabile dhe për ta ngritur mundësinë e qasjes në pjesët tjera të komunës, janë propozuar stacione tjera në Doberqan dhe Partesh. Ky Stacion Hekurudhorë ka lidhje direkte edhe me Stacionin e Ri të Autobusëve dhe me atë lokalë duke krijuar kështu një Qendër Mobiliteti për qytetin e Gjilanit. Me këtë ndjeshëm përmirësohet qasja



dhe mundësinë e lëvizshmërisë së qytetarëve në Komunë dhe jashtë sajë.

Veprimet e nevojshme për përmirësimin e mobilitetit:

- Rregullimi i Transportit Publik dhe masave të sigurisë në komunikacion,
- Transporti i Ri Publik ( Autobus/Tren ),
- Lidhje më të mira ndër rajonale,
- Ndërtimi dhe zgjerimi i rrugëve në zonat rurale,
- Shtigjet për këmbësorë dhe çiklistë,
- Rregullimi i udhëkryqeve.

Prioritetet strategjike janë:

- Përmirësimi i kualitetit fizik dhe zgjerimi i rrjetit rrugorë në drejtim të Maqedonisë dhe Serbisë.  
E para, zgjerimi i rrugës në drejtim të Preshevës dhe së dyti rruga e re për në Kumanovë përmes Zhegrës do ta forconte pozitën qendrore të Gjilanit si pikë takimi i " Trekëndëshit të Dyfishtë". Këto rrugë do ta lidhnin Gjilanin dhe Kosovën me Maqedoninë dhe me të edhe me korridoret e planifikuara 10 dhe 8.
- Lidhja e Qendrave Sekondare ndërmjet veti si dhe lidhja e tyre me fshatrat përreth tyre. Zhvillimi policentrik pasqyrohet në këtë mënyrë edhe në raport me Transportin Publik.
- Rritja e sigurisë në trafik.

## Infrastruktura teknike

### Ujërat dhe kanalizimi

Zhvillimet si në vijim duhet të supozohen:

- Shtimi i popullsisë totale në Komunë,
- Rritja e konsumimit të ujërave industriale si pasojë e rigjallërimit të ekonomisë,
- Rritje e konsumimit të ujit për banorë për një ditë si standard gjeneral të pajisjeve sanitare të ekonomive familjare do të përmirësohet.

Në tërësi, nevojat për ujë të pijshëm do të rriten në vitet e ardhshme. Pajisjet në fabrikën e përpunimit të ujit në pendën e Përlepnicës janë



rinovuar plotësisht në kohën e fundit. Ndërsa akumulacioni në Livoq aktualisht nuk përdoret për ujë të pijes për Gjiçanin. Përderisa liqenëi i Përlepticës dhe dy burimet tjera Guri i Hoxhës dhe Baja janë duke e furnizuar pjesën më të madhe të Gjiçanit me ujë të pijes. Një akumulacion tjetër është propozuar të ndërtohet në rrjedhën e lumit në fshatin Pogragjë. Prioritetet kryesore mund të jenë:

- Riparimi dhe përmirësimi i sistemi ekzistues të furnizimit të ujit,
- Zgjerimi i sistemit të furnizimit të ujit në të gjitha pjesët e komunës,
- Ndërtimi i rezervarit të dytë të liqenëit në Pogragjë,
- Përkrahje e përdorimit sa më efektiv të ujit,

Me shpresë për gjetjen e sasisë së nevojshme të ujit, në muajin Prill të vitit 2006, kanë filluar hulumtimet gjeofizike të ujërave të pijshëm për komunën e Gjiçanit dhe Ferizajt. Ky projekt është financuar nga Qeveria Zvicerane (7,5 milion euro) dhe implementimi i është besuar kompanisë EBP (Ernst Basler+Partner Ltd).

Hulumtimet ishin të drejtuara kryesisht në lokacionet dhe karakterizimet e sakta të vendeve të puseve, në hapësirat e identifikuar më parë në Studimin e Fizibilitetit të ZhRUKJ (Elektrowatt).

Hulumtimet gjeofizike me mjete bashkëkohore, në kuadër të projektit për zhvillimin e resurseve ujore në Kosovën Juglindore do të bëjnë identifikimin e ujërave nëntokësore që do të mund të shfrytëzoheshin për pije, në mënyrë që të shtohen kapacitetet e ujërave në komunat Gjiçan dhe Ferizaj, ku tani ka mungesë të ndjeshme të ujit.

Këto hulumtime përfunduan në Janar të vitit 2007, ndërsa raporti është bërë me 28 shkurt 2007. Në vazhdim po i shkëpusim konkluzionet dhe rekomandimet nga ky raport.

Sipas hulumtimeve të kryera, rekomandohet të ndërtohen 6 puse me specifikacionet në vijim:

Emri	X (UTM)	Y (UTM)	Diametri i Vrimës [mm]	Diametri i Gypit DN (Johnson Filter)	Thellësia e Parafert [m]	Q <sub>rec</sub> [l/s]	z [m]	R [m] Q <sub>rec</sub>
Pusi 1	539547	4695740	700	450	40	14.5	5.75	138
Pusi 2	539514	4695572	700	450	40	14.5	5.9	137
Pusi 3	539119	4695574	700	450	38	17	5.4	151
Pusi 4	539257	4695510	700	450	38	16	5.0	140
Pusi 5	539411	4695168	700	450	30	11	4.0	123
Pusi 6	539470	4695353	700	450	33	9.5	5.1	121

Puset e propozuara në Gjilan




Fig.42: Puset e propozuara në Gjilan

Pikat e kuqe tregojnë puset e propozuara 1-6. Pikat e zeza janë puset që janë aktualisht në përdorim nga fabrika RC Cola (RC) dhe Fabrika e Mishit.

Shkalla e propozuar e pompimit përfshin rreth 50% të shkallës maksimale së llogaritur të pompimit, kështu që zvogëlohet ulja dhe minimizohet bashkëveprimi ndërmjet puseve të ndryshëm. Vendosija e dy puseve në anën e djathtë të Moravës ka edhe një përparmi më tepër, pasi që uji nëntokësor me mineralizim më të lartë nga ana e majtë e Moravës (që mund të përmbaj një sasi më të lartë të manganit dhe hekurit) do të përzihet. Figura në vijim tregon lokacionin e puseve të propozuara,



piezometrave ekzistues dhe puseve që aktualisht janë në përdorim në këtë hapësirë.

Me interes të veçantë është pusi që përdoret nga Fabrika e Mishit, sipas bisedave gojore merret një sasi rreth 15 l/s (12-15 h/ditë; prej të Hënës deri të Premten ), i cili ndodhet në pjesën juglindore të hapësirës së puseve. Në Nëntor 2006 janë mbajtur bisedime me përfaqësuesit e Fabrikës së Mishit, AKM dhe Hidromoraves lidhur me mundësinë e kyçje të fabrikës në rrjetin e ujësjellësit të qytetit. Fabrika e mishit akoma e ka statusin e ndërmarjes shoqërore dhe tani ndodhet në procesin e privatizimit. Përfaqësuesit e NSh. nuk ishin në pozicion që të komentojnë një propozim të tillë. Bisedimet mund të rifillojnë vetëm atëherë kur fabrika të privatizohet. Fabrika nuk ka akoma leje ujore për nxjerrjen e ujit nëntokësor.

Përafërsisht 600m në veri nga fusha e puseve, janë katër puse që përdoren nga fabrika RC Cola. Fabrika nuk ka leje ujore për asnjërin nga puset. Për arsye të rritjes së vazhdueshme të kërkesave për ujë, tani shumë vonë është ndërtuar edhe pusi i katërt. Në çfarë mase, nxjerrja afatgjate e ujit nëntokësor do të ndikoj në sasinë e ujit nëntokësor në fushën e puseve për ujë të pijshëm, aktualisht nuk është e njohur. Kontura e nivelit të ujërave nëntokësor tregon të paktën se edhe një sasi e ujit nëntokësor rrjedh nga fusha e puseve të RC Coles në drejtim të aquiferit aluvial të Moravës. Prandaj një ndikim i tillë nuk mund të përjashtohet.

Siç është ekspozuar më lartë, konsumimi i ujit është pritur të rritet dukshëm. E njëjta gjë aplikohet për ujërat e zeza të cilat do të prodhohen në të ardhmen.

Në lidhje me shtimin e nevojave, shkatërrimi i pjesshëm i gjendjes së rrjetit të kanalizimit, dhe fakti se Gjilani nuk ka ndonjë pajisje për trajtimin e ujërave të zeza. Është evidente se sistemi i menaxhimit të ujërave të zeza duhet të riparohet.

Me zgjerimin e sistemit të kanalizimit, do të jetë i nevojshëm një menaxhim më gjithëpërfshirës i ujit. Elementi thelbësorë i menaxhimit modern të ujit, është ndarja e mbledhjes së ujërave nga reshjet dhe ujërave të zeza. Ndonëse, ujërat e zeza duhet të mbledhen dhe të trajtohen brenda një sistemi të mbyllur, ujërat nga reshjet duhet të trajtohet në një mënyrë që është e përafërt me ciklin e ujërave natyrore. Kjo e përfshinë mbrojtjen dhe filtrimin e ujërave të shiut brenda zonave



banuese dhe komerciale. Mbrojtja dhe filtrimi i ujerave të shiut e zvogëlon shkarkimin e ujërave të zeza gjatë kohës së rënies, dhe ndihmon në reduktimin e investimeve të nevojshme.

Një impiant i ri i ujërave të zeza është propozuar në komunë, në periferi të qytetit të Gjiçanit. Duhet të bëhen shembuj më detaj për ta vendosur lokacion e saktë.

### **Menaxhimi i mbeturinave**

Nëse do të ishte ndaluar ndotja e mjedisit përmes mbeturinave, ose nëse hedhja e mbeturinave (vendosja ilegale dhe e paautorizuar e mbeturinave) do të vazhdon të mbështetet shumë mirë në sistemin funksional të mbledhjes së mbeturinave. Mbledhja e mbeturinave do të zgjerohet në të gjitha pjesët e komunës. Ky proces është gjithashtu i rëndësishëm për ngritjen e vetëdijesimit të popullsisë në lidhje me rrezikun nga hedhja e mbeturinave dhe ta inkurajoj kontrollin shoqërorë.

Momentalisht, mbeturinat janë grumbulluar në pjesë të mëdha të Kosovës jugore dhe janë transportuar në deponon rajonale në Gjiçan, ku mbeturinat ruhen pa asnjë trajtim të mëtutjeshëm. Në të ardhmen, kur të rregullohet menaxhimi i mbeturinave nga rregulloret e BE-së, mbeturinat do të kallen dhe vetëm hiri do të depozitohet. Vetëm disa deponi të tilla për djegien e mbeturinave do të jenë të nevojshme në tërë Kosovën, dhe me sa duket ato do të ndërtohen në kombinim me deponit rajonale të sotme. Një zgjerim i deponisë ekzistuese të Gjiçanit megjithatë mund të pritet.

Prioriteti i parë për menaxhimin e mbeturinave si pasoj duhet që shërbimet e grumbullimit të mbeturinave të zgjerohen në tërë komunën dhe të pastrohen pjesët e depozitimit ilegal të mbeturinave. Në hapin e dytë, pajisjet dhe metodat e deponive ekzistuese duhet të adoptohen me standardet e BE.





## Energjia elektrike

Reduktimet shpeshta te energjisë elektrike janë dukuri e përditshme dhe ne çdo sezone ne Kosovë si edhe në Gjiçan. Problemi kryesor i Gjiçanit si dhe i tërë Kosovës është furnizimi kualitativ dhe kuantitativ me energji elektrike.

Problemi kryesorë në këtë komunë është gjendja e keqe e rrjetit për furnizim me energji elektrike. Shumë ekonomi familjare furnizohen nga linjat mbitokësore, disa prej tyre në gjendje të shkatërruar. Përmirësimi i këtyre linjave duhet të ketë prioritet. Mundësia e eksploatimit të burimeve të energjisë elektrike alternative brenda komunës gjithashtu duhet të provohet.

Humbjet elektrike janë dukuri që përfshinë çdo sistem elektroenergjetik. Sidoqoftë humbjet e energjisë për Gjiçan dhe rrethinë të llogaritura si humbje teknike evidentohen me një përqindje prej (10.2-10.6) % sipas shënimeve në distribucion duke mos i marr parasysh humbjet komerciale që paraqet një dukuri negative në menaxhimin e KEK.

Fytet e ngushta, të furnizimit me energji elektrike, janë prezentë pothuajse ne tërë SEE të Kosovës, pra edhe në komunën e Gjiçanit.

Furnizimi kualitativ dhe kuantitativ i Anamoravës me energji Elektrike do të sigurohet atëherë kur të ndërtohet edhe një trafostacion i ri, TS 110kV së bashku me Largpërçuesin e dyfishtë 110kV (në gjatësi 2x0.8 km) dhe kyçje e linjave kabllobike 10(20)kV në rrjetin lokal.

Linjat 20kV, nëpër qytet duhet të jenë kabllore, ndërsa ato për vendbanimet rurale , ajrore.

Shndërrimi i sistemit 110/35/10kV në sistemin 110/20kV, si dhe rikonstruimi i rrjetit 10 kV ne atë 20kV në tërë Kosovën pra edhe për komunën e Gjiçanit, paraqet investim kapital në energjetikë. Kështu do te eliminohen fytet e ngushta, do te rritet aftësia bartëse e linjave dhe do te mundësohet furnizimi kuantitativ dhe kualitativ me energji elektrike.



Fig.43: Trafostacionet e reja ne Kosove



Burimi: KEK

TS e ri 110/20(10) kV


\$ TS\_2002-2005

\$ TS\_2006-2010

\$ TS\_2011-2015



Fig.44: Rëniet e Tensionit



Burimi: KEK

#### Rëniet e tensionit (%)

2000 - # 0-5

2005 - # 5-10

2010 - # 10-15

2015 - # 15-30




KEK-u ka paraparë ndërtimin e TS 110/20 kV, Gjiçani(GL V), që do të ndërtohet në zonën të tregu i Automjeteve dhe TS 110/20 kV, Gjiçani(GL-IV), respektivisht do të shndërrohet TS 35/10 kV në TS 110/20kV, zona afër varrezave.

Shfrytëzimi i resurseve ujore të Komunës për prodhimin e energjisë elektrike është imperativ i kohës. Mu për këtë është një mundësi e ndërtimit të një minihidrocentrali në Pogragjë. Për këtë duhet paraprakisht të bëhet një studim i fizibilitetit për krijimin e një liqeni akumulues, ku pos prodhimit të energjisë do të mund të shfrytëzohej edhe për zhvillim të zonave rekreative të zhvillimit rural.




## Telekomunikacioni

Shumica e pjesëve të komunës janë të mbuluara me rrejt të telefonisë mobile. Nuk kanë qasje në telefoni fikse të gjitha pjesët e komunës. Prioritet duhet tu jepet të gjithë banorëve që të kenë qasje edhe në telefoninë me kablo edhe atë mobile.



- rrugë magjistrale me vendkalim kufitar  
magistral road with border crossing
- rrugë rajonale me vendkalim kufitar  
regional road with border crossing
- rrugë e re me prioritet të lartë  
new road with high priority
- rrugë lokale  
local road
- "linza komunale"  
Municipal ring-road
- stacioni i autobusëve  
bus station
- vijë hekurudhore me stacion  
railway with station
- Heksaterre rrokry  
Alternative railway
- depozitë / qendër reciklimi  
landfill / recycling centre
- mbledhës i ujit të pijshëm  
Drinking water plant
- Impianet komunale  
Municipal plant
- impianet rajonale me harrsërin mjedhësore fshat / komunale  
Regional sewage plant with attachment area
- hidrocentralet  
hydroelectric power plant
- vijat e tensionit elektrik  
35 kV/110 kV/220 kV/400 kV  
electricity lines
- Stacionet e tensionit  
35 kV/110 kV/220 kV/400 kV  
transformer stations  
SS 35-10SS 110-10SS 110-35
- GL V (TS110/10/20) kV
- GL IV (TS110/10/20) kV
- Kanalizimi me fije optike  
në realizim e sipër



**Kuvendi Komunal Gjilan**  
Municipal Assembly Gjiçan

**Plani zhvillimor komunal i Gjiçanit**  
Municipal development plan of Gjiçan

**Plani trafikut dhe infrastrukturës teknike**  
Traffic and Technical Infrastructure Plan

14.04.2008

Përpjesët:  
Plan 11  
Scale:  
0 5 km

**planingsgruppe 4**

DIREKTORI PËR PLANIMIN, INJENIERI DHE ARHITEKTURËN  
E QYLLIMIT DHE BASHKËPUNIMIN PËR PLANIMIN DHE ARHITEKTURËN



### 3.2.3 Popullsia, banimi, vendbanimet, çështjet sociale, trashëgimia kulturore dhe natyrore

#### Popullsia

Gjatë periudhës së vitit 2002 deri 2020 shtimi i popullsisë për komunën e Gjilanit do të jetë brenda një diapazoni prej 17.000 deri në 22.000 banor. Për qytetin e Gjilanit<sup>9</sup> nga 9.500 deri 12.000, për fshatra prej 7.000 deri 9.500 varësisht mbi supozimet relative të migrimit

Tab. 43: Zhvillimi i popullsisë së Gjilanit për vitin 2002-2020

Zona	2002 baza e të dhënave komunale	2015 vetëm shtimi natyral	2020 vetëm shtimi natyral	Migrimi shtesë i banorëve	2020 migrimi -100 p/a	Banorët shtesë - 100 p/a	2020 migrimi -250 p/a	Banorët shtesë - 250 p/a
Komuna	139.558	156.951	161.395	21.837	159.396	19.838	156.430	16.872
Qyteti	79.000	88.846	91.361	12.361	90.230	11.230	88.551	9.551
Fshati	60.558	68.105	70.034	9.476	69.166	8.608	67.879	7.321

**Vërejte:** llogaritjet vetëm për komunën. shpërndarja e banorëve ndërmjet qytetit dhe komunës në shkallë prej 79.000 deri 139.558 banor si në vitin 2002

**Burimi:** Baza e të dhënave të komunës së Gjilanit për vitin 2005, Statistikat Jetësore të vitit 2003 (SOK 2004) / llogaritjet e IWU –së

Sipas llogaritjeve alternative, popullsia do të shtohet më shpejt, kështu numri i banorëve në komunë në vitin 2015 do të jetë 165.780 (respektivisht 180.073 në vitin 2020). Megjithatë, duke filluar me numrin e vogël të banorëve në vitin 2002 (133.724) numri i madh i banorëve në të ardhmen është për faktin se është përdorur një faktor relativ dhe konstant i shtimit prej 1,667%, p.sh. një rritje vjetore prej 16,7 banorësh për 1.000 banorë. Kjo e tejkalon shkallën e shtimit prej 13 për 1.000 banor, të dhëna nga MMPH-ja për Kosovën në tërësi (MMPH 2004, p.12), dhe kjo nuk i përgjigjet shkallës aktuale të shtimit natyral në Gjilan për vit, (2002 – 2004) të cilat janë madje më të vogla (11,5; 9,0; 9,8 për 1.000 banorë , respektivisht 1,146%; 0,897%; 0,982% i të gjithë banorëve të komunës në këto vite ).

<sup>9</sup> Distribucioni i banorëve në mes të qytetit dhe komunës në shkallën prej 79000 në 139.558 banorë si në 2002





Tab. 44: Zhvillimi i Popullsisë në Gjiçan për vitet 2002 – 2020,  
Llogaritjet e shtimit natyral mbi një konstantë faktori i shtimit natyral 1.667%

Viti	Numri i banorëve
2002	133.724
2005	140.523
2010	152.630
2015	165.780
2020	180.073


**Burimi** : Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim; Zyra Rajonale për Statistikë-Gjiçan; Përpunoi: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-Gjiçan

Për më shumë, mund të theksohet se, të dyja llogaritjet japin një rrezik të fortë të mbivlerësimit, si ulje e shkallës së tanishme të shtimit natyral – i pavarur nga niveli i tij i saktë i tanishëm është më i përshtatshmi për të ardhmen.

Përderisa migrimi është shqetësues, ai gjithashtu duhet të respektohet, se prognozatat e popullsisë të fituara nga migrimi nuk mund të "llogariten" në një arsye të duhur, edhe sikur të ekzistonin të dhënat detale nga e kaluara. Në kohën e tashme, baza e të dhënave të gatshme për Gjiçanin është mjaft e shpërndarë. Kështu, vetëm me supozime të ndryshme mbi migrimin mund të tregonin kufirin e një korridorit të zhvillimit të mundshëm. Po që se ekonomia në Kosovë, dhe veçanërisht në Gjiçan do të zhvillohet mirë, balancimi i migrimit mund të mbërrihet. Një zhvillim i tillë, nga i gjithë, mund të pritët vetëm në qendrën ekonomike të komunës, në qytetin e Gjiçanit. Investimet industriale të jashtëzakonshme e tërheqin fuqinë punëtore shtesë për komunën e Gjiçanit. Megjithatë, një zhvillim i tillë nuk është shumë i mundshëm, por sidoqoftë kjo nuk mund të përjashtohet. Në anën tjetër, mund të pritët që një marrëveshje ndërkombëtare për zgjedhjen e statusit të Kosovës do të ndihmonte migrim të jashtëm të organizuar- punëtorë sezonal, në shtetet anëtare të BE.

Për komunën si tërësi- duke i marrë në konsideratë shifrat mbi migrimin e tërë jetës në Kosovë- migrimi jashtë vendit është perspektiva më e mundshme e zhvillimit. Pa ndonjë analizë specifike për këtë problem, mund që e arrijmë në një konstatim se migrimi i jashtëm përafërsisht mund të jetë 100 banor për vit.

Fig.45: Zhvillimi i popullsisë në Gjiçan për vitin 2005 - 2020



Dhënia e vlerësimit të migrimit siç është paraqitur më lartë, popullsia në fund të periudhës nga viti 2005 deri në vitin 2020 do të shtohet në një numër përafërsisht:

- **156.000** banorë, bazuar në një përqindje prej 250 shpërngulje jashtë Gjiçanit në vit ,
- **159.000** banorë, bazuar në një përqindje pre 100 shpërngulje jashtë Gjiçanit në vit ,
- **161.000** banor, nëse migrimi balançohet.

Meqë nuk ka më shumë të dhëna të specifikuar statistike demografike, që e bëjnë dallimin ndërmjet popullsisë në fshatra dhe në qytetin e Gjiçanit, shpërndarja e banorëve ndërmjet qytetit dhe komunës është llogaritur në baza të proporcionit prej 79.000 banorëve në qytet nga 139.558 banor në komunë (baza e të dhënave dhe vlerësimi i Komunës në vitin 2002).



Ne supozojmë se, qyteti i Gjilanit mund të rritet më shpejt sesa fshatrat. Sa Rrita e qytetit, pashmangshme, mund të tërheq banor edhe nga fshatrat. Dimensi i këtij migrimi të brendshëm, megjithatë nuk mund të llogaritet.


Duke u dhënë vlerë të serishëm prognozave të pasigurta, mund të tregohet se:

- Planifikimi Hapësinor përkatës me kërkesat e ardhme mund të organizohet në mënyrë të fuqishme, kështu që mund ti adaptohet lehtë ndryshimeve (më të mëdha ose më të vogla) të kërkuara për tokën ndërtimore,
- Modeli i zhvillimit hapësinor duhet të jetë i tillë që të mund të zbatohet hap pas hapi , dhe në secilin hap të krijoj njësi funksionale,
- Prognozat duhet të rishikohen menjëherë posa të jenë të gatshme të dhënat e sigurta nga regjistrimi i përgjithshëm mbi numrin e tanishëm të banorëve, dhe
- Shifrat e migrimit dhe zhvillimit të fuqisë punëtore, duhet të grumbullohen gjatë viteve, kështu që, më shumë tendenca të vlefshme mund të përfitohen nga to dhe të përdorën për prognoza.

#### Grup moshat

Gjatë viteve, në lidhje me këto prognoza të zhvillimit- shtimit të popullsisë, struktura e popullsisë ndryshon për shkak të shkallës së vogël të lindjes dhe jetëgjatësisë. Në tërësi, shtimi i popullsisë me moshat e vogla për njerëz të rinj, dhe më e madhe për të vjetër. Mosha grupore e fëmijëve më të ri se 15 vjet, do të shkurtohen vetëm në tre tremujorë të numrit aktual të kësaj moshe grupore (38.261 to 29.749) dhe aty mund të jetojnë dy herë më shumë njerëz në Gjilan më të vjetër se 60 sesa që jetojnë sot aty (13.781 to 26.859). Kjo ka pasoja për sistemin e shkollës si dhe për sistemin e shëndetit. Kërkesat relative të shërbimeve duhet të jenë përkatëse me ndryshimin numrit të klientëve potencial.

Fig.46: Grupmoshat në Gjilan 2005 dhe 2020



**Burimi:** Statistikat jetësore të Kosovës 2002 – 2003 (SOK 2004), Llogaritjet nga IWU

### Bazat për vlerësimin e kërkesave për banim në të ardhmen.

Vlerësimi i kërkesave për të ardhmen është i bazuara në këto të dhëna:

Tab. 45: Kërkesat për banim në të ardhmen në Gjilan, bazat e vlerësimit

Artikulli	2002	2020	increase
Numri i banorëve, komunë	139.558		
Zhvillimi nga shtimi natyral		161.395 max	21.837 max
Zhvillimi nga migrimi negativ (-100)		159.396 (-100)	19.838 (-100)
Zhvillimi nga migrimi (-250)		156.430 (-250)	16.872 (-250)
Numri i banorëve, qytet	79.000	91.361 max	12.361 max
Numri i banorëve, fshatra	60.558	70.034 max	9.476 max
Numri i familjeve, komunë	23.723	32.279 max	8.500 max
Numri i familjeve, qytet	14.364	20.302 max	6.000 max
Numri i familjeve, fshatra	9.359	11.672 max	2.300 max
persona/familje, Komunë	5,9	5,0	
persona/familje, Qytet	5,5	4,5	
persona/familje, Fshatra	6,5	6,0	



m <sup>2</sup> /person (Kosova)	18,65 <sup>10</sup>	23	
Mesatarja e të hyrave për familje	E pa njohur	Në rritje	
Numri ekzistues i njësive të banimit	E pa njohur	Në rritje	
Kosto e banimit	E pa njohur	Në rritje	

**Legend**

Të dhënat statistike	
Vlerësimet	
Të dhënat statistike për Kosovën	
Prognozat logaritëse	
Llogaritjet	

Nga të dhënat e mësipërme mbi popullsinë, madhësia e familjes dhe hapësira për banim nga supozimet komplementare janë marrë:

- Indeks i mesatar i sipërfaqes prej 0.8 në zonë të qytetit,
- Indeks i mesatar i sipërfaqes prej 0.4 në zona të fshatrave,
- Një raport mesatar neto / bruto të tokës ndërtimore prej 0.7 (qytete dhe fshatra).

Përfundimisht, numri i njësive për banim, që për momentin janë në ndërtim ose janë të zbrazëta për arsye tjera, janë vlerësuar përafërsisht 5%. Kjo përqindje është nxjerr prej kërkesave të llogaritura në të gjitha vlerësimet

Për shkak të planifikimit urban, nevojën për tokë në qytetin e Gjilanit dhe fshatrave përreth, duhet shqyrtuar ndaras. Pika kritike për shpërndarjen e nevojës për tokë në qytet dhe fshatra është faktor i migrimit ndër komunal (migrimi prej fshatrave në qytet). Sipas ekspertëve lokal, është një trend konstant i migrimit prej fshatrave në qytet. Sasia e migrimit ende nuk është e njohur.

Si pasojë e dallimit zhvillimit ekonomik në mes qytetit dhe fshatrave si dhe struktura e moshës së popullsisë në fshatra, një migrim ndër komunal prej 10% të popullsisë parashikohet. Kjo konsideratë është inkorporuar në llogarinë e shpërndarjes së tokës.


<sup>10</sup> Cf. MMPH / Instituti për planifikim hapësinorë: Plani hapësinorë i Kosovës, Dokument pune, 2005.



Nevoja për tokë ndërtimore në **fshatra** të komunës së Gjilanit deri 2020 pritet të jetë:

- 172 ha, nëse bilanci i migrimit të jashtëm është i njëjlojtë (i.e. migrimi në dhe prej komunës së Gjilanit).
- 163 ha sipas mesatares prej 100 persona migrimi jashtë komunës së Gjilanit për vit, ose
- 150 ha sipas mesatares prej 250 persona migrimi jashtë komunës së Gjilanit për vit.

Fig.47: Nevoja e llogaritur për tokë ndërtimore (fshatrat)




Nevoja totale për tokë ndërtimore në **komunën e Gjilanit** deri më 2020 është:

- 364 ha, nëse bilanci i migrimit të jashtëm është i njëjlojtë (i.e. migrimi në dhe prej komunës së Gjilanit),
- 350 ha sipas mesatares prej 100 persona migrimi jashtë komunës së Gjilanit për vit, ose
- 328 ha sipas mesatares prej 250 persona migrimi jashtë komunës së Gjilanit për vit.



Fig.48: Nevoja e llogaritur për tokë ndërtimore (komuna)



Duhet theksuar se llogaritë e mësipërme bazohen në shtimin aktuale të popullsisë në komunë dhe nga faktorët kritik për nevojat e ardhshme. Si rezultat i ndërrimeve potenciale të modelit socio-demografik, llogaritë duhet përshtatur nevojave për të ardhmen.

### Vendbanimet

Për ta parandaluar një strukturë të banimit të pakontrolluar dhe potencialisht të padëshirueshme, është propozuar një numër i limituar i qendrave dytësore, për ti plotësuar disa nga punët e qytetit të Gjilanit .

Qëllimi i qendrave dytësore është shpërndarja e zhvillimeve në mënyrë shumë të barabartë nëpër tërë komunën. Për më tepër një sistem plotësues i qendrave lokale e lehtëson qasjen më të mirë në shërbimet publike dhe private për qytetarët në pjesët rurale të komunës.

Plani Zhvillimor Komunal e sugjeron një sistem hierarkik me dy nivele:

**Niveli 1 (qendra e komunës )**, është e përbërë nga qyteti i Gjilanit. Qyteti do të zhvillohet sipas objektivave në vijim:

- Gjilani do të jetë fokus i shkallës së lartë të zhvillimit industrial dhe komercial, të cilët mendojnë ti plotësojnë kërkesat e investueseve të cilët vijnë jashtë komunës.
- Qyteti gjithashtu do të funksionoj si qendër e zhvillimit të banimit në komunë. Kjo do të thotë se kërkesat e banimit të cilat rrjedhin si pasojë e migrimit, (brenda komunës ose jashtë komunës) do të ndeshën në qytetin e Gjilanit.
- Sfera e plotë e sektorit privat dhe publik do të sigurohet në qytetin e Gjilanit.



- Sektori i tregtisë me pakicë do të ndihmohet në atë mënyrë që sfera e plotë e prodhimeve me kërkesa afatshkurtër <sup>11</sup> , afatmesëm<sup>12</sup> dhe afatgjatë <sup>13</sup> të jenë të përshtatshme.
- Pajisjet edukative, kulturore, për kohë të lirë dhe shëndetësi së komunës me rëndësi të plotë janë të përqendruara në qytetin e Gjilanit.

Niveli 2 (qendrat dytësore ), përbëhen nga një numër i fshatrave të mëdha në pjesët e ndryshme të komunës, të cilat arrijnë tanimë ti kenë funksionet e nën-qendrave për zonat përkatëse përreth. Ky rol do të përkrahet. Aktualisht, fshatrat Cërnice , Bresalc, Përlepnicë, Dobërqaq, Zhegër, Pogradjë, janë të përshtatshëm që të funksionojnë si qendra dytësore.

Qendrat dytësore do të zhvillohen në atë mënyrë që ti ndeshin objektivat si në vijim:

- Qendrat dytësore duhet të ofrojnë tokë të mjaftueshme për banim, si dhe për industri dhe tregti që i ndeshin kërkesat që rrjedhin nga zonat përkatëse përreth .
- Shërbimet publike bazë siç janë shkollat e mesme, qendrat e shëndetit familjarë dhe zyrat përfaqësuese të administratës komunale duhet të vendosen në qendrat dytësore.
- Shërbimet dhe prodhimet private të kërkesave afatshkurta dhe afatgjate duhet të jenë të përshtatshme .

Fshatrat e mbetura, të cilat nuk janë pjesë e sistemit të qendrës, do të përkrahen për të pasur përdorim të plotë në zhvillimin e potencialit të rrezikuar. Kjo do të thotë se, këtë fshatra të vogla tipike duhet të inkurajohen që të caktojnë tokë të mjaftueshme për banim dhe tregti që ti akomodojmë kërkesat e tokës ndërtimore në banimet e tyre.

---

<sup>11</sup> Shembujt për "Kërkesat afatshkurta": ushqimi, prodhimet kimike, gazetat dhe revistat, librat, malli farmaceutik, etj.

<sup>12</sup> Shembujt për "Kërkesat afatmesme": veshja, mbathja dhe gjërat nga lëkura, pajisjet e sportit dhe pushimit, lodrat etj.

<sup>13</sup> Shembujt për "kërkesat afatgjate": mobilje, tepih, pajisje elektrike, stoli dhe orë, etj.



## Çështjet Sociale

### Edukimi

Edukimi bazik, është i nevojshëm edhe për fuqinë e ardhshme punëtore, nëpunësit civil dhe për nevojat njohjes së kulturës Evropiane.

Planifikimi i pajisjeve të reja për shkolla dhe pajisjet tjera edukative duhet të bazohen në programin, duke i treguar prioritetet e përshtatshme për numrin e banorëve që duhet të shërbehen. Një program i tillë duhet të përpunohet në emër të drejtorisë të Edukimit në komunë.

Vendi i përcaktuar për shkollat e reja dhe pajisjet tjera edukative duhet të planifikohet në kontekst të planit rregullues. Treguesit e parë për lokacionet e duhura në komunë mund të nxirren nga Plani Zhvillimor Hapësinor. Objektiva kryesore është që të silllet edukimi i niveleve të ndryshme sa më afër banorëve. Të gjitha fshatrat duhet të pajisen me shkollat fillore. Shkollat ekzistuese duhet të rinovohen dhe të pajisen sipas numrit të nxënësve. Shkollat e reja të mesme janë paraparë në qendrat dytësore. Edukimi i lartë p.sh. Fakultetet e Universitetit të Prishtinës dhe alternativat private, si dhe trajnimet profesionale do të ofrohen në qytetin e Gjiçanit.

### Kujdesi shëndetësorë

Qendrat familjare për përkujdesje shëndetësore janë duke i formuar bazat për sistemin primar të përkujdesjes shëndetësore. Ata parashohin një rrjet të ambulancave në komunë. Qendrat sekondare për përkujdesje shëndetësore janë siguruar nga spitali rajonal në qytetin e Gjiçanit.

Prioritet primar për sistemin e përkujdesjes shëndetësore është ruajtja e pajisjet ekzistuese, ti rinovoj ndërtesat, ti restauroj pajisjet dhe ti zbatoj standardet e aprovuara për nivelet përkatëse.

Planifikimi i një objekti ndihmës të ri për përkujdes shëndetësorë duhet të bazohet në programin, duke i treguar prioritetet e përshtatshme për numrin e banorëve që duhet të shërbehen. Një program i tillë duhet të përpunohet në emër të drejtorisë të Shëndetësisë në komunë.

Lokacionet e përcaktuara për ambulanca të reja, qendra familjare të shëndetësisë duhet të planifikohen në kontekst të planit rregullues.



Nevojat e para për lokacionin e përshtatshëm në komunë duhet të nxirren nga Plani Zhvillimor Hapësinor. Për të ju dhënë të gjithë banorëve qasje të shpejtë në përkujdes shëndetësor, është qëllimi që të ndërtohet një ambulancë në secilin fshat. Qendrat dytësore do të furnizohen me qendra familjare për përkujdesje shëndetësore.

### **Peizazhi dhe mjedisi**

Territori komunal jashtë zonës urbane të Gjilanit është e ndarë në dy zona; zona e rrafshët dhe ajo malore.

Bujqësia dhe zhvillimet tjera ekonomike janë përqendruar në zonat e rrafshëta. Kjo mund ta kursej zonën malore nga disa shtypje të zhvillimit.

Zona malore është shpallur zonë me prioritet për mbrojtje. Në të ardhmen, duhet parashikuar ripyllëzimi dhe rikrijimi i zonave malore. Komuna duhet ti kufizoj dhënien e lejeve për ndërtim dhe zhvillim në zonat malore.

### **Pyjet dhe pylltaria**

Një pjesë e madhe e zonës malore, është e mbuluar nga malet. Malet luajnë një rolë të rëndësishëm për florën dhe faunën në komunë, si dhe për klimën globale dhe lokale, por gjithashtu kanë ndikim edhe në zhvillimin ekonomik lokal. Druri i prerë nga malet nga banorët lokal përdoret për ndërtim, artizanat tradicionale, përpunimin industrial dhe nxehje. Vetëm disa pjesë të prera të maleve në vitet e fundit janë ripyllëzuar. Për ti riparuar dëmet e shkaktuara, duhet të planifikohet pyllëzim i ri në zonën malore. Për ta siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të pyjeve, prerjet që do të bëhen në të ardhmen duhet ripyllëzimi me druajtë të zakonshëm për zonën.

### **Lumenjtë dhe liqet**

Për ta përmirësuar cilësinë e ujit në komunë, për ta parandaluar nga erozionet e mëtejme, dhe për ti mbrojtur lumenjtë dhe liqenet, të gjitha trupat ujore janë rrethuar nga zonat mbrojtëse. Ekzistojnë tri lloje të zonave të mbrojtura, në varësi se në çfarë lloj zone është i vendosur trupi ujor.

Zona e mbrojtur malore nga uji, është zona më me pak kufizime. Për tu mbrojtur nga erozioni dhe vërshimet është që zona e mbrojtur e lumenjve të mbahet larg nga ndërtimet e lira e kështu do të ndikojmë në



përmirësimin e cilësisë së ujit. Mbeturinat e lira duhet të mbahen larg nga zonat e ujit. Të gjithë lumenjtë dhe liqenet në male dhe pjesë tjera në zonat malore janë mbrojtur me zonë e mbrojtjes malore nga uji.

Lumenjtë që kalojnë përgjatë zonës së rrafshët, janë të rrethuara me zonat e mbrojtjes të ujit. Për tu mbrojtur nga erozioni dhe vërshimet është që zona e ruajtur të mbahet larg nga ndërtimet e lira. Për ta përmirësuar cilësinë e ujit, mbeturinat e lira duhet të mbahen larg nga zonat e ujit, dhe ujit të mbrohet nga ndotja.

Lumenjtë dhe pellgjet në vendbanime janë të mbrojtura nga ujërat. Për tu mbrojtur nga vërshimet, duhet të ndërmerren veprime për ti ruajtur zonat e mbrojtëse, dhe zonat ujore të mbahen të lira nga ndërtimet. Për ta përmirësuar cilësinë e ujit, është që zonat ujore të jenë të pastuara nga mbeturinat dhe të mbahen ndaras nga sistemi i ujërave të zeza.

### **Trashëgimia kulturore dhe natyrore**

#### Trashëgimia Kulturore

Mbrojtja objekteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Gjilanit është domosdoshmëri. Kjo duhet të bazohet në vetëdijësimin e publikut për vlerat e tyre, rëndësinë e tyre, për identitetin e komunitet lokal duke mundësuar që këto vlera të shijojnë edhe vizitorët e rastit. Për vlerat historike dhe kulturore të objekteve të tilla, duhet që edhe në programet shkollore të përfshihen të dhënat për monumente të tilla. Ngritja e vlerës së trashëgimisë kulturore bazohet se sa njohuri ka për to. Krijimi i Muzeut Lokal Historik për të ekspozuar të dhënat për objektet e tilla mundëson njohjen edhe me të mirë të banorëve të grupmoshave të ndryshme komunale e më gjerë.

Mbrojtja e monumenteve historike në vend të parë do të thotë ruajtja e tyre fizike. Për këtë arsye monumentet historike duhet të jenë në shfrytëzim. Me këtë sigurohet kujdesi dhe mirëmbajtja e tyre. Por ka raste kur ndonjë objekt me rëndësi kulturore dhe historike, të cilat janë në pronësi individuale e të cilat kushtojnë shumë për tu riparuar, për këto duhet gjetur, siguruar donacione për konservim deri sa të grumbullohen mjete për rinovimin e tyre.

Shpeshherë mirëmbajtja jo adekuate dhe nga mungesa e informimit për rëndësinë e tyre historike, objektet shkaktohen ose edhe kur rinovohet pa projekt adekuat dhe teknologji përkatëse rinovuese, këto objektet



pësojnë deformitete të pariparueshme. Për pronarët e objekteve të tilla, komuna duhet siguroj ekspert për dhënien e këshillave profesionale. Ndhmë shtesë për këtë, komuna pronarëve të objekteve përkatëse duhet të iu ofroj edhe programe për trajnim profesional.

Objektet e vetme dhe rrethinat e tyre.

Me planifikim urban, objektet e tilla në një lokacion të vetmuar, duhet të parashihet që objektet përreth nuk guxojnë ta cenojnë hapësirën e nevojshme mbrojtëse dhe origjinën e tyre. Gjendja e monumentet historike në Gjiçan siç janë Xhamitë, tyrbet dhe kullat, është shqetësuese, por ato janë të integruara deri diku në strukturën e qytetit. Ka raste kur ndërtesat e afërme, dimensionesh dhe formash të larmishme, me monumenteve kulturore ua rrezikojnë vlerat e tyre shekullore. Mu për këtë, organet komunale duhet aprovuar rregullore dhe norma specifike që të shpëtohen ato objekte që ende kanë mbetur pa u dëmtuar dhe të lejohet ndërtimi vetëm e atyre i objekteve të reja të cilat nuk e cenojnë karakterin dhe hapësirën e nevojshme për to.

Trashëgimia natyrore

Tri objektiva plotësuese esenciale duhet të aprovohen:

- Mbrojtja e trashëgimisë natyrore, peizazhit të hapur dhe pyjeve, nga aktivitetet e vendbanimeve, shkatërrimet e mëtejme dhe eksploatimeve të pa përkrahura,
- Të krijohen qasje në burimet e natyrës për të ju bërë të mundur popullatës ti shijojnë bukurinë e natyrës dhe peizazhit,
- Të mbahen zonat më të cënueshme dhe të çmuara natyrore nën mbrojtje (mos të ketë qasje, as eksploatim).

Një pjesë e peizazhit të hapur i është në gjendje shqetësuese. Mu për këtë, mbrojtja e tokës e shkaktuar nga hedhja e pakontrolluar e mbeturinave, duhet të mbrohet me ligji për mbrojtjen e mjedisit. Për ta rikthyer dhe ruajtur peizazhin, biodiversitetin dhe bukurinë e mjedisit edhe për gjeneratat e ardhshme si dhe për ta mbrojtur tokën dhe burimin e ujit të pijes nga ndotjet e ndryshme. Është nevojshme që peizazhi të pastrohet nga hedhja ilegale e mbeturinave dhe të mirëmbahet.






Fig.49: Zonat e Mbrojtura



Çfarëdo forme e përdorimit të paarsyeshëm të peizazhit, p.sh. prerja ilegale e pyjeve, duhet të pengohet. Kultivimi i tokës bujqësore duhet të avancohet, me qëllim të ruajtjes së pamjes tradicionale të peizazhit. Ndërtimi i vendbanimeve të shpërndara duhet të ndalohej dhe duhet të kufizohen ndërtimet në zonat ekzistues të vendbanimeve të tilla.

Zonat me vlera të veçanta natyrore dhe shkalla e lartë të biodiversitetit duhet të identifikohen dhe mbrohen me vendime të komunës. Ato zona duhet të sigurohen, të ndalohej qasja e makinave dhe çfarëdo eksploatimi tjetër komercial.

Zonat e ndotura dhe të shkatërruara nuk janë atraktive dhe nuk janë të përshtatshme për rekreacion të jashtëm. Kështu që mbrojtja e peizazhit dhe elementeve të tij natyrore, është një parakusht për zhvillimin e objekteve ndihmëse rekreative. Natyra e hapur mund të përkrahet me vetëdijesimin e popullatës duke i ruajtur bukuritë e paprishura.

#### Zonat e Mbrojtura me Vendim Komunal

1	Lugina e Lumit Llapushnik	Park natyrorë
2	Burimet Hidrotermale - Kmetoc	Monument natyrorë
3	Liçenëi i Përlepticës me rrethinë	Peizazh i mbrojtur
4	Trungjet e dardhës së egër - Lipovicë	Monument natyrorë
5	Trungu i bungut - Dragancë	Monument natyrorë
6	Trungjet e bungut - Koretishtë	Monument natyrorë
7	Lisi në fshatin Pasjan	Monument natyrorë
8	Trungjet e bungut - Burincë	Monument natyrorë
9	Burimi i ujit termal - Uglarë	Monument natyrorë
10	Burimi i ujit termal - Gumnishtë	Monument natyrorë
11	Trungjet e bungut - Ponesh	Monument natyrorë
12	Burimi i ujit mineral - Ponesh	Monument natyrorë
13	Trungjet e bungut - Parallovë	Monument natyrorë
14	Burimi i ujit termomineral - Pidiq	Monument natyrorë
15	Shpella e Bresalcit	Monument natyrorë

**vendbanimet / zonë urbane e Gjilanit**  
settlements / urban zone Gjilan

**lum / rrjedhë**  
river / stream

**mbrojtja e ujërave në zonën ndalimi i ndërtimit në hapësirë, parandalimi i ndotjes së napsirave ujore**  
water protection zone forest: retention area for action, water at is to be kept free of garbage

**mbrojtja e ujërave në zonën rrafshore, parandalimi i ndotimit në hapësirë ujore, mbrojtja e ujërave nga ndotja me plehra**  
water protection zone plain: retention area is to be kept free of construction, water at is to be kept free of garbage, water is to be protected from fertilizer-pollution

**mbrojtja e ujërave në vendbanime, parandalimi i ndotjes së hapësirave ujore dhe mbrojtja e tyre nga ndotja, ndarja e ujërave nga sistemit kanalizim**  
water protection zone settlements: actions for the water retention are to be taken, water area is to be kept free of constructive water area is to be kept free of garbage, water is to be separated from the sewage-system

**zonë malore: hapësirë me prioritet për mbrojtjen e natyrës, rrypëllezim dhe rekreacion**  
mountain zone: priority area for nature protection, reforestation and recreation

**zonë trashënorë: hapësirë me prioritet për bujqësi**  
plain zone: priority area for agriculture

**monument kulturor / natyror**  
cultural / natural monument

**deponi / qendër e reciklimi**  
depository / recycling center

**mbledhës ujor në pishëm**  
domestic water plant

**impianti rajonal me hapësirë mbledhëse fehat / komunë**  
village / municipal sewage plant with catchment area

**impiant komunal**  
Municipal plant

**Kuvendi Komunal Gjilan**  
Municipal Assembly Gjilan

**Plani zhvillimor komunal i Gjilanit**  
Municipal development plan of Gjilan

**Plani i mbrojtjes së natyrës dhe ambientit**  
Landscape and Environmental Protection Plan

14.04.2008


Përpjesja: 1:150,000  
Scale: 1:150,000

0 1 2 3 4 5 km

**Plani 12**  
Plan 12

DIREKTORIA PËR URBANIZIM, RINDËRTIM, DHE AMBIENT  
THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT

**planungsgruppe 4**







### 3.3 SHËNJIMI I ZONAVE URBANE EKZISTUESE DHE TË PROPOZUARA DHE NDËRTIMI E ZONAVE JASHTË ZONËS URBANE

Për një zhvillim të qëndrueshëm të bazuar në potencialet e veta, komunës së Gjiçanit i duhet siguruar hapësirë adekuate për zona banimi, mikse, komunale si dhe tokë për industri dhe biznes.

#### Zonat e banimit

Nevoja për tokë banimi në komunën e Gjiçanit bazohet në 3 skenarë të ndryshëm të migrimit.

Që të sigurohet tokë e nevojshme banimi, për skenari për nevojë më të madhe për tokë, është marrë si bazë për llogaritje migrimi i balancuar në dhe prej komunës së Gjiçanit .

Duke llogaritur nevojën totale të furnizimit me tokë ndërtimore, hapësirë shtesë nevojitet për zona komplementare me banimin si psh shkollat, tregtia si dhe objektet kulturore të cilat janë të integruara në zonat e banimit. Sipas këtyre, strukturave specifike të vendbanimeve, furnizimi i duhur me tokë ndërtimore bashkë me zonat komplementare duhet ta tejkaloj furnizimin me tokë ndërtimore i rritur për 30%.

Bazuar në këto konstatime, furnizimi me tokë ndërtimore **deri 2020** rekomandohet:


- **Qyteti i Gjiçanit** duhet të siguroj një shtesë prej 190 ha tokë për banim. Si pjesë e nevojës për banim mund të alokohet hapësirat në zonat e reja mikse dhe zonat qendrore (aproximativisht 50% e zonave mikse dhe 30% e zonave qendrore). Kështu nevoja për tokë banimi reduktohet nga 190 ha në 150 ha.
- **Fshatrat** dhe **qendrat sekondare**<sup>14</sup> si dhe **periferia** duhet të sigurojnë tokë banimi për banorët lokal (zhvillim lokal). Sigurimi mesatari tokës për banim prej 2 deri 3 ha për fshat dhe 3 deri 4 ha për qendra sekondare, llogaritet të jetë i mjaftueshëm për zhvillimi të qendrave sekondare. Nevojat specifike të fshatrave dhe qendrave sekondare mund të ndryshojnë. Mu për këtë, për raste të veçanta duhet bërë analiza veç e veç. Shuma totale e

<sup>14</sup> i.e. Partesh, Zhegër, Pogradjë, Përlepnice, Bresalc.

nevojës për tokë për **zhvillimin e fshatrave dhe qendrave sekondare** është rreth 186 ha.

- Për nevojën adekuate për banim në **qytetin e Gjiçanit pas 2020**, plani përcakton një shtesë të tokës për ndërtim rezervë prej 100 ha (totali 220 ha furnizimi afatgjatë me tokë ndërtimore për Gjiçanin).

Fig.50: Furnizimi i rekomanduar me tokë për banim deri më 2020



### Furnizimi me tokë për industri dhe biznes

PZHK duhet gjithashtu të sigurojë tokë për industrinë dhe biznesin.

Për shkak të situatës specifike ekonomike në Gjiçani, llogaritja e nevojës për furnizim me tokë për industri dhe biznes nuk është i arsyeshëm. Është rekomanduar të sigurohet furnizim strategjik me tokë për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të komunës.

Përkundër grupeve potenciale si: logjistika, ndërmarrjet distributive, industritë ndërtimore, (incl. Prodhimi i materialit ndërtimor) dhe industrisë ushqimore (sidomos vera), rezerva prej 20 deri 30 ha të tokës zhvillimore është mjaftueshëm për hapat e parë të zhvillimit. Për nevoja afatgjata rekomandohet rezerva strategjike e tokës prej 100 ha. Furnizimi me tokë duhet të fokusohet në **qytetin e Gjiçanit**. Kjo e dhënë, nuk e kundërshton zhvillimin lokal të industrisë dhe tregtisë në **fshatra dhe qendrat sekondare**<sup>15</sup> të Gjiçanit.

<sup>15</sup> i.e. Cërnicë, Zhegër, Pogradjë, Dobërçan, Përlepticë, Bresalc.



### Furnizimi me tokë për qendrën e qytetit / zonat qendrore, zonat mikse dhe zonat për përdorim të përbashkët (komunale)

Furnizimi me tokë për qendrën e qytetit / zonat qendrore, zonat mikse dhe zonat për përdorim të përbashkët (komunale), është me interes të veçantë. Mu për këtë, rekomandohet të rezervohet sasia e tokës për zhvillim afatgjatë të **qytetit të Gjilanit, dhe atë:**

- rreth 20 ha qendrës së qytetit/ zona qendrore, (Kryesisht në pjesët e rihvilluara),
- rreth 90 ha të zonës mikse (përgjatë rrugëve kryesore),
- rreth 10 ha të zonës komunale (për ritjen e objekteve shkollore).

**Qendrat sekondare**<sup>16</sup> duhet të sigurojnë rreth 2 ha të zonave mikse për furnizim të ndërmarrjeve të vogla dhe tregtisë. Për përcaktimin e zonave potenciale mikse, zona të përshtatshme duhet identifikuar dhe ruajtur brenda qendrave sekondare.

**Fshatrat përreth Gjilanit** si dhe **paralagjët** duhet kryesisht të jenë në gjendje për zhvillimin e zonave mikse dhe zonave komunale brenda strukturës së vendbanimeve.

### Politika globale e furnizimit me tokë/ zhvillimi hap pas hapi

Për përdorim më të mirë të potencialeve, rekomandohet ti jepet prioritet rihvillimit të tokës së lënë djerrë. Zhvillimi i zonave të gjelbërimit duhet kuptuar si prioritet sekondar.

Zhvillimi i politikës për sigurimin e rekomanduar me tokë në Gjilanit duhet bërë hap pas hapi. Kjo nënkupton se furnizimi i rekomanduar me tokë nuk duhet siguruar përnjëherë. Megjithatë, duhet siguruar tokën e ndërimit **sipas nevojave të së ardhmes.**

<sup>16</sup> i.e. Cërnice, Zhegër, Pogradjë, Dobërçan, Përlepnice, Bresalc.





Fig. 51: Furnizimi me tokë ndërtimore i përcaktuar me PZH/PZHU

Kategoria e tokës ndërtimore	Furnizimi i tokës në hektar ( ha)				Vërejtje
	Qyteti	Qendrat dytësore 17	Periferit ë	Fshatrat	
Zonat banuese deri në vitin 2020	120	3-4 ha		2-3 ha	Rezervat strategjike prej 100 ha në qytet të emëruara në planë
		Totali: 186			
Qendra e qytetit / zonat e pjesës qendrore (afatgjate )	20	-			Shumica të vendosura në pjesët e ri-zhvilluara
Zonat e përdorur në mënyrë të përzier (afatgjate )	90	~ 2 ha për qendër	-		Zhvillimi i përdorimit të përzier në fshatra mund të akomodohet në strukturën e vendbanimeve ekzistuese
Përdorimi i përzier (afatgjatë )	10	-			Lehtësimi i Përdorimit të përbashkët në fshatra dhe qendrat dytësore duhet të akomodohen në strukturat e vendbanimeve t ekzistuese
Toka për industri dhe tregti	90	-			Fokusimi në qytetin e Gjiçanit ,

<sup>17</sup> i.e. Cërnice, Zhegër, Pogragjë, Dobërçan, Përlepnicë, Bresalc.



(afatgjate )			vetëm zhvillimi i fshatrave dhe qendrave dytësore të rrezikuara, hapi i parë i zhvillimit në qytet: 20 to 30 ha
--------------	--	--	---

### 3.4 SHËNJIMI I ZONAVE TE NDËRTIMIT TË RËNDËSISHËM, PROJEKTI STRATEGJIK APO ZONAVE TE VEÇANTA TË APROVUARA ME PHK OSE PLANIN E ZONAVE TË VEÇANTA

Si projekte strategjike të aprovuara për rajone më të gjëra janë:

- Bashkëpunimi ndërkufitarë i cili e definojnë Gjiçanin si qendër të "trekëndëshit të dyfishtë ",
- Deponia rajonale,
- Impianti rajonal.
- Hekurudha.

### 3.5 VLERËSIMI I NDIKIMIT SOCIO-EKONOMIK DHE MJEDISORË TË KORNIZËS SË PROPOZUAR

Planifikimet kanë ndikime në jetën e njerëzve si dhe në zhvillimet sociale dhe ekonomike të tyre. Këto planifikime doemos reflektohen edhe në hapësirë përmes dy formash:

- Okupimi i territorit të ri,
- Ndërrimi i destinimit të territoreve me funksione të reja.

Këto ndikime mund të jenë pozitive dhe negative në jetën e njeriut, në zhvillimet ekonomike, sociale si dhe në mjedis. Meqenëse, planifikimet bëhen me qëllim të përmirësimit të kualitetit jetësorë, atëherë nënkuptohet që këto ndikime duhet të jenë pozitive në të gjitha aspektet. Ndikimet negative duhet të minimizohen.

Korniza e paraparë e zhvillimit është e orientuar kah plani i veprimit. Ajo parasheh zhvillime të cilat banorëve të Gjiçanit duhet të t'i sjellin përparim dhe zhvillim social dhe ekonomik. Zhvillimi komunal i mbështetur në katër shtylla e tij, të përmendura më herët, i mobilizojnë të gjitha resurset e zhvillimit ekonomik, për të shtuar numrin e vendeve të punës, për të rritur kualitetin e prodhimeve dhe për t'i dhënë një identitet rajonit. Zhvillimi ekonomik duhet të përkrahët nga një zhvillim social i përparuar në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe sportit. Zhvillimi ekonomik dhe



social duhet të mbështetet nga një infrastrukturë funksionale si dhe shërbime më të mira për qytetarët.

Ndikimet e mundshme negative ekonomike dhe sociale nga strategjia e paraparë mund të jenë fragmentare duke pasur parasysh se në komunën e Gjiçan janë paraparë edhe projekte të nivelit qendror – si psh. hekurudha, e cila mund të ndikojë në zhvillimet lokale nëpër vendbanime apo jashtë tyre – siç janë eksproprijimi i tokës, ndarja e ngastrave të tokës bujqësore etj.

Përveç ndikimeve ekonomike dhe sociale, ndikimet e mundshme në mjedis të cilat duhet të merren parasysh gjatë implementimit të planit Zhvillimor Urban janë si më poshtë.

#### NDIKIMI NË TOKË – ZËNIA E TOKËS BUJQËSORE

Njëri nga prioritetet e planit është mbrojtja e tokës kualitative bujqësore dhe ndalimi i ndërtimit në tokat e kategorisë I-IV. Strategjia parasheh ndalimin e ndërtimit në tokën kualitative bujqësore, përveç në rastet e përshkruara me Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor.

#### NDIKIMI NË AMBIENT

Ndotja e ajrit kryesisht shkaktohet nga:

- Trafiku dhe
- Industria

**Trafiku** - Ndotja e ajrit nga trafiku parashihet të zvogëlohet me shkarkimin e trafikut përmes Unazës së jashtme dhe asaj të brendshme. Rrjeti i ri i trafikut, me strategjinë e propozuar, ka paraparë përmirësimin e kualitetit të rrugëve gjë që ndikon edhe në zvogëlimin e ndotjes.

**Prodhimtaria industriale** - Ndikimet negative nga prodhimtaria industriale do të zvogëlohen pasi që strategjia parasheh zhvillimin e prodhimtarisë jo shqetësuese dhe ndërrimin e destinimit nga industria e rëndë në atë të lehtë. Po ashtu zonat industriale klasike parashihen të transformohen në zona mikse (industri+tregti). Sipas rregullores së MMPH, çdo prodhim i ri, si pjesë e kërkesës për leje ndërtimi dhe operimi, duhet të përgatisë Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis me çka bëhet i mundur kontrolli i ndikimeve në mjedis sipas kriterëve ligjore aktuale.

#### NDIKIMI NË UJË





Ndikimet negative në ujëra janë kryesisht nga derdhjet e ujërave të zeza të kanalizimeve të cilat nuk janë të trajtuara paraprakisht. Me planin e ri parashihet integrimi i infrastrukturës së kanalizimit të ujërave të zeza dhe



ndarja e tij nga ujërat atmosferik i cili mund të derdhet në lumenj. Po ashtu është paraparë ndërtimi i kolektorëve përgjatë lumenjve si dhe një numër i caktuar impiantesh lokale si nënstacione, para lidhjes së impiantit kryesor që parashihet të ndërtohet. Gjithashtu strategjia parasheh mbrojtjen e lumenjve nga ndërtimet si në zonën urbane ashtu edhe jashtë sajë.

#### NDIKIMI NË VEGJETACION

Planifikimi i ndërtimit në lartësi, në qendër të qytetit, do të ketë ndikim pozitiv, sepse do të lirohet hapësira përreth këtyre objekteve për gjelbërim dhe vegjetacion. Kufizimi i ndërtimit në zonat rurale dhe përcaktimi i parametrave të ndërtimit në këto zona, do të ndikoj pozitivisht si në ruajtjen e vegjetacionit ashtu edhe në mbrojtjen e tokës bujqësore.



**Kuvendi Komunal i Gjilanit**  
Municipal Assembly of Gjilan

**Plani zhvillimor komunal i Gjilanit**  
Municipal development plan of Gjilan

**Demografia dhe qështjet Sociale**  
Population and Social Infrastructure

14.04.2008  
Përpleks: 1:50,000  
Shall:

**Plani 13**

**DEKRETI PËR SHANIMIN, RINDRITURIMIN DHE AVANTURIMIN E QARKORJES SË KESHIJALËVE**

**planimigruppe 4**



	qendra e qytetit të Gjilanit Gjilan city centre
	hapësirat me shfrytëzim të përzier / ban mixed / residential areas
	hapësirat me shfrytëzim të përzier / ban suburban mixed / residential areas
	hapësirat me shfrytëzim industrial / komer industrial / commercial areas
	zonë fshati: vetëm zhvillim endogjen village zone: only endogenous development
	qendra komunale municipal centre
	qendra sekondare secondary centre
	administrata / bashkia administration / town hall
	shkollë e mesme / fakultet universitar secondary school / university faculty
	qender e mjeksisë familjare / spital family health care centre / hospital
	zonë matore: hapësirë me prioritet për rekreacion dhe natyrë, rripëzime dhe mountain zone: priority area for nature protection, recreation and recreation development
	zonë rrafshinore: hapësirë me prioritet për bujqësi plain zone: priority area for agriculture
	lum / rrihedhë me zonë për të u mbrojtur river / stream with protection zone
	hapësira kryesore e rekreimit main recreation zone
	Pogragjë recreation / tourism centre
	monument kulturor / natyror cultural / natural monument
	hapësira për shëtitje / hapësira për peshkë hiking area / fishing area
	burim mineral / restorant mineral spring / restaurant
	rrugë magjistrale me vendkalim kufitar magistral road with border crossing
	rrugë rajonale me vendkalim kufitar regional road with border crossing
	rrugë lokale local road
	hekurudha railway
	"Unaza policentrike" Hekurudha alternative
	deponi / qendër reciklimi landfill / recycling centre
	impjant komunal / rezervoar i ujit të pijsëm sewage plant / drinking water plant
	impjant rajonal / interesi turistik Regional plant

**Kuvendi Komunal Gjilan**  
Municipal Assembly Gjilan

**Plani zhvillimor komunal i Gjilanit**  
Municipal development plan of Gjilan

**Plani zhvillimor hapësior - Shfrytëzimi i Tokës dhe i Hapësirës**  
Spatial Development Plan - Land use


14.04.2008

Plan 14  
Plan 14

Përpjesa:  
Scale:

DIREKTORIA PËR URBANIZIM, RINDËRTIM DHE AMBIENT  
THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT

**planingsgruppe 4**







## 4 STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR ZBATIM

Duke pasur parasysh se Plani Zhvillimor Komunal e drejton dhe e kontrollon zhvillimin në Komunën e Gjilanit për 10 vitet e ardhshme, funksioni i tij më i rëndësishëm është ti vendos strukturat urbane dhe furnizimin me infrastrukturë për periudhën kohore deri në vitin 2015. Por PZHK gjithashtu e luan një rol të rëndësishëm për kohën edhe pas vitit 2020. Zonat e ndërtesave dhe objektet ndihmëse të infrastrukturës që duhet të ndërtohen pas vitit 2020 janë të realizueshme, vetëm nëse pjesët, trasat dhe kanalet e tyre janë siguruar në PZHK-n e.

Për këtë qëllim kemi propozuar pakon e veprimeve për zbatim që përbëhet prej Projekteve kyçe. Këto janë të rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm të komunës së Gjilanit. Projekteve kyçe janë ndarë në projekte për vendbanime, peizazh, trafik dhe infrastrukturë teknike. Radhitja e projekteve të përmendura nuk përcakton prioritetin e tyre.

### VENDBANIMET

Plani rregullues për Cërnicë, Përlepnicë, Pogragjën, Zhegër, Dobërqaq dhe Bresalc

Fshatrat Përlepnicë, Pogragjë, Zhegër, Cërnicë, Dobërqaq dhe Bresalc janë përcaktuar që të bëhen qendra dytësore. Komuna do të bëjë investime në këto fshatra, dhe ato do të kanë nevojë të pashmangshme zhvillimi. Për ta parandaluar zhvillimin e pakontrolluar, dhe shtrirjen e mëtejme urbane, duhet të përgatiten planet rregulluese për qendrat dytësore.

### INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE AJO TEKNIKE

Korridori për rrugën M25-3 për Ferizaj

Ferizaj dhe Gjilani janë dy qytet më të mëdha në Kosovën juglindore, dhe lidhjet ndërmjet tyre janë të rëndësishme për dy komunat. Trafiku ndërmjet këtyre dy komunave do të rritet në të ardhmen, dhe zgjerimi i rrugëve do të jetë i domosdoshëm. Për ti siguruar investimet e tilla, një korridor përgjatë këtyre rrugëve duhet të mbahet i lirë nga ndërtimet.

Rruga R212 për Kumanovë

Kumanova është qyteti më i madh në Maqedoninë veriore, dhe është një nga partnerët më të rëndësishëm të tregtisë për Gjilanin. Për ta



përmirësuar lidhjen ndërmjet Gjilanit dhe Kumanovës, standardi i rrugës rajonale R212 duhet të ngritet.

### **Korridori për linjën Hekurudhore**

Hekurudha ndërmjet Gjilan dhe dy qyteteve, Ferizaj dhe Bujanovc, është paraparë në Planin Hapësinor të Kosovës. Realizimi i kësaj hekurudhe nuk do të fillojë në një të ardhme të afërt. Megjithatë, ky projekt do të ketë efekt të drejtpërdrejt në zhvillimin e së ardhmes së Gjilanit. Për ta siguruar realizimin e ardhshëm të kësaj hekurudhe, duhet të bëhet një studim i qëndrueshmërisë dhe duhet të mbahet një korridor i lirë nga ndërtimet. Një studim i tillë duhet të bëhet në bashkëpunim me komunat dhe autoritet tjera me ndikim.

### **PEIZAZHI DHE MJEDISI**

#### **Rezervari i liqenit dhe qendra rekreative e Pogragjës**


Për ta përmirësuar furnizimin me ujë të pijes, është propozuar të krijohet një liqe në luginën e lumit Morava të Bincës në fshatin Pograxhë. Liqenëi gjithashtu do të përdoret për rekreacion. Për ta filluar zhvillimin e turizmit në Pogragjë, dhe për ti penguar ndërtimet e padëshirueshme, në këtë fshat duhet të ndërtohet një qendër për vizitor .

#### **Qendra rekreative në burimin e ujit mineral në Dobërçan**

Burimi mineral në Dobërçan është një nga atraksionet kryesore për vizitorët në komunë. Ky lokacion mund të arrihet lehtë nga rruga M25-3. Ky burim paraqet edhe piken fillestare për organizimin e ekskursioneve dhe zhvillimin e turizmit rural. Për ta parandaluar një zhvillim të pakontrolluar dhe për ta siguruar përdorim rekreativ për të ardhmen, pranë burimit duhet të ndërtohet një qendër për vizitor.

#### **Mbrojtja e Moravës së Bincës**

Lumi Morava e Binçës kalon përmes komunës së Gjilanit. Ky lum është i ndotur nga mbeturinat. Derdhja e ujërave nga kanalizimi është shkarkuar drejtpërdrejt në ndotjen e lumit. Kualiteti i ujit të Moravës së Binçës ndikon drejtpërsëdrejti në shëndetin e banorëve të komunës. Realizimi i shpejt i zonës mbrojtjes të lumit, i propozuar në këtë plan, është i rëndësishëm së veçantë.



**VENDBANIMET**  
**SETTLEMENTS**

- 1 Plani rregullues Përlëpnicë  
Regulatory plan Përlëpnicë
- 2 Plani rregullues Pograditë  
Regulatory plan Pograditë
- 3 Plani rregullues Zhegër  
Regulatory plan Zhegër
- 4 Plani rregullues Cërnica  
Regulatory plan Partesh
- 5 Plani rregullues Bresalc  
Regulatory plan Bresalc
- 6 Plani rregullues Dobërçan  
Regulatory plan Dobërçan

**TRAFIKU**  
**TRAFFIC**

- 1 M25-3 për në Ferizaj  
M25-3 to Gjiatani
- 2 R 212 për në Kumanova  
R 212 to Kumanova
- 3 hekurudha  
railway
- 4 rruga rajonale R209  
regional road R209

**PEJSAZHI**  
**LANDSCAPE**

- 1 Liqeni akumulues  
Storage lake / recreation centre Pograç
- 2 Qendër rekreative Dobërçan  
Recreation centre Dobërçan
- 3 Zona e lumit Morava e Binçës  
Riverarea Morava e Binçës

"Unaza policentrike"

**Kuvendi Komunal Gjiatani**  
Municipal Assembly Gjiatani

**Plani zhvillimor komunal i Gjiatani**  
Municipal development plan of Gjiatani

**Projektet kryesore Komuna**  
Key Projects Municipality

14.04.2008

Plani 15  
Plan 15

Përpjesa:  
Scale:



DIREKTORIA PËR URBANIZIM, RINDËRTIM DHE AMBIENT  
THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT



Institute for Planning and Environment



#### 4.1 STRATEGJITË PËR ZBATIM DHE PLANET E VEPRIMIT TË SHOQËRUARA ME KONCEPTET HAPËSINORE OSE PARIMET

##### Instrumentet e rëndësishme për implementim

Implementimi i projektit të vendbanimeve të tjera nga projektet kyçe, ka si imperativ realizimin e Planit Rregullues Urban (cf. Neni 15 Ligji për Planifikimin Hapësinor). **Planet Rregulluese Urbane**, “ i përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave si dhe rregullat për lokacionin e ndërtesave në ngastrat urbane”. Përmes themelimit të bazës ligjore për ndërtimi, është e përcaktuar korniza për investime private. Si rrjedhim Planet Rregulluese Urbane paraqesin dokumente kyçe për implementimin e zonave të përcaktuara ndërtimore.

Implementimi i projekteve të caktuar për trafik dhe infrastrukturë, kërkon një **studim të qëndrueshëm dhe teknikisht të detalizuar**. Për këtë është e nevojshme që të grumbullohen të gjitha informatat e nevojshme të cilat mundësojnë që më saktësi të përcaktohen parametrat teknik që mundësojnë implementim me kosto të arsyeshme.

##### Implementimi i strategjisë

Shtyllat e implementimit të strategjisë janë përcaktimi i **fazave të zhvillimit**. Përmes fazave identifikohet korniza kohore si dhe ndërvarësinë ndërmjet masave, kriterëve dhe mundësive për një realizueshmëri të projekteve përkatëse.

Strategjitë tona për zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal do të jenë përgatitja e planeve të nevojshme përkatëse, intervenimet konkrete në hapësirë për mbrojtje dhe zhvillim, përgatitja dhe harmonizimi i politikave komunale, krijimi i partneriteteve të nevojshme, menaxhim i informatave, hulumtime të vazhdueshme dhe monitorim të zhvillimeve të bazuara në kornizën ligjore.

Projektet kyçe i tregojnë masat e zhvillimit të cilat janë vitale për implementimin e fazave të lartpërmendura të zhvillimit. Lista e projekteve kyçe përmban një përzierje masash në fushën e vendbanimeve, peizazhit, trafikut dhe infrastrukturës drejt zhvillimit të qëndrueshëm të zonës urbane.



## 4.2 VLERËSIMET E STRATEGJIVE BAZUAR NË KRITERET E PËRCAKTUARA ME PARIME, POLITIKA DHE LIGJE

### Demografia dhe Çështjet Sociale

Kontrrolli i migrimeve të popullsisë në Qendra Sekondare (QS)

Ndalimi i imigrimi të popullsisë në qendrën komunale (Gjiçan)

Ofrimi i shërbimeve administrative, shkollimit, sportive, rekreative dhe infrastrukturës sociale në QS.

### Zhvillimi Ekonomik

Ruajtja e tokës bujqësore dhe favorizimi i bujqësisë duke i koncentruar ndërtimet në Gjiçan dhe qendra sekondare,

Shpërndarja më efikacë e zhvillimeve ekonomike,

Ndarja e përgjegjësisë edhe në QS.

### Mjedisi dhe Shfrytëzimi i Tokës

Shfrytëzimi më racional i tokës dhe hapësirës,

Ndalja e zhvillimeve të pakontrolluara,

Mbrojtja e lumenjëve dhe ujërave nëntokësore,,,

Mundësia më e lehtë e menaxhimit me impiante dhe mbledhje të mbeturinave,

Shfrytëzimi racional i resurseve nëntokësore,

Ripyllzimi.

### Infrastruktura Teknike

Unaza Policentrike lidhë edhe vendbanimet edhe më të largëta mes vedit, të cilat pastaj përmes QS-ve kanë lidhje direkt me qendrën komunale.

Ofrimi më i lehtë dhe i lirë i infrastrukturës teknike si qendra shpërndarëse.



#### 4.3 AFATET KOHORE, IMPLIKIMET FINANCIARE, KORNIZA INSTITUCIONALE

##### Hapat e përshtatshëm të zhvillimit

Projektet e treguara kyçe janë projekte me prioritet. Ato duhet të implementohen sa më shpejtë që të jetë e mundur, sipas kapaciteteve financiare të komunës. Për shkak të ndryshimeve politike dhe ekonomike të pritura në periudhën afatshkurta dhe afatmesëm, kapacitetet e investimeve të komunës mbeten të pasigurta. Duke qenë në dijeni për këtë fakt, është e nevojshëm që të adoptohet një **qasje hap pas hapi e realizimit të projekteve**, e cila e bën përdorimin maksimum të fondeve që janë në dispozicion për vitin buxhetor në vijim.

Pasi që kapacitetet investuese në komunën e Gjiçanit janë të limituara për momentin, **faza e parë e zhvillimit** i përfshinë masat që mund të implementohen pa investime të mëdha. Investimet e mëdha janë të nevojshme në fazat e mëvonshme, që i mundësojnë komunës për të grumbulluar fonde për to.

Duke marr parasysh **burimet e pakta financiare**, administrata e komunës duhet të kërkoj fonde shtesë nga programet kombëtare ose ndërkombëtare. Në këtë mënyrë komuna mund ta dinamizoj procesin e zhvillimit dhe ti arrij qëllimet e saja të zhvillimit për kohë më të shkurtër

##### Bashkëpunimi – instrument kyç për implementim

Në implementimin e PZHK – projekteve kyçe të parapara, është e rekomandueshme që gjithashtu të ketë përfitime nga **partneritetet publik-privat**. Kompanitë private mund të luajnë rol të rëndësishëm në modelet e financimit duke ofruar mjete dhe personel me specializime të avancuara.

Si shtesë është rekomanduar që të vlerësohet partneritetet strategjike me komunat fqinje ose autoritetet tjera publike (**partneritet publik-publik**), veçanërisht në ngritjen e shërbimeve publike dhe pajisjeve të infrastrukturës.

Përfundimisht, komuna duhet ti filloj përpjekjet e saj për ti futur qytetarët e saj në proceset e planifikuara ndërtimore .



**SHTOJCA Nr. 1 – Propozim Për Planin e Veprimit**

*Vërejtje: Ky propozim duhet të trajtohet dhe harmonizohet me politikat Komunale*

Ky propozim i Planit Zhvillimor komunal të Gjiçanit ofron kalimin në mes të gjendjes ekzistuese dhe kornizës hapësinore. Është formuluar pako e strategjive dhe veprimeve për realizimin e qëllimeve brenda kornizës hapësinore, afatet e caktuara dhe rrjedhat tjera në proces

- Strategjitë për zbatim dhe planet e veprimit të shoqëruara me konceptet hapësinore ose parimet;
- Vlerësimi i strategjive bazuar në kriteret e përcaktuara me parimet për mbrojtje dhe zhvillim, politika dhe ligje;
- Afatet kohore, implikimet financiare, kornizën institucionale.

Duke u bazuar në vizionin e komunës, pakoja e strategjive dhe veprimeve për realizimin e qëllimeve brenda kornizës hapësinore do të zbërthehet në plane veprimi me prioritete strategjike

Fig.52: Plani i Veprimit për prioritetin – Hartimi i Planeve Përkatëse

Aktiviteti	Afati kohor	Implikimet financiare	Pjesëmarrësit	Vërejtje
Përgatitja e planeve rregulluese për Cërnicë, Përlepticë, Pogragjë, Zhegër, Dobërçan dhe Bresalc	3 vite	180 000 €	Komuna dhe Kompani të Specializuara për Planifikim	
Trajtimi i 17 vendbanimeve të ndryshme komunale në bazë të koncepteve të zhvillimit hapësinor.	5 vite	200 000€	Komuna dhe Kompani të Specializuara për Planifikim	



Fig.53: Plani i Veprimit për prioritetin – Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Aktiviteti	Afati kohor	Implikimet financiare	Pjesëmarrësit	Vërejtje
Projekti për mbrojtjen e lumit Moravës së Bincës	1 vitë		Komuna + Qeveria e Republikës së Kosovës	
Ripyllëzim	5 vite	30 000€	Komuna + Qeveria e Republikës së Kosovës	
Reduktim i ndotjeve dhe pastrim të lumenjëve	5 vite	50 000€	Komuna + Qeveria e Republikës së Kosovës	
Mbrojtje e zonave ujore	5 vite	20 000€	Komuna + Qeveria e Republikës së Kosovës	
Parandalim i vërshimeve	5 vite	30 000€	Komuna + Qeveria e Republikës së Kosovës	
Mbrojtje e hapësirave dhe objekteve me vlera natyrore	5 vite	50 000€	Komuna + Qeveria e Republikës së Kosovës	
Mbrojtje e hapësirave - zonave me resurse nëntokësore	5 vite	100 000€	Komuna + Qeveria e Republikës së Kosovës	

Fig.54: Plani i Veprimit për prioritetin – Ofrimi i infrastrukturës së domosdoshme për krijimin e kushteve për investime në zhvillim ekonomik

Aktiviteti	Afati kohor	Implikimet financiare	Pjesëmarrësit	Vërejtje
Zonat Industriale	1 vitë	50 000€	Komuna + komuniteti i biznesit	
Hapësirat aktive rurale	5 vite	20 000€	Komuna + komuniteti i biznesit	



Zhvillimi i zonave turistike në Kalanë e Pogradjës, Përlepnicë, Miresh, Uglar, Nasalë, Pidiq etj	5 vite	100 000€	Komuna + Qeveria e Republikës së Kosovës	
Zhvillimi i zones rekreative në Stanishor	2 vite	10 000€	Komuna + komuniteti I biznesit	
Zhvillimi i zones së lirë doganore në Stançiq dhe Muqibabë	3 vite	20 000€	Komuna + Qeveria e Republikës së Kosovës	

Fig.55: Plani i Veprimit për prioritetin – Shfrytëzimi racional i territorit

Aktiviteti	Afati kohor	Implikimet financiare	Pjesëmarrësit	Vërejtje
Sigurimi, mbrojtja, rigjenerimi dhe shfrytëzim i tokës për bujqësi.	5 vite	50 000€	Komuna dhe Komuniteti	
Sistem i menaxhimit të tokës dhe fond për këmbim të tokës	5 vite	10 000€	Komuna dhe Komuniteti	

Fig.56: Plani i Veprimit për prioritetin – Hartimi i programit për trajtimin e vendbanimeve joformale

Aktiviteti	Afati kohor	Implikimet financiare	Pjesëmarrësit	Vërejtje
Hartimi i planeve për trajtimin e vendbanimeve joformale	2 vite	30 000€	Komuna dhe Kompani të Specializuara për Planifikim	
Sistemi i menaxhimit të tokës dhe fondet për implementim	5 vite	10 000€	Komuna dhe Kompani të Specializuara për Planifikim	



Fig.57: Plani i Veprimit për prioritetin – Avancimi i projekteve ndërkufitare

Aktiviteti	Afati kohor	Implikimet financiare	Pjesëmarrësit	Vërejtje
Lidhja e Gjiçanit me Bujanovcin dhe Preshevën	5 vite	30 000€	Komunat përkatse Qeveria e Republikës së Kosovës	
Lidhja e Gjiçanit me Kumanovën	5 vite	50 000€	Komunat përkatse Qeveria e Republikës së Kosovës	

Fig. 58: Plani i Veprimit për prioritetin – Përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe krijimi i asaj hekurudhore

Aktiviteti	Afati kohor	Implikimet financiare	Pjesëmarrësit	Vërejtje
Sigurimi I koridorit të trasës së hekurudhës	5 vite	20 000€	Komunat + Hekurudhat e Kosovës + Qeveria e Republikës së Kosovës	
Sigurimi I koridorit të trasës së lidhjeve ndërkufitare	5 vite	30 000€	Komunat + Qeveria e Republikës së Kosovës	



Fig.59: Plani i Veprimit për prioritetin – Përmirësimi i infrastrukturës sociale dhe teknike

Aktiviteti	Afati kohor	Implikimet financiare	Pjesëmarrësit	Vërejtje
Intervenimet konkrete në hapsirë për mbrojtje dhe zhvillim	5 vite	20 000€	Komuna dhe Komuniteti	
Përgatitja e dhe harmonizimi i politikave komunale	5 vite	10 000€	Komuna	
Krijimi i partneriteteve të nevojshme	5 vite	10 000€	Komuna	
Menaxhim i informatav	5 vite	5 000€	Komuna	
Mulumtime të vazhdueshm dhe monitorim	5 vite	10 000€	Komuna	



## 5 DISPOZITAT PËR ZBATIM

### 5.1 UDHËZIME MBI ÇËSHTJET E INTERPRETIMIT TE PLANIT ZHVILLIMORË KOMUNAL GJATE HARTIMIT TE PLANEVE RREGULLUESE DHE PLANEVE TJERA

Edhe pse Komuna mund të fillojë me zbatimin e planit menjëherë pas aprovimit të tij, një numër i elementeve të përfshira me plan duhet të definohen- sqarohen me Plane Rregulluese. PZHU nuk ka definuar përkufizimet, rregullat e ndërtimit, parametrat urban kështu që një numër i madh i aspekteve të ndryshme duhen të specifikohen më hollësisht. Për çdo zonë urbane dhe qendra sekondare duhet të hartohen plane rregulluese. Të gjitha hulumtimet e nevojshme si psh. studime për mjedisin, studime në zona të veçanta arkeologjike si dhe studime rreth rregullimit të trafikut janë të nevojshme dhe duhet zbatuar Planet Hapësinore për Zona të Veçanta (PHZV).

PHZV-të do të kërkohen për zonat të cilat janë të një niveli me të lartë të interesit dhe rëndësisë. Sidoqoftë ato do të hartohen nga niveli qendror, PHZV-të duhet të jenë për aq sa është e mundur në përputhje me udhëzimet dhe synimet e përcaktuara me PZHU.

### 5.2 KUSHTE TE PËRCAKTUARA NGA QEVERIA LOKALE MBI ÇËSHTJE TË RËNDËSISHME PËR ZHVILLIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E TOKES NE KOMUNË

#### 5.2.1 Kushtet për përcaktimin dhe destinimin e sipërfaqeve publike në territorin e Komunës

Hapësirë publike do të duhej të definohej bregu përgjatë lumit. Ai do të duhej të zbatohet pasi që këtë veprim e ka konfirmuar edhe plani rregullues ekzistues për rregullimin e shtratit të lumit i aprovuar nga Asambleja Komonale.

Në çdo vendbanim ekzistues, me theks në vendbanime joformale, nevoja dhe mundësia e përcaktimit të hapësirave publike si janë fushat për lojë, zonat e gjelbëruara, tregjet, hapësirat sportive dhe hapësira për parkim do të përkrahen me plane rregulluese, aty ku hartimi i PRRU është prioritet. Ky vlerësim do të jetë pjesë e procesit të hartimit të këtyre planeve.

Në zonat e reja të planifikuara për zhvillimin e banimit, rezervimi i hapësirës publike do të jetë udhëzimi kryesor në planifikim.





## 5.2.2 Kushtet për rregullimin e hapësirës

### 5.2.2.a Ndërtesat me rëndësi për Kosovën

Ndërtimet me rëndësi për Kosovën janë të gjitha ato të cilat janë të parapara me PH të Kosovës, si: impianti për pastrimin e ujërave të zeza, deponia rajonale, hekurudha, vendkalimet kufitare si dhe të gjitha llojet e ndërtimeve të cilat do ta forconin bashkëpunimin ndërkufitar të komunës me shtetet përreth me theks në objektet kulturore-sportive dhe të atyre të infrastrukturës teknike dhe sociale.

### 5.2.2.b Zonat ndërtimore për vendbanime

Dispozitat e kontrollit të zhvillimit të vendbanimeve janë:

- Kompaktësia e zhvillimit,
- Tokat bujqësore të kategorive prej I – IV,
- Korridoret rrugore,
- Zonat me trashëgimi të pasur kulturore dhe natyrore,
- Zonat me pasuri nëntokësore,
- Zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore.

Për 22 vendbanime janë përcaktuar kahet e zhvillimit. Si kriter për përzgjedhjen e këtyre vendbanimeve është numri më i madh se 1000 banorë. Gjithashtu në këto 22 vendbanime janë edhe qendrat sekondare komunale. Skicat, resurset dhe kahet zhvillimore të këtyre 22 vendbanimeve gjinden në shtojcë të këtij dokumenti

### 5.2.2.c Strukturat e ndërtuara jashtë vendbanimeve

Për zonat ku nuk ka PRRU, ndërtimi i ndërtesave të larta do të kufizohet në përputhje me rregullat e përcaktuara me PZHU. Në zonat tjera, PRRU-të duhet të jenë të hartuara në përputhje me udhëzimet dhe synimet e përcaktuara dhe miratuara me PZHU.

Në raste kur ndërtimi më i lartë do të lejohet, vëmendje e posaçme duhet kushtuar sipërfaqeve siç janë; fushat për lojë, parkingjet, qasjet dhe peizazhi.

## 5.2.3 Kushtet për vendosjen e veprimtarive ekonomike

Këshilli Komunal për Zhvillim

Një parakusht tjetër për implementimin e suksesshëm të këtij plani është formimi i këshillit komunal i cili do të udhëheqë një numër të projekteve zhvillimore. Ata këtë mund ta bëjnë përmes dhënies së tokës në shfrytëzim, me ndërtimin e rrugëve dhe infrastrukturës tjetër dhe me



krijimin e kushteve më të mira për shitjen e parcelave individëve privat dhe biznesit.

Ky Këshill gjithashtu do ta bënte ndërlidhjen planeve dhe programeve zhvillimore Evropiane dhe të Qeverisë qendrore me qëllim të thithjes së investimeve dhe donacioneve të ndryshme të dedikuara për zhvillim në nivele të ndryshme organizative.

Gjithashtu, Këshilli do ta organizonte informimin dhe këshillimin me investues privat gjatë promovimit të partneritetit privat/shoqëror.

Aktivitetet ekonomike- tregtare dhe ato të industrisë së lehtë jo shqetësuese deri në 1500m<sup>2</sup> do të lejohen edhe në zonat banuese-mikse në pjesën urbane.

### **Zonat komerciale/industriale**

Zonat komerciale dhe industriale sigurojnë hapësirë për të gjitha llojet e çështjeve komerciale, kryesisht përdorimet që nuk janë të lejuara në zonat tjera. Janë paraparë përdorimet si në vijim:

1. Të gjitha llojet e ndërmarrjeve komerciale dhe industriale, ndërtesat e dyqaneve, depotë dhe ndërmarrjet publike,
2. Biznes, zyra dhe administratë,
3. Pompat e karburantit,
4. Objekte sportive.

Përdorimet në vijim janë paraparë vetëm në raste të veçanta:

1. Objekte për fenë, kulturën, pajisjet sociale dhe kujdesit shëndetësorë,
2. Banimin për stafin mbikëqyrës, menaxherët ose pronarët e prodhimeve,
3. Objekte e ndërmarrjeve.

#### **5.2.4 Kushtet për vendosjen e veprimtarive publike**

Themelimi i shërbimeve të reja dhe përmirësimi i shërbimeve ekzistuese publike për qytetin e Gjiçanit do të jenë të përqendruara në zonën urbane.

Ne zonën rurale, këto shërbime publike do të jenë te përqendruara ne fshatrat Cërnice, Bresalc, Përlepnicë, Dobërçan, Pogragjë dhe Zhegër. Ne vendbanimet tjera rurale, një gjë e tillë nuk do të përkrahet.



### 5.2.5 Kushtet dhe mënyra e ndërtimit të objekteve të banimit

Dendësimi në vendbanimet ekzistuese, pas përcaktimit të hapësirës për fushëloja, hapësirave publike dhe për parkim do të jetë i stimuluar. Në këto zona ku hartimi I PRRU është prioritet, një vlerësim i mundësive për dendësim do të përfshihet në procesin e hartimit të këtyre planeve. Shumica e zonave të banimit kryesisht sigurojnë hapësirë për banim. Në këto zona janë paraparë përdorimet si në vijim:

1. Ndërtesat për banim,
2. Furnizimi i zonave të nevojshme për tregti me pakicë, të furnizimit të ushqimit, dhe përdorimet komerciale jo shqetësuese,
3. Objekte për fenë, kulturën, pajisjet sociale të kujdesit shëndetësorë, dhe çështje sportive.

Përdorimet si në vijim janë paraparë vetëm në raste të veçanta:

1. Tregtia e akomodimit ,
2. Përdorimet tjera jo shqetësuese komerciale,
3. Ndërtesat për administratë,
4. Ndërmarrjet kopshtare,
5. Pompat e karburantit.

### 5.2.6 Kushtet për vendosjen e korridoreve apo trasave, sipërfaqeve komunikuese dhe sistemeve tjera të infrastrukturës

Për pjesëmarrje në jetën shoqërore dhe ekonomike mund të thuhet se mobiliteti është kushti kryesorë për të gjithë njerëzit.

Ky mobilitet duhet të planifikohet në atë mënyrë që të minimizojë ndikimet negative në ambient në njërën anë, ndërsa nga ana tjetër duhet ta risë qasjen e lehtë të qytetarëve në destinacione të dëshiruara, duke ndikuar pozitivisht në sigurinë në trafik dhe kualitetin e jetës.

Stacioni kryesor i hekurudhës për komunën do të vendoset në qytetin e Gjiçanit. Për ta ndihmuar përdorimin e transportit publik, për ta bërë hekurudhën më dobiprurëse dhe për ta ngritur mundësinë e qasjes në pjesët tjera të komunës, janë propozuar stacione tjera në Doberqan dhe Partesh. Ky Stacion Hekurudhorë ka lidhje direkt edhe me Stacionin e Ri të Autobusëve dhe me atë lokal, duke krijuar kështu një Qendër Mobiliteti për qytetin e Gjiçanit. Një organizim i tillë dukshëm e përmirëson qasjen dhe rritë mundësinë e lëvizshmërisë së lirë të qytetarëve në Komunë dhe jashtë sajë.



Veprimet e nevojshme për përmirësimin e mobilitetit:

- Rregullimi i Transportit Publik dhe masave të sigurisë në komunikacion,
- Transporti i Ri Publik ( Autobus/Tren ),
- Lidhje më të mira ndër rajonale,
- Ndërtimi dhe zgjerimi i rrugëve në zonat rurale,
- Shtigjet për këmbësorë dhe çiklistë,
- Rregullimi i udhëkryqeve.

Prioritetet strategjike janë:

- Përmirësimi i kualitetit fizik dhe zgjerimi i rrjetit rrugorë në drejtim të Maqedonisë dhe Serbisë,  
E para, zgjerimi i rrugës në drejtim të Preshevës dhe së dyti rruga e re për në Kumanovë përmes Zhegrës do ta forconte pozitën qendrore të Gjilanit si pikë takimi i “ Trekëndëshit të Dyfishtë”. Këto rrugë do ta lidhnin Gjilanin dhe Kosovën me Maqedoninë dhe me korridoret e planifikuara 10 dhe 8.
- Lidhja e Qendrave Sekondare ndërmjet veti si dhe lidhja e tyre me fshatrat përreth tyre. Zhvillimi policentrik pasqyrohet në këtë mënyrë edhe në raport me Transportin Publik.
- Rritja e sigurisë në trafik.

### 5.2.7 Kushtet për rregullimin e zonave dhe tërësive me vlerë të veçante

Planet hapësinore për zona të veçanta

Planet Hapësinore për zona të veçanta do të kërkohen për zonat e nivelit më të lartë të rëndësisë. Përmes këtyre rekomandimeve, Komuna e Gjilanit do të bëjë një kërkesë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të filloj hartimin e planeve hapësinore për zona të veçanta për:

- Mbrojtja e Moravës së Binçës,
- Qendra rekreative në burimin e ujit mineral në Dobërçan,
- Rezervari i liqenit dhe qendra rekreative e Pogragjës.

### 5.2.8 Masat për mbrojtjen e peizazheve, vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike

- Duhet bërë përzgjedhjen e elementeve të trashëgimisë kulturore të cilat duhet mbrojtur, dhe duhet miratuar rregullore përkatëse.



- Asnjë ndërtim nuk do të lejohet në zonat të cilat në PZHU janë të përcaktuara si zona të gjelbërimit.
- Jashtë zonës urbane, asnjë ndërtim nuk do të lejohet në brigjet e lumit dhe një distance prej 50 m' në të dy anët e lumit do të jetë e mbrojtur.
- Prera e drunjtëve nuk do të lejohet përderisa nuk të mbjellën fidanët e rinj si zëvendësim për ta. Në zona të caktuara ku ekziston rreziku nga erozioni, prerja e drunjtëve do të ndalohej.
- Ndërtimi i akomodimeve të vogla në fshatra ekzistuese do të lejohen, nëse respektohet mjedisi.

Zhvillimet e listuar në vijim nuk do të lejohen në zonat rurale:

- Ndërtimi për banim jashtë fshatrave,
- Ndërtimi për banim për çështje tjera që nuk kanë për qëllim plotësimin e kërkesës për rritje natyrore të fshatit,
- Ndërtesat me të larta se tri nivele/kate (P+2),
- Veprimtaritë industriale të rënda.

### 5.2.9 Mënyra e trajtimit të hedhurinave (përpunimi, deponimi dhe bartja)

Po të ndalohej ndotja e mjedisit nga hedhja e mbeturinave, nëse mbledhja (vendosja ilegale dhe e paautorizuar e mbeturinave) do të vazhdon të mbështetet mirë nga një organizim i mirë i grumbullimit të tyre, mjedisi do të ruhet dhe një proces i tillë i grumbullimit të mbeturinave do të zgjerohet në të gjitha pjesët e komunës. Kjo do të ndikoj gjithashtu në ngritjen e vetëdijesimit të popullsisë në lidhje me rrezikun për jetesë nga hedhja e mbeturinave dhe ta inkurajoj kontrollin shoqërorë.

Momentalisht, mbeturinat janë grumbulluar në pjesë të mëdha të Kosovës jugore dhe janë transportuar në deponon rajonale në Gjiçan, ku mbeturinat grumbullohen- ruhen pa asnjë trajtim të mëtutjeshëm. Në të ardhmen, kur të rregullohet menaxhimi i mbeturinave nga rregulloret e BE-së, mbeturinat do të digjen dhe vetëm hiri do të depozitohet. Vetëm disa deponi të tilla për djegien e mbeturinave do të jenë të nevojshme në tërë Kosovën, dhe me sa duket ato do të ndërtohen në kombinim me deponit rajonale të sotme. Një zgjerim i deponisë ekzistuese të Gjiçanit megjithatë mund të pritët.

Prioriteti i parë për menaxhimin e mbeturinave ka si imperativ formimin e shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave i cili duhet të zgjerohet në



tërë komunën dhe të pastrohen pjesët e depozitimit ilegal të tyre. Në hapin e dytë, pajisjet dhe metodat e deponive ekzistuese duhet të adoptohen me standardet e BE.

#### 5.2.10 Masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis

Shumica e masave për mbrojtjen e mjedisit si mbrojtja e peizazheve, mbrojtja e lumenjve, ripyllëzimi, procedimi i mbeturinave, impiantet etj., janë përmendur edhe më herët. Megjithatë, politikat mjedisore duhen reflektuar me një dokument lokal të trajtimit. Duhet të formohet një shërbim i ri në kuadër të administratës komunale.

#### 5.2.11 Masat për parandalimin e ndikimit negativ social

- Trajtimi i Vendbanimeve Joformale,
- Zgjidhja e problemeve të ndërtimeve pa leje,
- Sigurimi social dhe shëndetësor.

#### 5.2.12 Masat për zbatimin e planit

##### 5.2.12.a Obligimi për hartimin e planeve detale rregulluese

##### *Planet Rregulluese Urbane*

Ndonëse hartimi I PRRU duhet të mbulon tërë territorin urban dhe zonat e ndërtuara rurale, është e qarte se prioritet duhet ti jepet për ato zona ku problemet hapësinore janë natyrës urgjente.

Posaçërisht zonat si në vijim:

Për zona të cilat konsiderohen vendbanime joformale, që në vete kanë ndërtime me një status të paqarte:

- Zonat të cilat me ndërtimet e veta nuk janë në pajtim me PGJU (I cili është ende në fuqi dhe vetëm pjesërisht i aplikueshëm), mirëpo të cilat nuk janë në konflikt me PZHU;
- Aty ku riprojektimi dhe rekonstruimi i hapësirës publike është me interes dhe kërkon zgjidhje dhe qasje adekuate.

Zonat e cituara më poshtë janë identifikuar si zona parësore për të cilat duhet filluar menjëherë procesin e hartimit të PRRU:

1. Cërnica,
2. Bresalci,
3. Përlepnica,





4. Dobërcani,
5. Porragja dhe
6. Zhegra.

#### 5.2.12.b Masat për rregullimin dhe mbrojtjen e tokave

##### *Mbrojtja e Tokës Bujqësore*

Për tokën bujqësore përgjatë kufirit të territorit urban, nuk ka nevojë të hartohet PRrU. Sidoqoftë, zonat bujqësore dhe natyrore duhet mbrojtur nga ndërtimi joadekuat.

Ne përputhje me nenin 22.4 të LPH, komuna duhet të përgatisë vendimin për mbrojtjen e tokës kualitative bujqësore. Këto zona të mbrojtura do të shërbenin si një plotësim për PRrU të cilët duhet hartuar për zonën urbane, dhe do të ndihmojnë orientimin e zhvillimit të ri në zonat e destinuar për këtë.

Ne përgjithësi, nuk duhet lejuar ndërtime jashtë fshatrave dhe zonës urbane.

### 5.3 DISPOZITAT LIDHUR ME KONSULTIMIN, BASHKËPUNIMIN DHE PJESËMARRJEN

#### *Përmirësimi i pjesëmarrjes, përfshirjes dhe vetëdijesimit*

Jetësimi dhe zbatimi i PZHK dhe PRrU-ve është i mundshëm vetëm atëherë kur komuna krijon përkrahje dhe besim të qytetarëve për këto aktivitete, besim i cili do të arrihet me fushata mediale me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve.

#### *Centralizimi i informatave hapësinore*

Shënimet dhe informatat duhet të centralizohen në një sistem të GIS-it.

#### *Lejet e ndërtimit*

Lejet e ndërtimit duhet të qartësohen si procedura dhe të përmirësohen. Baza e të dhënave dhe sistemi i GIS-it duhet ti asistojnë kësaj procedure.

#### *Monitorimi dhe Rishikimi*

Gjiçani si edhe shumë komuna tjera në Kosovë, e ka eksperiencën e zhvillimit dinamik socio-ekonomik. Si pasojë, nevojat për tokë ndërtimore dhe furnizim të infrastrukturës mund të ndryshojnë në mënyrë të papritur. Për këtë arsye, është e nevojshme që të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme zhvillimi i komunës – nëse është e nevojshme – të rishikohet përmbajtja e PZHK së paku njëherë në 2 vite. Rishikimi- revidimi i tërësishëm i planit bëhet pas pesë vitesh.



### *Mandati i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit*

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 (e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/18). Neni 5.1 i Rregullores 2005/18 përkufizon se “Agjencia duhet të ketë kompetenca t’i administroj Ndërmarrjet në pronësi Publike dhe Ndërmarrjet në pronësi Shoqërore të regjistruara në Kosovë që nga 31 dhjetori 1988 apo ndonjë date pasuese (pavarësisht a i është nënshtruar Ndërmarrja Transformimit apo jo)”. Ne bazë të kësaj Rregulloreje, prona të shumta në komunën e Gjilanit, bien nën mandatin e AKM-së. Patundshmëria urbane dhe bujqësore e natyrës Publike ose Shoqërore nën mandatin e AKM-së mbase paraqet një përqindje të konsiderueshme.

Ne mes të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe AKM-së është akorduar e ashtuquajtura “procedura për shkëmbimin e tokave”, në lidhje me kërkesat komunale për të siguruar pronë shoqërore për projektet “te interesit të përgjithshëm”. Kjo politike kërkon që kërkesat të vlerësohen “rast për rast”, ku Ndërmarrja në Pronësi Shoqërore do të kompensohet në mënyre të duhur për cilëndo prone të tyre që do të transferohet komunës.

## 5.4 DISPOZITAT MBI RENDIN KRONOLOGJIK APO ETAPAT E ZBATIMIT

### *Buxheti i shpenzimeve komunale bazuar në PZHK dhe PZHU*

Planifikimi i investimeve komunale, posaçërisht ato me komponentë hapësinore (përfshirë aktivitetet e planifikimit, punëve publike, shpërndarjen e shërbimeve publike, banimi dhe ndërtimi tjetër), do të realizohet në përputhje me veprimet e theksuara në të dy planet PZHK dhe PZHU.

Tre muaj pas miratimit të të dy planeve (PZHK dhe PZHU). Asambleja Komunale do të miratoj planin e buxhetit me të cilin do ceket qartë se si do të financohet zbatimi i të dy planeve për se paku tri vitet e para. Ky plan shtesë i buxhetit do të definoj mes tjerash se si do të hartohen PRrU-të, se si do të zbatohen hulumtimet e domosdoshme dhe si do të financohet hartimi i dokumenteve politike zhvillimore të përcaktuara me plane zhvillimore.

### *Sigurimi i përputhshmërisë me dokumentet ekzistues politike*

Tre muaj pas miratimit të të dy planeve (PZHK dhe PZHU), komuna duhet të



rishikoj politikat sektoriale në mënyrë që ato të jenë në harmoni me dispozitat e PZHK dhe PZHU.

## 5.5 ELEMENTET DHE UDHËZIMET PËR HULUMTIM TE MËTUTJESHËM


Planet dhe politikat që duhet hartuar

1. Plani i politikave mjedisore, në veçanti mbrojtja e ujërave, pyjeve dhe tokës bujqësore,
2. Plani i infrastrukturës teknike,
3. Politikat e mobilitetit,
4. Hulumtimi i energjisë për ngrohje,
5. Studimi i fizibilitetit të kalimit të hekurudhës përmes qytetit nën tokë,
6. Zonat arkeologjike,
7. Studimi i mundësive dhe i një furnizimi të qëndrueshëm me ujë të pijes,
8. Eko-Prodhimet.





# SHTOJCAT






























































## **Referencat:**

European Commission and International Management Group (EU/IMG):

**Damage Assessment Kosovo.** Assessment of Damaged Housing and Local / village Infrastructure in Kosovo. July 1999

Raportet Sektorale

- Administratë Komunale
- Kulturë, Rini dhe Sport
- Buxhet, Financa dhe Investime
- Arsim
- Shërbime Publike
- Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient
- Ekonomi dhe Menaxhment
- Shëndetësi dhe Çështje Sociale
- Siguri dhe Emergjencë
- Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi
- Bujqësi dhe Pylltari
- Zyra për Komunitete Lokale

European Commission Damage Assessment Kosovo / International Management Group (EU/IMG):

**Building Assessment.** Municipality: Gjilan / Prishtine. IMG Kosovo, April 2000

Raportet e Grupeve punuese

- Demografia dhe Çështjet Sociale
- Zhvillimi Ekonomik
- Mjedis dhe Shfrytëzimi i Tokës
- Infrastruktura

Federal Republic of Yugoslavia (FRY) / Federal Statistical Office (FSO) / Savezna Republika Jugoslavija / Savezni Zavod za Statistiku:

**Popis '91 Stanownischtwo.** Belgrad 1993

Government of Kosovo:

**The Kosovo General Government 2003 Budget.** Prishtina 2003

Government of Kosovo:

**The new Kosovo Government. 2002 Budget.** Prishtina 2002

International Monetary Fund:

**Kosovo. Institutions and Policies for Reconstruction and Growth.** Prepared by Dimitri G. Demekas, Johannes Herderschee, Davina F. Jacobs, 2002

International Organisation for Migration / IOM:

**Kosovo. Demographic, socio-economic and reproductive health survey.** Basic Results. May 2000





Ministry of Environment and Spatial Planning / Department of Spatial Planning:

**Report on present situation in urban management and planning in municipalities of Kosovo.** Prepared by: Municipalities, Road Directorate, Kosovo Cadastral Agency, Urban Institutions, Kosovo Statistical Office and Institute for the Protection of Monuments, 2002

Ministry of Environment and Spatial Planning (MESP) / Ministria e Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor (MMPH):

**Kosovo State of the Environment** / Raport Mbi gjendjen ambientale në Kosovë April / Prill 2003

Ministry of Environment and Spatial Planning / Department of Housing and Construction / Reconstruction Section:

**Kosovo Profile. Kosovo Spatial Development.** Working document. Prishtina June 2004

Ministry of Environment and Spatial Planning / Institute for Spatial Planning:

**Report on present situation in urban management and planning in municipalities of Kosovo.** Prepared by: Municipalities, Road Directorate, Kosovo Cadastral Agency, Urban Institutions, Kosovo Statistical Office and Institute for the Protection of Monuments, 2002

Ministry of Health, Provisional Self-Government of Kosovo:

**Demographic Transition and Health Insurance in Kosovo.** Report prepared by Manoj Mohanan, Harvard School of Public Health Boston MA; Prishtina 2003

National Board of Housing, Building and Planning, Sweden; Ministry for Regional Development of the Czech Republic, editors:

**Housing Statistics in the European Union 2004**

Organization for Security and Co-Operation in Europe (osce) and UNHCR:

**Assessment of the Situation of Ethnic Minorities in Kosovo** (October 2000 to February 2001) OSCE Mission Fact sheet March 2001

Organization for Security and Co-Operation in Europe (osce) and UNHCR:

**Ninth Assessment of the Situation of Ethnic Minorities in Kosovo** (Period covering September 2001 to April 2002) 27 May 2002,  
[http://www.osce.org/documents/mik/2002/05/11110\\_en.pdf](http://www.osce.org/documents/mik/2002/05/11110_en.pdf) Prishtina 2002

Organization for Security and Co-Operation in Europe (osce):

**Municipal Profile Gjilan / Gnjilane.** November 2005

Osmani, Dr. Jusuf

**Kosova dwellings 6 Gjilani,** Prishtina 2004

RIINVEST:

**Post-War Reconstruction of Kosova. Strategy and Policies.** Prishtina, March 2000

RIINVEST:

**Labour Market and Unemployment in Kosova.** Prishtina, January 2003



Simpson, David; and Bajram Maxhuni:

**Kosovo Health Profile**. Supported by DFID, UNICEF and Open Society Institute, June 2003

Statistical Office of Kosovo (SOK):

**Kosovo and its Population. A brief description**. 5th Version, June.2003

Statistical Office of Kosovo (SOK):

**Kosovo Demographic and Health Survey 2003**. Preliminary results. Draft chapters, [http://www.sok-kosovo.org/publications/dhs\\_2003.htm](http://www.sok-kosovo.org/publications/dhs_2003.htm); April 2004.

Statistical Office of Kosovo (SOK):

**Kosovo Labour Force Survey 2001**. Methodological report. August 2002

Statistical Office of Kosovo (SOK):

**Labour Market Statistics 2004**. Series 5: Social Statistics. Prishtina 2005

Statistical Office of Kosovo (SOK):

**Vital statistics of Kosovo 2002 - 2003**. Bulletin Number 3. Prishtina 2004 / Statistikat Vitale të Kosovës 2002 - 2003. Buletini Numër 3. Prishtinë 2004

Statistical Office of Kosovo (SOK):

**Vital statistics of 2004**. Bulletin Number 4. Prishtina 2005 / Statistikat Vitale të Kosovës për Vitin 2004. Buletini Numër 4. Prishtinë 2005

Statistical Office of Kosovo (SOK); United Nations Population Fund (UNFPA) and International Organization for Migrations (IOM):

**Demographic, social, economic situation and reproductive health in Kosovo following the 1999 conflict**. Results of a household survey November 1999 – February 2000. Report prepared by Chantal Blayo, Christophe Bergouignan, Marine Llopart, Nicodème Okobo and Nancy Stiegler, Institute of Demographic Studies of the University Montesquieu – Bordeaux IV (IEDUB), France, January 2001

United Nations Development Programme (UNDP):

**The Kosovo Mosaic: Perceptions of local government and public services in Kosovo**; results of the "Local Authorities and Public Services Survey"; study performed by Index Kosova and BBSS Gallup International; Prishtina 2003;

United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (UNMIK): Energy sector.

Technical assistance project (ESTAP) Kosovo. World Bank Grant No. TF-027791 Module A

**Electricity Demand** (Draft Report: V3b). Supported by: CESI, EIW, Ramboll, RE; pp. 22 ff. Demographic Analysis; Prishtina, April 2002

United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (UNMIK):

**Energy Sector. Technical assistance project / ESTAP** World Bank Grant No. TF-027791. Supported by CESI, EIW, Ramboll, RE; **Executive Summary. Final Report**; pp. 14 ff.: Demographic Development; [http://www.ks.gov.net/mem/pdf/estap1/Executive\\_Summary.pdf](http://www.ks.gov.net/mem/pdf/estap1/Executive_Summary.pdf); Prishtina, September 2002

United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (UNMIK):

**Fact Sheet Kosovo**, 2002



United Nations, Development Programme (UNDP):

**Human Development Report Kosovo 2004.** The Rise of the Citizen: Challenges and Choices. Core team of writers: Mytaher Haskuka, Leon Malazogu, Nita Luci, Ilir Dugolli; Prishtina 2004

World Bank:

**Kosovo, Poverty Assessment.** (In two volumes) Volume I: Main report; Volume 2; Based on Living Standard Measurement Survey / LSMS 2001; December 20, 2001

World Bank:

**Kosovo, Labor Market Study: Policy Challenges of Formal and Informal Employment.** Human Development Unit Europe and Central Asia Region. June 2003